

BESIMI SOCIAL DHE AUTORITETI INSTITUCIONAL NË DEMOKRACINË SHQIPTARE

Raport Studimor

*Prof. Dr. Adem Tamo
MA Besnik Baka
MA Egest Gjokutaj*

Tiranë, Qershor 2011

Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së Sh.B.A.-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Departamentit të Shtetit.

Autorët marrin përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e këtij raporti, i cili jo domosdoshmërisht pasqyron pikëpamjet e IDN-së.

Falënderime

Studimi “Besimi social dhe autoriteti institucional në demokracinë shqiptare” përbën një nga aktivitetet më të rëndësishëm të IDN-së për periudhën 2010-2011. Ai u ndërmor në kuadër të përpjekjes për të sistemuar perceptimet shoqërore për rolin e besimit social në ndërtimin e shtetit ligjor dhe për të dhënë një përgjigje për këtë lidhje. Ai është mbështetur në idenë se nuk mund të jepen përgjigje të thjeshta për çështje të ndërlikuara.

Projekti mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së Sh.B.A.-së në Tiranë 2010.

Studimi i zhvilluar ofron të dhëna për fenomene të cilat lidhen me sistemin e vlerave aktive në shoqëri. Ai i shikon këto vlera si një komponent efikas i proceseve sociale, sidomos për ndërtimin e besimit dhe të institucioneve.

Ky raport është produkt i punës së një ekipi të përbërë nga MA Besnik Baka dhe MA Egest Gjokutaj, të cilët punuan nën drejtimin e Prof. Dr. Adem Tamos.

Me rastin e përfundimit të studimit autorët dëshirojnë të shprehin mirënjohjen për drejtuesit dhe punonjësit e IDN-së që ofruan infrastrukturën e nevojshme dhe gjithë mbështetjen logjistike për kryerjen e tij, si edhe për të gjithë personat të cilët kontribuan me idetë e tyre gjatë konsultave grupale apo intervistave individuale zhvilluar në kuadër të këtij projekti. Shpresojmë që studimi në vijim të sfidojë intelektualisht dhe etikisht të gjithë lexuesit e tij, si edhe të nxisë diskutime të mëtejshme për këtë temë sa të ndërlikuar aq edhe të nxehtë për jetët tona individuale e publike.

Pasqyra e lëndës

Falënderime	3
Pasqyra e lëndës	4
Lista e tabelave, figurave dhe kutive	5
1. Hyrje 1	6
1.1. Qëllimi dhe objektivat	9
1.2. Rreth karakterit të studimit	9
1.3. Metodologjia e studimit	11
1.3.1. <i>Grumbullimi i të dhënave</i>	11
1.3.2. <i>Analiza e të dhënave</i>	12
1.4. Kufizime të studimit	13
1.5. Përmbledhje ekzekutive e gjetjeve kryesore të studimit	13
2. Rezultatet dhe diskutimi	15
2.1. Trashëgimia e afërt e besimit social nga periudha moniste	15
2.2. Rëndësia e studimit të besimit social	18
2.3. Koncepti mbi besimin social dhe autoritetin e ligjit	19
2.3.1. <i>Koncepti dhe burimet e besimit social</i>	22
2.3.2. <i>Marrëdhëniet e besimit social me kapitalin social</i>	24
2.3.3. <i>Shteti ligjor, autoriteti i ligjit, autoriteti institucional</i>	25
2.4. Aplikime të koncepteve mbi besimin social e kapitalin social në studimin e konteksteve të ndryshme	27
2.5. Marrëdhëniet ndërmjet besimit ndërpersonal dhe atij institucional	31
2.5.1. <i>Marrëdhënia ndërmjet besimit ndërpersonal dhe atij institucional</i>	36
2.5.2. <i>Kënaqësia nga jeta, përfshirja në politikë dhe pjesëmarrja në aksion politik</i>	46
2.6. Besimi në përgjithësi, qëndrimet politike dhe sjelljet shoqërore	54
2.6.1. <i>Besimi në përgjithësi, besimi ndërpersonal dhe rrjetet informale</i>	57
2.6.2. <i>Sjelljet sociale dhe besimi në përgjithësi</i>	58
2.7. Shteti Ligjor në Shqipëri: hartimi, zbatimi i ligjit dhe ndikimi në besimin social	64
2.7.1. <i>Procedurat nga draftimi te miratimi i ligjeve</i>	64
2.7.2. <i>Zbatimi dhe ndëshkimi ligjor</i>	75
2.7.3. <i>Ndikimi i zbatimit të ligjit në besimin social</i>	82
3. Përfundime	87
4. Shtojca	89
4.1. Shtojca 1: Lista e variablave të SBV-së të përdorura në studim	89
4.2. Shtojca 2: Listë Kontrolli për zbatimin e ligjit	94
5. Bibliografia	96

Lista e tabelave, figurave dhe kutive

Tabela 1: Përmbledhje e situatës së skemave kryesore piramidale në Shqipëri	32
Tabela 2: Besimi ndërpersonal 1998 dhe 2002 në %	36
Tabela 3: Pjesëmarrja në grupime jo –politike 2002 në %	38
Tabela 4: Përgjegjësia e njerëzve kundrejt asaj të qeverisë 1998 dhe 2002 në %	42
Tabela 5: Anëtarësimi në partitë politike (2002) në %	48
Tabela 6: Besimi i përgjithësuar në rajon (1996-2002) in %	55
Tabela 7: Pranimi i disa sjelljeve shoqërore me implikime politike	61
Figura 1: Skemë përmbledhëse e trajtimit teorik të konceptit kapital social dhe përbërësve të tij	20
Figura 2: Besimi ndërpersonal dhe besimi tek qeveria 1998 dhe 2002 në %	36
Figura 3: Besimi tek shtypi 2002 në përqindje	38
Figura 4: Besimi në institucionet ndërkombëtare 1998 dhe 2002 në %	39
Figura 5: Besimi tek Policia 1998 dhe 2002 në %	40
Figura 6: Besimi tek drejtësia 2002 në %	41
Figura 7: Besimi tek Policia, Parlamenti dhe FA 1998 dhe 2002 në %	41
Figura 8: Respekti dhe dashuria për prindërit 1998 dhe 2002 në %	43
Figura 9: Koha e lirë kaluar me familjen shokët, kolegët e me të tjerë 2002 në %	43
Figura 10: Ata që jetojnë me prindërit dhe ata që jetojnë vetëm 1998 dhe 2002	44
Figura 11: Ata që jetojnë me prindërit dhe ata që firmosin një petition 2002	45
Figura 12: Jeta vetëm, jeta me njerëz të tjerë dhe angazhimi civil	45
Figura 13: Frekuencat e interesimit për politikën gjatë 1998 dhe 2002 në %	47
Figura 14: Pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare 1998, 2001, 2005 dhe 2009 sipas OSBE/ODIHR	47
Figura 15: Vlerësimi i sistemit politik 1998 dhe 2002	48
Figura 16: Kënaqësia nga jeta dhe anëtarësia në partitë politike (2002) në %	49
Figura 17: Kënaqësia nga jeta dhe firmosja e peticioneve në 2002 në %	51
Figura 18: Kënaqësia nga jeta dhe pjesëmarrja në demonstrata të ligjshme 2002	51
Figura 19: Niveli i perceptuar i lirisë së zgjedhjes dhe përfshirja në firmosjen e një peticioni 1998 dhe 2002	52
Figura 20: Pjesëmarrja në aksione politike (1998)	52
Figura 21: Pjesëmarrja në aksione politike (2002)	53
Figura 22: Besimi në përgjithësi 1998, 2002 në %	54

Figura 23: Rëndësia e familjes, shokëve dhe besimi në përgjithësi në 1998 dhe 2002 në %	57
Figura 24: Pranueshmëria e sjelljeve shoqërore morale 1998 në %	58
Figura 25: Pranueshmëria e sjelljeve shoqërore morale 2002 në %	59
Figura 26: Pranueshmëria e sjelljeve shoqërore politike 1998 në %	60
Figura 27: Pranueshmëria e sjelljeve shoqërore politike 2002 në %	60
Figura 28: Indeksi i korrupsionit në Shqipëri në vite (WB, Aggregate Governance Indicators 1996-2006)	62
Figura 29: Korrupsioni ndërmjet zyrtarëve publikë	63
Figura 30: Vendimet e Gjykatës Kushtetuese mbi veprimtarinë e Parlamentit dhe Këshillit të Ministrave	73
Figura 31: Zhvillimi i Shtetit Ligjor në Shqipëri sipas World Bank	78
Figura 32: Zhvillimi i shtetit të së drejtës në Shqipëri	79
Figura 33: Vendimet e Gjykatës Kushtetuese për Sektorin e Drejtësisë	80
Figura 34: Ankesat drejtuar Avokatit të Popullit në lidhje me vendimet e drejtësisë	81
Figura 35: Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës në Shqipëri ndër vite	82
Kutia 1: Përsëri punë vullnetare?	21
Kutia 2: Diskutim për shtetin ligjor në dyqanin e djathit	26
Kutia 3: Rruga e gjatë nga Moska në Stokholm	27
Kutia 4: Kriza e firmave piramidale	31
Kutia 5: Shumë të kënaqur por të lodhur me politikën	50
Kutia 6: Kundërshtia mes të praktikuarit dhe të pranuarit të vlerave	62
Kutia 7: Hapat në procesin legjislativ	65
Kutia 8: Marrëveshja Kufitare mes Shqipërisë dhe Greqisë	66
Kutia 9: Akcizat në Shqipëri: Në 9 vjet i rishikuar 12 herë	68
Kutia 10: Hartimi i ligjit në Parlament – Problematika Kryesore	71
Kutia 11: Rasti i Kushtetutës	74
Kutia 12: Ligji kundër duhanit	76

1. HYRJE

Shqipëria përmbylli dekadën e dytë të një kapërcimi të madh prej një shoqërie autoritare me një sistem ekonomik të planifikuar, drejt një shoqërie demokratike me një sistem ekonomik të tregut të lirë. Demokracia pluraliste dhe ekonomia e tregut tashmë janë instaluar me sukses, por kthimi i këtyre dy arritjeve në faktorë që prodhojnë përparim do ende më shumë kohë.

Në përpjekjet e saj për zhvillim Shqipëria është anëtarësuar në NATO dhe synon që të pranohet në BE. Megjithë arritjet, kjo rrugë nuk ka qenë e lehtë.

Krejt në kundërshtim me perceptimin e përgjithshëm se kalimi nga sistemi diktatorial dhe ekonomia e centralizuar drejt sistemit demokratik dhe ekonomisë së tregut do të ndodhte në një kohë të shkurtër, ne tani ndeshim keqardhjen që tranzicioni në Shqipëri qenka i gjatë dhe nuk dihet se kur do të jetë fundi i tij. Kjo keqardhje ndonjëherë është aq e madhe, saqë edhe vetë fjala tranzicion ngacmon një kompleks i cili shfaqet me irritime. Keqardhja ose edhe urrejtja për këtë periudhë, është tregues i pritshmërisë për diçka që nuk mund të ndodhë aq shpejt dhe aq mirë sa e duam ne: tranzicioni nga një sistem në tjetrin përbën një dukuri shumë më komplekse se kaq. Nga ana tjetër kjo keqardhje e urrejtje për kohëzgjatjen lidhet shpesh me produkte ende të pamarrë nga ky tranzicion. Kjo ngre çështjen e diskutimit të kohëzgjatjes së këtij tranzicioni dhe të faktorëve që e kushtëzojnë atë. Ajo që tashmë është e dukshme për këdo, është se ndryshimi i sistemit politik nuk përmbushi automatikisht pritshmëritë e njerëzve dhe instalimi i demokracisë pluraliste nuk përkthehet kaq shpejt në rezultate të kënaqshme për të gjithë.

Çështje të rëndësishme të përparimit të vendit në drejtim të plotësisimit të kërkesave që kërkon procesi i integritit evropian, vihen re në mënyrë shumë kritike edhe në dokumentet evropiane që e vlerësojnë këtë proces. Kritikën dhe rekomandimet e herëpashershme në dokumente e misionë vlerësuese, vënë në dukje vështirësi në ndërtimin e institucioneve ligjore. Të gjitha këto bëjnë që herëpashere të ngrihen pyetjet: Pse nuk po arrijmë të ndërtojmë institucionet që dëshirojmë? dhe Ç'na pengon të bëjmë një shtet ku ligji të jetë rregullator për të gjithë?

Shoqëria shqiptare duket se është përfshirë në një diskutim të gjerë lidhur me fatet e vendit, tensionet e panevojshme, vështirësitë e jetës, etj. Ky diskutim është i gjallë në mjediset tona shoqërore, por përkundër, vetëm rrallë është transferuar në tryezat politike, akademike e sociale. Përmasat e tij të gjera duken në interesimin e përgjithshëm për këto çështje si edhe në gatishmërinë që për këto çështje të diskutohet kudo.

Mesa duket, këto probleme janë shumë të rëndësishme dhe pikërisht për këtë arsye nuk mund të rrihet pa i diskutuar seriozisht ato. Duhet thënë se në disa raste, diskutimi i sotëm për to lë vend për thashetheme, është instrumentalizuar nga politika e ditës për të shprehur ankime e akuza të një pale ndaj palës tjetër, ka natyrë konsumistike dhe, për fat të keq, vetëm pak herë ka ndodhur që ai të kryhet siç i takon një diskutimi serioz politik, akademik e shoqëror.

Mbi besimin social janë shkruar studime të shumta një pjesë e mirë e të cilave kanë marrë shkas nga të dhënat e pesë sondazheve botërore/europiane mbi vlerat. Një nga studimet më

interesante është ai i Rothstein i cili i kategorizon shoqëritë europiane e botërore bazuar në indeksin e besimit. Gjetje e rëndësishme e këtyre studimeve është edhe fakti se shoqëritë prirën të jenë shoqëri besuese dhe shoqëri mosbesuese. Për shembull, shoqëritë e vendeve të veriut të Europës konsiderohen si shoqëri ku besimi ndërpersonal është relativisht i lartë, ndërsa besimi në shoqëritë e jugut të Europës mbetet relativisht i ulët. Pra banorët e veriut të Europës janë më besues të njëri-tjetri ndërsa në të jugut jemi më pak besues. Fakti që Shqipëria bën pjesë në jugun e Europës, në kryqëzimet e civilizimeve, të besimeve, të gjeografive politike duket se e mban të gjallë këtë nivel relativisht të lartë mosbesimi tek njëri-tjetri.

Gjatë dy dekadave të fundit, në nivel ndërkombëtar, janë kryer e po kryhen studime të shumta për besimin social, ndërkohë që në vendin tonë duket se bota akademike nuk e ka trajtuar ballazi këtë fenomen përveç trajtimeve episodike e në këndvështrime të caktuara që i është bërë atij prej individëve të shquar të shoqërisë civile.

Çështjet se sa autoritet kanë institucionet që kemi arritur të ndërtojmë, se përse ato nuk kanë një autoritet më të madh, se përse ne nuk po arrijmë të ndërtojmë institucionet siç i duam vetë, se përse kemi gatishmëri t'i përgojmë (deri edhe t'i sulmojmë) ato, përbëjnë thelbin e këtij studimi.

Studimi i marrëdhënieve midis besimit social dhe autoritetit të ligjit përbën një ndërmarrje të ndërlikuar. Kjo çështje ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve ndërkombëtarë. Përpjekjet e studimeve të deritanishme kanë çuar në formulimin e disa teorive dhe në zbulimin e lidhjeve ekzistuese midis faktorëve të ndryshëm.

Studimi që keni në dorë merret me marrëdhëniet midis besimit social, autoritetit të ligjit dhe shtetit ligjor. Autorët e tij mendojnë se institucionet që ne kemi arritur t'i ndërtojmë pasqyrojnë kapacitetin tonë për të ndërtuar një shoqëri funksionale dhe se ato nga ana e tyre, me realizimet dhe mosrealizimet e tyre, formësojnë nivelin tonë të besimit dhe të mosbesimit në to. Kësisoj, në studimin në fjalë do të trajtohet marrëdhënia midis kapitalit tonë social dhe besimit në institucionet e ligjit.

Ky studim mund të hedhë themele për përcaktimin e problemeve të besimit social dhe të rolit të tyre në formimin e institucioneve, duke ofruar kështu bazat për studime të mëtejshme. Kjo gjithashtu mund të ndihmojë për elaborimin e hipotezave për studime të mëtejshme në këtë fushë. Ky është motivi që shtyn për zbulimin e ideve, të lidhjeve, dhe ndërveprimeve. Në këtë kuptim, studimi që keni në dorë do të ndihmojë edhe për precizimin e problemit të marrëdhënies midis besimit social dhe ndërtimit të shtetit ligjor, për identifikimin e linjave kryesore të veprimit drejt alternativave më të mundshme, për të zbuluar se çfarë qasjesh janë më të mira për studimin e kësaj marrëdhënieje dhe për të përcaktuar përparësi për studime të mëtejshme.

Ky kërkim studimor përbën një përpjekje nismëtare dhe të rëndësishme për të kuptuar diçka rreth marrëdhënieve dhe rolit të besimit social e të kapitalit social me autoritetin institucional.

1.1. Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij studimi është ekspozimi i çështjes së marrëdhënies midis besimit social dhe autoritetit të institucioneve ligjore, dhe transferimi i saj nga një çështje e diskutimit joformal në një çështje të denjë për diskutim në forume politike, akademike e sociale. Në këtë këndvështrim, studimi pretendon të tërheqë vëmendjen e politikëbërësve, të akademikëve dhe të forcave shoqërore të kualifikuara, duke shqyrtuar faktorë ndikues në lidhjen e besimit social me autoritetin e ligjit. Në këtë mënyrë, studimi synon të kontribuojë në forcimin e sundimit të ligjit gjatë kalimit nga monkracia në demokraci.

Objektivat e këtij studimi janë:

1. Të analizojë gjetjet e studimeve të mëparshme që kanë të bëjnë me besimin social dhe autoritetin institucional/sundimin e ligjit në vend dhe faktorët që ndikojnë këtë proces.
2. Të përshkruajë posaçërisht perceptimet e kontekstit shqiptar mbi besimin dhe autoritetin e ligjit.
3. Të gjenerojë/propozojë shpjegime për faktorët që mundësojnë perceptime të tilla.
4. Të elaborojë faktorët e mundshëm që forcojnë besimin në autoritetin e ligjit.

Kjo do të jetë një sipërmarrje e vështirë, si për këtë studim, ashtu edhe për të tjerë të pritshëm në këtë fushë. Përgjigjet e gjetura për objektivat e mësipërme do të strukturohen në këtë mënyrë:

1. Paraqitja e marrëdhënies midis besimit të njëri-tjetri dhe besimit në institucionet në tërësi,
2. Paraqitja e marrëdhënies së cilësisë së perceptuar të jetës dhe aktivizimit shoqëror,
3. Paraqitja e marrëdhënies midis qëndrimeve ndaj familjes dhe qëndrimeve ndaj institucioneve shoqërore,
4. Paraqitja e marrëdhënies midis besimit në tërësi, sjelljes politike dhe sjelljeve shoqërore.
5. Paraqitja e gjetjeve në lidhje me problematikën që vihen re në hartimin e ligjit dhe administrimin e drejtësisë.

Realizimi i qëllimit dhe i objektivave të këtij studimi përbëjnë një sipërmarrje sfidante dhe të rëndësishme si për diskutimin e ditës ashtu edhe për ardhmërinë tonë si shoqëri.

1.2. Rreth karakterit të studimit

Ky studim, ka të bëjë me besimin social dhe rolin e tij në procesin e ndërtimit të institucioneve ligjore. Si i tillë ai përbën një përpjekje të rëndësishme për të trajtuar një nga dukuritë e ndërlikuara të jetës sonë publike.

Besimi social është karakteristikë e kapitalit social dhe kapitali social është një faktor themelor për shumë procese shoqërore, përfshirë edhe proceset e ndërtimit të shtetit/institucioneve ligjore¹. Kësisoj ky studim bazohet në kuptimin më autoritar e më të përhapur mbi kapitalin social dhe rolin e tij shoqëror.

Karakterit i këtij studimi është eksplorator. Ai rreh të formulojë çështjen e marrëdhënies midis besimit social dhe autoritetit institucional, për shqyrtim më preciz dhe për ndërtimin e hipotezave dhe të përparësive për studim të mëtejshëm, të grumbullojë informacione në lidhje me vështirësitë që hasen në ndërtimin e shtetit ligjor si dhe të prezantojë një këndvështrim më të gjerë social të shikimit të çështjes së ndërtimit të shtetit ligjor. Në këtë mënyrë ai përpiqet të japë dhe të sistemojë përgjigjet që ekzistojnë në mjedisin tonë shoqëror në lidhje me kapacitetin tonë për të ndërtuar shtet ligjor, mundësitë tona reale për ta bërë një gjë të tillë dhe veprimet e pagoditura në këtë proces.

Karakterit i studimit është i lidhur me faktin se si ndodh që besimi social ushtron ndikimin e vet përmbi qëndrime të caktuara me peshë në jetën shoqërore, siç janë qëndrimet ndaj aktivizmit shoqëror, sjelljeve shoqërore, etj. Në këtë këndvështrim, zgjidhjet e mundshme të problemeve të caktuara shqyrtohen dhe vlerësohen nga vetë studiuesit. Cilësitë e aktivizmit shoqëror, kënaqësia nga jeta dhe aspekte të tjera të jetës shoqërore vlerësohen në mënyrë të tërthortë. Duket se angazhimi për të kërkuar rreth besimit social dhe marrëdhënive të tij me autoritetin e institucioneve, bazohet pikërisht në faktin se kjo marrëdhënie nuk njihet. Nuk dihet se pse besohet pak, nuk dihet se pse ka apati dhe as se pse ndodh që vullneti i individit të dalë përmbi ligjin dhe rregullat që përcaktojnë funksionimin e institucionit. Në këtë kuptim, natyra e studimit, jep mundësi që të kërkohen edhe veprime alternative për përmirësimin e situatës.

Karakterit eksplorator i studimit të marrëdhënies midis besimit social dhe autoritetit të institucioneve bazohet në faktin se në kontekstin tonë kjo lidhje nuk është artikuluar aq sa duhet në nivel akademik, nuk ekzistojnë përpjekje të dukshme për shpjegime të përafërta si edhe në idenë se kombinimi i të dhënave nga studimet e mëparshme me ato të fokusgrupeve dhe intervistave përbën një metodologji elastike për këtë temë studimore.

Në këtë mënyrë, studimi përpiqet të integrojë në një paraqitje të vetme të dhëna nga studime të tjera, eksperiencia të personave kyç të kontekstit shqiptar dhe kazuse nga jeta përditshme. Kjo mundëson paraqitjen e një numri jo të vogël interpretimesh të situatave, gjë që përbën edhe një nga veçoritë e këtij studimi: propozimin e studimeve të mëtejshme në këtë fushë.

¹ Putnam. Robert, "Social Capital: Measurement and Consequences", Kennedy School of Government, Harvard University, f.29.

1.3. Metodologjia e studimit

1.3.1. Grumbullimi i të dhënave

Ky studim mbështetet në të dhëna të grumbulluara nga disa burime njëherësh:

1. Në Sondazhin Botëror mbi Vlerat (SBV) në valët 3 dhe 4 të tij² ku Shqipëria figuron në vitet 1998 dhe 2002.

Sondazhi Botëror mbi Vlerat përfaqëson një iniciativë madhore për grumbullimin e të dhënave mbi dukuritë shoqërore dukshëm të lidhura nga sistemet e vlerave në të cilat ne besojmë. Ky sondazh përbën një projekt kërkimor global, që studion vlerat dhe besimet e njerëzve, mënyrën si ato ndryshojnë përgjatë rrjedhës së kohës dhe ndikimin që ato kanë mbi jetën shoqërore dhe politike. Sondazhi kryhet nga një rrjet botëror studiuesish socialë, të cilët kanë kryer sondazhe kombëtare përfaqësuese në pothuajse 100 vende të botës. Ai përbën burimin e vetëm të të dhënave empirike në lidhje me qëndrimet e shumicës së popullsisë së botës (rreth 90%).

Sondazhi Botëror mbi Vlerat ofron matje, monitoron dhe analizon këto nënfusha specifike: mbështetjen për demokracinë, tolerancën ndaj të huajve dhe minoriteteve etnike, mbështetjen për barazinë gjinore, rolin e fesë në shoqëri, ndikimin e globalizimit, qëndrimet ndaj mjedisit, punës, familjes dhe politikës, identitetin kombëtar, kulturën, diversitetin, pasigurinë dhe mirëqenien subjektive.

Gjetjet e këtij sondazhi prestigjioz janë të çmuara për politikëbërësit dhe aktorët e shoqërisë civile që punojnë për ndërtimin e institucioneve demokratike në vendet në zhvillim. Baza e të dhënave e këtij sondazhi, përdoret gjithashtu gjerësisht edhe nga studiues me emër të institucioneve të njohura ndërkombëtare si Banka Botërore, PNUD, universitete e institucione akademike etj.

Të dhënat e këtij studimi, përbëjnë një bazë serioze për shumë studime komplekse e me peshë në fushën e sociologjisë dhe politologjisë. Gjetjet nga SBV janë analizuar dhe, tani dhe më vonë, do të diskutohen dhe elaborohen më tej, për t'u krahasuar me të dhëna të kontekstit tonë për të gjetur përgjigje për publikun dhe shtetarët, për individët dhe institucionet.

Për Shqipërinë, kjo bazë të dhënash përmban të dhëna për dy valët e para të tij të kryera në vitin 1998 dhe në vitin 2002, madje të dhënat janë koaliduar me ato të vitit 2007. Kështu kjo bazë të dhënash përbën një burim të çmuar që mbetet për tu studiuar më tej dhe më gjerë³.

2. Në një koleksion studimesh të kryera në nivel evropian e ndërkombëtar në lidhje me besimin social dhe ndërtimin e shtetit ligjor.

Autorët e këtij studimi, realizuan një kërkim të zgjeruar në lidhje me studime të ngjashme për

² Vini re: vala e tretë dhe e katërt e sondazhit botëror mbi vlerat konsiderohet e tillë, pra e tretë dhe e katërt, ndërsa Shqipëria është përfshirë vetëm në dy valë të tij. Ky studim mbështetet në sondazhin që i është bërë Shqipërisë.

³ Sondazhi Botëror i Vlerave: www.worldvaluessurvey.org

besimin social, kapitalin social, shtetin ligjor, demokracinë e nënfusha të tjera të ngjashme. Rezultat i këtij kërkimi është krijimi dhe studimi i një arkivi të zgjeruar studimesh të çmuara për fushën tonë të studimit, të cilat kanë ndihmuar si në njohjen e saj ashtu edhe për konsultime metodologjike.

Pjesë e këtij koleksioni janë edhe një numër sondazhesh të kryera në Shqipëri nga organizata të shoqërisë civile lokale e ndërkombëtare të cilat kanë mbuluar çështjet e vlerave, të pjesëmarrjes qytetare, të demokracisë, të korrupsionit, etj.

Një paraqitje e listuar e studimeve më thelbësore të konsultuara, gjendet në shtojcën bibliografike të këtij studimi, ndërsa përgjatë tij janë listuar referenca të shumta të cilat tregojnë shfrytëzimin e materialeve burimore në këtë studim.

3. Në informacione të siguruara nga fokusgrupe dhe intervista me një audiencë të zgjedhur dhe me aktorë të njohur të jetës shoqërore në vend.

Për qëllimet e këtij studimi u organizuan dy fokusgrupe. Fokusgrupi i parë kishte për anëtarësi një numër studentësh të ciklit të dytë (Master) të studimeve në fushën e politologjisë dhe pedagogësh të kësaj fushe. Këtij fokusgrupi iu prezantua një paketë gjetjesh themelore nga studimi i çështjeve të besimit social dhe ndërtimit të shtetit ligjor në Shqipëri. Ky fokusgrup u organizua në muajin janar të vitit 2011. Fokusgrupi i dytë kishte për anëtarësi një numër individësh të shquar të jetës shoqërore në vend: analistë politikë, juristë, akademikë, gazetarë, sociologë. Pjesëmarrësve të këtij fokusgrupi iu prezantuan gjetjet themelore të SBV-së për Shqipërinë dhe, me këtë rast, u siguruan reflektimet e tyre në lidhje me të. Ky fokusgrup u organizua në muajin mars të vitit 2011.

Për qëllimet e grumbullimit të qëndrimeve dhe të interpretimeve të personave kyç të kontekstit tonë në lidhje me çështje themelore të hartimit të ligjeve dhe të administrimit të drejtësisë në vend u krye edhe një numër intervistash. Këto u kryen gjatë muajve mars dhe prill 2011. Gjithësej u kryen tetë intervista me individë të shquar nga sfera akademike e administrative. Atyre iu drejtua një listë pyetjesh themelore që ishin zgjedhur nga një instrument i njohur në nivel evropian, i hartuar nga ekspertët e SIGMA-s dhe që kishin të bënin kryesisht me procedurat dhe problemet në hartimin e ligjit dhe në administrimin e drejtësisë. Versioni i shkurtuar i këtij instrumenti gjendet në shtojcat e këtij raporti studimor.

1.3.2. Analiza e të dhënave

Logjika e përdorur në kryerjen e këtij studimi ka qenë elastike. Kjo është arritur duke kombinuar në një qasje të vetme përdorimin e të dhënave të bazës së të dhënave të Sondazhit Botëror mbi Vlerat për Shqipërinë, me të dhëna të sondazheve të tjera të kryera nga organizata studimore në Shqipëri dhe jashtë vendit, si dhe me fokusgrupe dhe intervista eksplorative me përfaqësues lokalë të jetës sonë shoqërore, administrative dhe akademike. Kjo logjikë e përdorimit të të dhënave të nivelit botëror ka mundësuar përdorimin e elementëve të statistikës deskriptive (për përcaktimin e marrëdhënieve mes variablave të ndryshëm të SBV-së), si edhe analizën cilësore të të dhënave që grumbulluan gjatë fokusgrupeve dhe intervistave. Vëmendje më e madhe i

është kushtuar pikëlidhjeve të të dhënave të SBV-së, të sondazheve lokale dhe të dhënave të fokusgrupeve dhe intervistave.

Variablat më të studiuara në këtë studim janë besimi në përgjithësi, besimi ndaj institucioneve të veçanta, niveli i pjesëmarrjes shoqërore, qëndrimi ndaj familjes, korrupsioni, etj. Studime të mëtejshme mund të bëjnë objekt të tyre më shumë variabla dhe analiza më të hollësishme statistikore, sidomos nëse përfshihen në analiza ndikimi i faktorëve të tjerë socialë e demografikë. Kjo mundësohet nëse zgjidhet të kryhen studime me karakter deskriptiv ose konkluziv.

1.4. Kufizime të studimit

Studimi i lidhjeve ndërmjet besimit social dhe autoritetit të institucioneve është temë madhore dhe komplekse, ndërkohë që objektivat e studimit tonë kanë përmasa relativisht modeste.

Autorët e studimit, janë të ndërgjegjshëm se studimi i marrëdhënieve mes besimit social dhe dukurive të tjera të jetës shoqërore, përfshirë edhe ndërtimin e institucioneve ligjore, do të çojë në rezultate më specifike nëse përdoren metoda më të avancuara statistikore dhe studiohen edhe variacione të besimit/mosbesimit, elemente të cilat në këtë studim nuk janë marrë përsipër.

Duke qenë pjesë të realitetit të këtushëm, i cili siç do të paraqitet edhe përgjatë këtij studimi përmban aspekte të shumta ndaj të cilave nuk mund të mos jemi kritikë, krijohet përshtypja se problematikat e paraqitura janë përjashtimisht problematika të Shqipërisë dhe se vendet e tjera fqinje dhe më tej nuk i kanë këto probleme. Por, siç do të përshkruhet edhe përgjatë studimit, në shumë drejtime, problematikat e Shqipërisë janë tërësisht të krahasueshme me ato të vendeve të rajonit dhe më tej. Prandaj nuk mund të mendojmë se përbëjmë një rast të veçuar e më të ndërlikuar, siç përmendet shpesh edhe me nota dëshpërimi.

Studimi ka karakter eksplorativ dhe si i tillë ai përmban gjithë kufizimet e studimeve të tilla: zbulon çështje e tematika, propozon studime dhe përvijon linja veprimi.

1.5. Përmbledhje ekzekutive e gjetjeve kryesore të studimit

1. Kërkimet e sotme shkencore mbi besimin social e shohin këtë si pjesë përbërëse të kapitalit social bashkë me pjesëmarrjen në rrjete sociale dhe krijimin e normave të reciprocitetit. Ky kapital dhe elementët e tij përbërës janë të lidhur ngushtë me realizimet ekonomike dhe progresin demokratik të një vendi.
2. Besimi social është faktor me rëndësi për progresin në ndërtimin e institucioneve demokratike duke qenë se me lëndën e tij ndërtohen institucionet publike.
3. Studimet e sotme, konsiderojnë se faktorët më të rëndësishëm me ndikim në besimin

social janë: trashëgimia shoqërore, mentaliteti klanor, kujtesa e realizimeve të mëparshme, performanca aktuale e institucioneve publike, korrupsioni i madh dhe i vogël.

4. Vendet që përjetuan eksperiencën e komunizmit kanë problematikë shumë të ngjajshme në lidhje me mënyrën e shfaqjes së besimit social dhe të lidhjeve të tij me faktorët e tjerë.
5. Besimi ndërpersonal dhe ai institucional janë të dy në nivele të relativisht ulëta në Shqipëri. Megjithatë, Shqipëria duket se paraqet nivele të larta besimesh sa i përket rafshit rajonal.
6. Besimi i qytetarëve tek institucionet kombëtare gjatë periudhës së tranzicionit të 20 viteve të fundit paraqet uljengritjet e veta.
7. Besimi në institucionet kombëtare duket të jetë më i ulët sesa besimi në institucionet ndërkombëtare.
8. Besimi ndaj familjes dhe fisit është në nivele relativisht të larta, duke ushqyer një mentalitet klanor, i cili duket se nuk favorizon besimin në institucionet publike.
9. Midis performancës së institucioneve publike, përpjekjeve për të forcuar shtetin ligjor dhe besimit social në institucionet ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë.
10. Ndërtimi i një korpusi të madh ligjor gjatë dy dekadave të fundit, shoqërohet me një problematikë jo të vogël: ka ligje që janë miratuar pa kaluar në një proces të plotë hartimi, konsultimi dhe transparence; procesi i rishikimit të ligjeve mbetet i mangët; mungon ekspertiza dhe kapacitetet e duhura institucionale; ka ligje që nuk i përgjigjen kontekstit tonë; klima herë-herë e tensionuar politike nuk mundëson një proces të arsyeshëm ligjvënies; paanshmëria në zbatimin e ligjit njezh vështirësi të cilat bëhen herë-herë dekurajuese.

2. REZULTATET DHE DISKUTIMI

2.1. Trashëgimia e afërt e besimit social nga periudha moniste

Si shumë vende të tjera të ish-bllokut lindor, Shqipëria në vitet e regjimit komunist hyri në një fazë zhvillimesh të veçanta shoqërore. Kjo është konsideruar një aksident historik. Përshkrimi i kësaj faze përbën një ndërmarrje të ndërlikuar e shumëplanëshe dhe nuk është objekt i këtij studimi. Në vijim do të skicohen shkurtimisht çështja e besimit social dhe e autoritetit institucional gjatë kësaj periudhe.

Shqipëria nuk është vendi i vetëm që adoptoi ideologjinë komuniste dhe e zbatoi atë në të gjitha fushat e jetës. Këtë gjë e kanë bërë edhe një numër vendesh të tjera. Kur merremi me çështjen e besimit social gjatë periudhës komuniste, nuk është fjala posaçërisht për besimin social në Shqipëri, por për besimin social në sistemin komunist në tërësi. Shqipëria ka pasur specifikat e saj në zbatimin e parimeve të ideologjisë komuniste, dhe për këtë është shkruar, por ashtu si edhe vendet e tjera ish-komuniste ajo karakterizohet nga disa fenomene të përbashkëta.

Regjimi komunist adoptoi një teori e cila iu përshtatej liderëve të rinj të pasluftës si dhe aspiratës së një populli të varfër e të shtypur për përparim ekonomik e liri. Atij iu desh të orkestronte një fushatë disadekadëshe të indoktrinimit total, të ngulitjes së besimit në ideologjinë, në udhëheqjen dhe në institucionet e kohës. Thelbi i gjithë procesit të indoktrinimit ishte dhe është i qartë: të rrënjosej me përsëritje, me presion, me kërcënim dhe me ndëshkim, besimi në ideologjinë dhe në çdo gjë që shihej si element i propagandës së kohës.

Regjimi komunist synoi të kultivonte “nënshtetas” që qëndronin nën shtetin e tyre: shteti sipër dhe ata poshtë. Në këtë mënyrë u ndërtua një makinë e madhe dhe e rëndë burokratike me karakter shtypës, me strukturë dhe hierarki të kontrolluar mbi bazën e besueshmërisë politike. Kështu u kultivua frika nga institucionet.

Me këtë përpjekje të sforcuar, u arrit që në një pjesë jo të vogël të njerëzve të kultivohej besimi se “këto punë i di Partia”, se “Partia nuk gabon”, etj. Këto frazeologji të zakonshme të asaj kohe, përmbajnë të vërtetën e indoktrinimit dhe të besimit që njerëzit ia dhuronin Partisë. Në anën tjetër, edhe personat që besonin se “këto punë i di Partia” kishin brenda vetes një rezervë të cilën nuk guxonin ta shprehnin prej frikës se mos etiketoheshin si jo-besues e jo-besnikë.

A ka ekzistuar besimi social si dukuri gjatë periudhës socialiste? Sigurisht që ka ekzistuar. Sipas studiuesve të ndryshëm, ka ekzistuar një tip i caktuar dhe relativisht i përhapur i besimit në institucione. Shteti socialist mori përsipër kontrollin e gjithçkaje. Institucionet detyrimisht që do të merreshin me kompetencat që kishin marrë përsipër. Në këto kushte u kultivua mentaliteti i pritjes nga shteti dhe besimi se ai do të dijë të merret me gjërat me të cilat është caktuar të merret. Po t'i shtohen kësaj rrethane edhe faktet e zgjidhjeve pozitive të një pjese të problemeve që dilnin, atëherë kuptohet se tipi i besimit në institucionet ka qenë një fakt i jetës. Tipi i shtetit paternalist

krijoi tipin e veçantë të besimit institucional. Studiuesja Vasilache, përmend faktin e ndjenjave të ankthit që pushtuan njerëzit pasi shteti i cili i kishte marrë përsipër t'i zgjidhte çështjet vetë u shkërmoq me fillimin e proceseve të zhvillimit të iniciativës së lirë dhe të demokratizimit. Një pjesë e mosbesimit social që është vënë e vihet re gjatë periudhës post-komuniste ka mundësi të lidhet pikërisht me çlirimin e shtetit nga roli i tij i dikurshëm. Krahas këtij besimi institucional, ka ekzistuar edhe njëfarë besimi ndërpersonal. Megjithatë, nuk mund të lihet pa përmendur se që të dyja këto kategori të besimit social kanë pasur dinamikën e tyre përgjatë dekadave të jetës komuniste. Në përgjithësi, me kalimin e kohës, besimi në institucionet erdhi duke rënë, ndërsa njerëzit u bënë më mosbesues ndaj njëri-tjetrit.

Indoktrinimi, burokracia dhe represioni ia arritën të zhvillonin një besim të verbër e fals si edhe një mosbesim në pothuaj çdo gjë të sferës shoqërore. Siç e kanë komentuar edhe shumë studiues të tjerë, gjatë fazës socialiste, në shumë vende u zhvillua një kompleks mosbesimi kryesisht me përpjekjet e apartçikëve të partisë dhe të burokracisë shtetërore. Ndërkohë që nga njëra anë është kërkuar besim te Partia, gjë që është shprehje e kërkesës për besim politik, në anën tjetër, njerëzit janë porositur ndjeshëm të kenë kujdes nga njëri tjetri, të jenë vigjilentë, gjë që është shprehje e kërkesës për besim social e cila zhvillon mosbesim të përgjithshëm. Studiuesja Vasilache ka shkruar se *“për komunizmin është karakteristik mosbesimi i brendshëm”*⁴.

Studiuesja Kaminska ka vënë në dukje se *“... në Poloni dhe në vende të tjera komuniste, logjika centraliste dhe jodemokratike e sistemit gjeneronte ndjesinë se vendimet që ndikonin mbi realitetin merreshin nga politikanë të panjohur të nivelit të lartë dhe se këto vendime nuk ndikoheshin dhe nuk kuptoheshin nga individit dhe mikrostruktura e tij. Kjo çonte në tërheqjen e individëve në një hapësirë të kufizuar sociale dhe në një kohë të kufizuar sociale brenda së cilës mund të ruhej një kontroll i caktuar i zhvillimeve në jetën e dikujt. Nga ana tjetër kjo çoi në dominimin e interesit imediat dhe egoist të mikrostrukturës së dikujt përmbi interesat e komunitetit më të gjerë (Tarkowski & Tarkowska, 1994). Këto kushte favorizuan gjithashtu mentalitetin merr-ç'të-marrësh dhe një përqendrim të vëmendjes në arritjet afatshkurtra”*⁵.

Analiza e procesit të formimit të besimit dhe mosbesimit gjatë periudhës moniste meriton studime të thelluara dhe shumëplanëshe. Këtu, vetëm sa po skicohet në linjat e saj më të përgjithshme, thelbi i dukurisë.

Makineria për të ndikuar mbi njerëzit ka qenë shumë e sofistikuar. Një shembull mbi rolin e medias: Ata që kanë arritur të jetojnë në autokraci dhe në demokraci mund ta bëjnë me lehtësi dallimin e këtij roli. Në autokraci për udhëheqësit dhe institucionet flitej vetëm mirë, ata mbroheshin nga çdo kritikë, ata që guxonin të ishin kritikë ndëshkoheshin. Kjo është një praktikë e njohur. Kësisoj mendohet se, të mbajtur larg syve të publikut, udhëheqësit dhe institucionet e asaj kohe, kanë gëzuar për njëfarë kohe një besim të caktuar. Në autokraci të mësojnë të mos jesh kritik, të mos arsyetosh dhe kur nuk ndodh kështu, të tregojnë se kjo gjë mund të jetë me rrezik. Ndryshe ndodh në demokraci ku udhëheqësit dhe drejtuesit janë shumë të ekspozuar

⁴ Simona. V, “Rebuilding Trust in Post-Communist Romania”, Academy of Economic Studies, Bukuresht, në International Symposium on Cultural Diplomacy 2010, f.4.

⁵ Kaminska Monika Ewa, Bonding Social Capital in a Postcommunist Region, f.769, <http://abs.sagepub.com/content/53/5/758>

në sytë e publikut. Madje disa herë atyre iu bëhen publike edhe gjëra për të cilat publiku nuk nevojitet t'i dijë. Kësisoj, mendohet se duke i mbajtur të ekspozuar në sytë e publikut, ata do të jenë të detyruar ta kontrollojnë mirë sjelljen e vet. Në demokraci, prindërit, shokët dhe media na mësojnë të mos besojmë verbërisht, por përkundrazi, të jemi kritikë dhe vigjilentë. Mjafton të përmendet se ndërsa në autokraci njeriu është i shtrënguar të besojë informacione të pjesshme dhe i penguar të mendojë në mënyrë kritike, në demokraci ai është i shtrënguar të besojë, pasi t'i ketë parë të gjitha informacionet e mundshme dhe të ketë menduar në mënyrë kritike. A është kjo gjë një faktor për të shpjeguar se pse ka kaq mungesë besimi sot? Duket se po. Njeriu tashmë ka fituar të drejtën të jetë mosbesues dhe kritik. Këtë të drejtë e kanë fituar të gjithë, edhe mendjet e shëndosha edhe mendjet e sëmura, edhe ata që kanë interes nga proceset, edhe ata që nuk kanë.

Disa autorë, janë marrë me krahasimin e praktikave të besimit social në shtetet komuniste dhe në diktaturat jokomuniste. Nga Winienci është hedhur ideja se shteti komunist është shumë më i ndryshëm edhe nga shtetet diktatoriale jokomuniste, në kuptimin e kontrollit të plotë politik mbi ekonominë⁶. Duke studiuar të dhënat e SBV-së të valës së tretë të tij (1998-2002), studiuesi Traps, ka vënë në dukje se komunizmi e dëmton besimin e qytetarëve dhe se ky dëmtim është më i madh sesa ai që ushtron shteti diktatorial jokomunist (autokratik)⁷.

Ka shumë mundësi që një pjesë e madhe e përmasës së mosbesimit të sotëm të jetë trashëgimi e periudhës moniste. Këtë e konfirmon edhe fakti se ish-vendet komuniste kanë një trashëgimi të përbashkët dhe të ngjashme nga e shkuara e tyre. Sipas studiuesve Sapsford dhe Abbott qytetarët e shoqërive post-komuniste besojnë më shumë tek të afërmit e tyre dhe miqtë, më pak te njerëzit në përgjithësi dhe kanë shumë më pak besim tek politikanët dhe institucionet⁸.

Ky model besimi/mosbesimi është i shpërndarë krahasueshëmrisht në të gjitha ish-vendet e bllokut lindor.

Pranohet gjerësisht si e vërtetë që regjimi komunist, si kudo në botë, edhe në Shqipëri, prodhoi mosbesim ndaj individëve dhe institucioneve të tij. Ky mosbesim duket tërthorazi edhe në forcën me të cilën u përmbys. Nga ana tjetër, edhe periudha që pasoi rënien e komunizmit duket se përmban praktika që mbajnë të gjallë një nivel të ulët të besimit social dhe që e kultivojnë atë më tej. Si komunizmi ashtu edhe post-komunizmi kanë ndikimet e tyre përmbi besimin social.

Shqipëria e ditëve tona ka kaluar edhe eksperiencën e komunizmit, një sistemi që nuk ishte i interesuar nëse njerëzit besojnë apo jo (që të besonin u përdor një fushatë e paparë indoktrinimi), por më shumë të ishin të dëgjueshëm; ai nuk ishte i interesuar në angazhimin e lirë dhe për këtë arsye ndaloi me ligj organizimin e lirë të njerëzve përfshirë këtu edhe iniciativën e lirë.

⁶ Cituar në "Communism and trust" nga Lenny Traps "Journal of politics and international affairs", Pranverë 2009, f.65.

⁷ Po aty, f.67.

⁸ Sapsford R, Abbott, P., "Trust, confidence and social environment in post communist societies", Frontiers of sociology, Sweden, 2005. f.14.

2.2. Rëndësia e studimit të besimit social

Kalimi nga totalitarizmi në demokraci u shoqërua, në të gjitha vendet evropiane, me disa fenomene të panjohura më parë prej shoqërisë së këtyre vendeve si papunësia, emigracioni, krimi, prostitucioni, droga, ndotja ekologjike e konfliktet sociale, tensionet politike. Këto fenomene të reja e pjesërisht të reja, kanë prodhuar e prodhojnë me shumicë varfëri, migracion, krim, divorc, aditivitet, humbje dhe, përveç këtyre, ndjesi stresesh, ankthesh, frike, pasigurie e mosbesimi.

Shkencat tona sociale nuk ishin të përgatitura për të ndihmuar sa duhej në këtë proces. Ato nuk kanë trashëguar eksperiencë të mjaftueshme në trajtimin e këtyre fenomeneve, veçanërisht të atyre shpirtërore. Periudha që po kalojmë me një tranzicion të gjatë e të lodhshëm është, në këtë këndvështrim, periudha e depresionit tonë të madh: ndjehemi se i kemi duart të lidhura ngase nuk dimë se çfarë të bëjmë me gjithë këto halle. Ky kompleks i madh fenomenesh negative (dhe shumë faktorë të tjerë, disa prej të cilëve do të cekem më tej) ka dëmtuar mjaft aftësinë e njerëzve për të besuar.

Tronditja ose dëmtimi i besimit përbën fenomenin social më të madh të jetës shpirtërore shqiptare. Për fat të keq, kjo tronditje duket se ka pasuar një fazë të parë të një entuziazmi të lartë, të një besimi dhe të një optimizmi të shënuar, i cili shoqëroi shkatërrimin e sistemit të vjetër dhe fillimin e instalimit të demokracisë pluraliste, të ekonomisë së tregut dhe të lirisë së ndërgjegjes.

Një nivel i caktuar besimi dhe mosbesimi mesa duket është i nevojshëm për funksionimin e shëndetshëm të ekonomisë, të politikës dhe të shoqërisë. Karakteri i jetës në një shoqëri demokratike na shtyn të bashkëpunojmë me persona të cilët nuk i njohim që më parë. Që të bashkëpunosh në mënyrë të frytshme me ta, është e nevojshme të kesh besim në ta. Në këto kushte, mbetet një çështje e rëndësishme ajo se çfarë është besimi. Çfarë tiparesh, qëndrimesh, kushtesh e prodhojnë dhe e pengojnë besimin në ata të cilët ne nuk i njohim personalisht?

Në shoqërinë tonë që përpiqet të jetë demokratike, duket sikur niveli i besimit ka rënë deri në atë pikë sa ka zëra që thonë se ne jetojmë njëherësh edhe një krizë besimi. Pra vuajmë nga ajo që njerëzit janë mosbesues. Dhe me njerëz mosbesues nuk ecën dot me lehtësi as ekonomia (se 'të vjedhin'), nuk ecën dot as policia (se kolegu mund të të dekonspirojë), nuk ecën dot as politika (se deputeti yt bëhet me palën kundërshtare). A ka të bëjë ky besim i ulët me cilësinë tonë si njerëz, apo ka bëjë me faktin se ai që nuk shërbehet e ka të vështirë t'i besojë atij që duhet të shërbejë? Ne nuk besojmë shumë pasi i shkelim njëri tjetrit të drejta të çmuara dhe sajojmë lëndime të cilat nuk lënë të shihet përtej plagës së formuar. A është ky besim i ulët produkt i zhvillimeve të dekadave të fundit, apo kemi të bëjmë këtu edhe me një trashëgimi sociale të kultivuar historikisht? A duhet t'ja kesh frikën qeverisë otomane të mesjetës apo duhet t'ia kesh edhe qeverive të sotme moderne shqiptare? Mesa duket, ne jemi të kapur në një kompleks besimi/mosbesimi. Mesa duket rrënuese mund të jenë njëloj edhe forcat natyrore, edhe forcat shoqërore. Trashëgimia shekullore e qeverive që të djegin si zjarri, ndërhyjnë edhe në qëndrimet e ditëve tona.

Mund të thuhet se çështja e besimit, e mirëbesimit dhe e mosbesimit janë gjithashtu çështjet më të mëdha të psikologjisë sonë kombëtare dhe shoqërore. Dihet se fuqia ndërtuese e njerëzve që nuk besojnë në atë që bëjnë është e dyshimtë: metafora e Kalasë së Rozafatit që ndërtohet

ditën dhe shkatërrohet natën, duket si një shembull interesant i forcës ndërtuese të besimit dhe i forcës shkatërruese të mosbesimit.

Çështja e besimit dhe e mosbesimit mund të shihet në dy optika. Optika e parë është humbja e besimit në udhëheqësit dhe në institucionet e periudhës së autokracisë. Fundi i shekullit e gjeti vendin tonë me shumë shkatërrime (madje ndoshta më të mëdha se ato të Luftës II Botërore), por shkatërrimi më i madh që na ka ndodhur, është shkatërrimi i besimit. Shqiptari u indoktrinua me idenë se shteti i mirëqenies nuk ishte larg dhe pas një gjysme shekulli çdo gjë u shemb. U shemb edhe besimi te ëndrra edhe besimi te udhëheqësit. Rezultat i kësaj është se shqiptari i sotëm e ka të vështirë të besojë tek polici dhe tek oficeri, tek gjykatësi dhe tek nëpunësi, tek kleri e tek politikanët, tek partitë dhe tek kompanitë. Ai e ka të vështirë të besojë edhe tek vetja. Duket sikur me këtë nivel të ulët të ndjenjës së besimit, është e vështirë të ndërtohet ajo që ne e aspirojmë si popull për ardhmërinë tonë, madje është e vështirë të ruhet edhe ajo që tashmë e kemi.

Optika e dytë është ajo e rivendosjes së institucionit të besimit në shinat e tij të natyrshme: të besojmë ato që na shohin sytë dhe të mos lëmë të na hedhin hi syve. Pra, të mos u dhurojnë besim të verbër as udhëheqësve e as institucioneve, dhe të gjykojmë në bazë të fakteve. Në këtë optikë, jeta është bërë sigurisht më e ndërlikuar: ne jetojmë në ndërtesa e lagje ku ka plot të tjerë të cilët nuk i njohim më si më parë, ne kemi lidhje biznesi me të panjohur, neve na duhet të bashkohemi në çështje të caktuara me njerëz që interesat e tyre i lidhin me ne, adoleshentët komunikojnë virtualisht me persona që shumë herë paraqiten me identitete të fabrikua. Ne kemi vënë re se si individë e institucione na zhgënjëjnë me veprimtarinë e tyre dhe na japin mësimin e të qenit më vigjilentë.

Në këtë kontekst, të nevojës për besim social (që të zhvillohemi) dhe nevojës për një nivel të caktuar mosbesimi (që të mos dëmtohemi), shkencat humane kanë mision të punojnë për ringjalljen e besimit në historinë tonë e në vlerat nacionale, në veten e në njeri-tjetrin, në institucionet dhe në proceset e forcimit të shtetit. Ne, siç duket, kemi nevojë për një psikologji më optimiste, pozitive e konstruktive, pasi pesimizmi, negacioni e destruktivizmi kanë fituar terren ndër vite.

2.3. Koncepti mbi besimin social dhe autoritetin e ligjit

Tradicionalisht, niveli i zhvillimit shoqëror është parë i lidhur me nivelin e zhvillimit të forcave prodhuese. Kjo traditë zgjati gati gjysmë shekulli nën ndikimin e teorive materialiste dhe posaçërisht Marksiste. Kjo pati ndikimet e veta edhe në mendimin sociologjik të vendeve të perëndimit.

Sot, disa dekada nga rënia e komunizmit, ajo që vihet re është se koncepti i forcave prodhuese nuk e shpjegon dot tërësisht gjithë ndikimin njerëzor në nivelin shoqëror dhe ekonomik të shoqërisë. Në këtë vështrim është ndërtuar koncepti i kapitalit social. Ky koncept shpreh, më shumë se koncepti i forcave prodhuese, ndikimin që kanë në shoqëri, në institucionet dhe në proceset, vetë njerëzit që e përbëjnë atë shoqëri.


Çështja e kapitalit social në dekadat e fundit është studiuar dhe studiohet edhe nga këndvështrimi sociologjik edhe nga ai politologjik. Kontribuesit kryesorë në këtë drejtim janë Pierre Bourdieu, James Coleman, Frensis Fukuyama dhe Robert Putnam. Të katër këta autorë, shohin në konceptin e kapitalit social marrëdhëniet mes njerëzve dhe vlerat aktive në këto marrëdhënie. Kapitali social shihet sot si një ndër faktorët kryesorë të përparimit ekonomik, të zhvillimit rajonal, të një qeverisjeje demokratike dhe të angazhimit kolektiv.

Cila është përmbajtja e konceptit të kapitalit social? Sipas autorëve më të shquar në këtë drejtim, kapital social konsiderohen tërësia e lidhjeve të njerëzve me njëri tjetrin, tërësia e normave që lindin dhe mbajnë këto marrëdhënie dhe besimi në palën tjetër.

Studiuesit më të njohur botërisht të kapitalit social dhe të dukurive të lidhura me të janë Bourdieu, Putnam, Coleman dhe Fukuyama. Pas tyre në studimin e çështjeve të kapitalit social, besimit social, angazhimit qytetar dhe krijimit të normave të reciprocitetit si edhe të një numri të madh faktorësh të tjerë janë reshtuar një numër jo i vogël kontribuesish.

Ekuacioni kryesor dhe e përbashkëta e këndvështrimit të Bourdieu, Putnam, Coleman dhe Fukuyama është si më poshtë: *“Kapitali social është dukuri që karakterizon besimin e njerëzve te njëri tjetri, prirjen për t’u bashkuar me ta në grupe e rrjete të caktuara dhe zhvillimin përmes bashkëpunimit të normave vlerore të reciprocitetit. E gjithë kjo energji njerëzore, çon në realizime ekonomike më të larta dhe në një rend demokratik i cili karakterizohet nga institucione që funksionojnë mbi bazën e ligjit.”*

Figura 1: Skemë përmbledhëse e trajtimit teorik të konceptit kapital social dhe përbërësve të tij.



Kërkimet shkencore në fushën e kapitalit social kanë zbuluar lidhje të shumta të përbërësve të tij me përparimin ekonomik në nivel lokal, rajonal e ndërkombëtar, me pjesëmarrjen aktive

qytetare sociale e politike, me luftën kundër korrupsionit dhe me veprimtarinë e institucioneve. Ato kanë zbuluar gjithashtu lidhje të forta të pjesëmarrjes qytetare dhe ndërtimit të institucioneve demokratike si edhe rolin e sistemeve të vlerave në drejtim si të përparimit ekonomik, ashtu edhe të ndërtimit të një demokracie funksionale.

Ekuacioni i kapitalit social sipas të cilit besimi në përgjithësi të tjetri të shtyn të bashkëpunosh me të tjerë duke qenë pjesëmarrës dhe të formosh sisteme të përbashkëta vlerash, është me rëndësi të shënuar për të kuptuar dhe përmirësuar atë çfarë mund ta bëjmë si shoqëri për përmirësimin e punëve tona.

Në këtë këndvështrim përbërësit e kapitalit social janë që të gjithë të rëndësishëm për një demokraci funksionale. Çështje të tilla si studiuues të ndryshëm u njohin peshë të ndryshme këtyre përbërësve: Putnam i kushtoi më shumë rëndësi organizimit dhe pjesëmarrjes qytetare në rrjete vullnetare⁹, Fukuyama i kushtoi më shumë rëndësi besimit social dhe Bourdieu dhe Coleman i kushtuan më shumë rëndësi normave të reciprocitetit¹⁰. Se cili prej këtyre përbërësve ka më shumë peshë, kjo ende mbetet një çështje në diskutim.

Gjithsesi, instinkti social i çdokujt mjafton për të pranuar se çdonjëri prej këtyre tri përbërësve të përmendur luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e një demokracie ku institucionet veprojnë mbi baza ligjore edhe kur merret i veçuar edhe kur ai shihet i lidhur me dy përbërësit e tjerë.

Ajo që ne e shohim dhe e dëgjojmë përditë, është se na është dëmtuar pjesëmarrja qytetare, nuk angazhohemi sa duhet dhe se na mungon aktivizmi i nevojshëm për të ndërprerë atë që nuk funksionon dhe për të denoncuar atë që funksionon keq. Shenjë e dukshme e dëmtimit të nervit për pjesëmarrje qytetare, është rënia e interesimit dhe e pjesëmarrjes në çështjet publike, fryma e theksuar e individualizmit, kujdesi për interesat ngushtësisht private dhe neglizhimi i interesave që janë publike. Shoqëria kompakte dhe harmonike është e lidhur ngushtë me pjesëmarrjen qytetare. Pjesë e programit qeverisës të qeverisë aktuale britanike, e cila bazohet në koalicionin konservator e liberal demokrat është një fokus i qartë në forcimin e pjesëmarrjes komunitare nëpërmjet dhënies së më shumë kompetencave pushtetit lokal, mbështetjes së iniciativave komunitare, etj.

Kutia 1: Përsëri punë vullnetare?

Në kohët tona vihet re se shpesh është mjaft e vështirë të ngjallet dhe të aktivizohet një element i njohur i jetës sociale të njerëzve, siç është *vullnetarizmi*. Ne shqiptarët kemi bërë shumë punë vullnetare. Aq sa na ka ardhur në majë të hundës nga ajo. Tani, kur na kërkohet sërish të bëjmë një punë të tillë, ne reagojmë negativisht: nuk duam t'i a dëgjojmë as emrin dhe e quajmë vullnetarizmin një element të komunistit. Nuk kemi faj: ne kemi bërë një *punë vullnetare të detyruar*, ne kemi bërë punë vullnetare për të mbuluar deficitet e punës së paguar. Pra kemi bërë punë të papaguar *për të mbuluar mosrealizimet e punës* të cilën na e kanë paguar. Në të dyja rastet ajo nuk ka qenë punë vullnetare. Tani, kur gjithkush ka liri të shohë interesin e vet, pjesëmarrja në punë vullnetare është me të vërtetë vullnetare, diçka e bërë me vullnetin e lirë të personit, pa imponime. Siç duket, vullnetarizmi nuk është

⁹ Paldam Martin & Svendsen Gert Tinggaard, "Missing social capital and the transition in Eastern Europe", Department of Economics, University of Aarhus, (second author) Department of Economics, Aarhus School of Business, f.4.

¹⁰ Martin Raiser, Christian Haerpfer, Thomas Nowotny and Claire Wallace, Social capital in transition: a first look at the evidence, World Bank for reconstruction and development, f.31.

një element i komunizmit, por i demokracisë. Fakti që tani në fillimet e demokracisë është e vështirë të shfaqet në shpërthimin e vet ky element, tregon se nëse njeriut i imponohet të shfaqë vullnetarizëm goftë edhe për të mirën e përgjithshme, atëherë ai lloj vullnetarizmi i imponuar e pengon atë të shfaqë edhe spontanisht dëshirën për t'u shërbyer të tjerëve, bashkësisë, pa u imponuar nga askush. Rrethana e dytë e shpjegimit të këtij fenomeni është ajo që tani në Shqipëri është lejuar të veprojë iniciativa e lirë. Ajo vepron me agresivitetin që shpërthen një energji e ndrydhur për shumë dekada¹¹.

Vlerat që ne çmojmë reciprokisht janë gjithashtu në një periudhë tranzicioni: kanë rënë e do të bien vlera të dikurshme, dhe do të zëvendësohen e modifikohen ato me të tjera. Ky proces ecën më ngadalë, por gjithsesi kuptimi i ekonomisë së tregut si liri për të vjedhur, është krejt në kundërshtim me vlerën se ekonomia e tregut është liria për të përfituar maksimalisht nga puna personale. Besimi social: ai trajtohet gjerësisht në gjithë këtë studim.

2.3.1. Koncepti dhe burimet e besimit social

Koncepti i besimit social është një koncept kyç dhe shumë i diskutuar kohët e fundit. Besimi social është një dukuri e ndërlikuar ku ndërthuren aspekte kognitive, afektive, sjellore; racionale e irracionale; aktualiteti dhe trashëgimia. Kjo është një çështje në studim e diskutim të vazhdueshëm. Mbi të gjitha, besimi social është një vlerë¹². Koncepti vlerë, në kulturën tonë nuk ka ekzistuar dhe po përdoret vetëm dekadën e fundit nga intelektualë me formim perëndimor ku ky term është pjesë jo vetëm e leksikut akademik, por edhe e shoqërisë civile dhe e përdorimit më të gjerë. Koncepte të tjera të përafërta me të janë morali, qëndrimet, zakonet.

Koncepti, ose konstrukti, i besimit social përbën një kategori të ndërlikuar dhe pak të studiuar. Megjithatë, ata që e kanë studiuar, mbështeten në këndvështrimin e psikologëve dhe e shohin atë si një konstrukt psikologjik i cili shpreh një predispozicion të brendshëm të njeriut për të vepruar në drejtime, me persona e konstrukte, të cilat perceptohen si të parrezikshme. Ky predispozicion formohet që herët në jetë, kur zhvillohen atashimet e para me figurat e rëndësishme për personin dhe, më vonë nën ndikimin e eksperiencave që kanë të bëjnë me sigurinë dhe pasigurinë. Rezultat i kësaj është formimi i një predispozicioni i cili shtrihet në vazhdimësinë besim-mosbesim dhe në të cilin çdokush zë një pozicion të vetin.

¹¹ Tamo, A., "Edukimi i qytetarisë demokratike në shkollën fillore", f.98, 2000

¹² Vlerat janë konstrukte subjektive, personale e sociale, që formohen nën ndikimin e faktorëve të shumtë individualë e grupalë përgjatë jetës së individëve dhe bashkësive. Ky përkufizim është një përkufizim operacional, pra për të operuar, dhe nuk ka pretendim shkencor. Sipas Van Deth dhe Scarbrough (cituar në "Religion, democratic values and political conflict, Festschrift in Honor of Thorleif Pettersson", f.316) Ekzistojnë më shumë se 180 përkufizime për konceptin vlerë. Kjo gjë, tregon larminë kuptimore për këtë konstrukt njerëzor. Vlerat, ndryshe nga opinionet dhe sjelljet shoqërore, kanë një qëndrueshmëri më të madhe. Si rregull, në periudha kthesash shoqërore vlerat ndryshojnë më me shpejtësi sesa në periudha relativisht të qëndrueshme zhvillimi. Karakteri relativisht i qëndrueshëm i vlerave është pikënisja e bazimit të këtij studimi në të dhënat e SBV-së, i cili për Shqipërinë përmban të dhëna deri në vitin 2006. Pra, pavarësisht se të dhënat paraqesin sistemin e vlerave para një dekade, ato merren përgjithësisht si të vërteta dhe aktuale edhe në këtë dekadë. Qëndrueshmëria relative e vlerave është një e vërtetë e pranuar. Në anën tjetër nuk mund të neglizhohet edhe një e vërtetë tjetër: jo të gjitha vlerat kanë të njëjtën qëndrueshmëri e të njëjtën dinamikë. Disa vlera janë më të qëndrueshme dhe disa më dinamike.

Ne e dimë se në bashkëveprimet me të tjerët do të ndikojmë mbi ta dhe do të ndikohemi prej tyre. Pëlqimet tona personale janë që në këto bashkëveprime të mos dëmtohemi. Në këtë kuadër besimi shihet si një mekanizëm me të cilin ne e nisim bashkëveprimin me sigurinë se nuk do të dëmtohemi gjatë bashkëveprimeve tona. Autorë të tillë si Wolfe e shohin besimin në tri nivele: në nivel individual, besimi është karakteristika e individit që nuk shikon dëmtim të mundshëm dhe që ka kurajo për të ndërmarrë bashkëveprime; në nivelin e marrëdhënieve shoqërore besimi shihet si një cilësi e nevojshme për të arritur qëllime grupale; në nivelin e një sistemi të tërë shoqëror, besimi shihet si një vlerë të cilën e mbështet i gjithë sistemi shoqëror. Këto tri nivele janë të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin. Kështu, mund të hasim persona që besojnë ose nuk besojnë te dikush a diçka, por që besojnë te një kompani, ministri ashtu siç mund të hasen persona që kanë më shumë besim te një biznesmen që vjen nga Holanda, sesa tek një që vjen nga Italia.

Me pak fjalë, besimi social është siguria se nuk do të dëmtoheni nga bashkëveprimet në të cilat hyjmë. Ky përkufizim është operacional: ai e shpreh kuptimin mbi besimin me anë të kuptimit mbi sigurinë. Askush nuk e ka në dorë të jetë besues ose mosbesues, megjithëse të gjithë jemi të tillë: besues në një rast dhe mosbesues në një rast tjetër. Disa janë të prirur të jenë më shumë besues e disa mosbesues. Si rregull priremi të jemi më shumë besues ndaj një pale tjetër, bazuar në besimin tonë në përgjithësi, në perceptimin që kemi për palën tjetër, në faktet e bashkëpunimit tonë të deritanishëm, në historinë e bashkëveprimeve tona, në kujtimet që kemi, etj. Si rregull, besimi formohet më shumë në bashkësi të vogla, të mbyllura dhe homogjene.

Studiuesit e kohës sonë e kanë parë besimin social të lidhur me faktorët individualë: disa individë dhe disa popuj priren të jenë më besues se disa të tjerë; e kanë parë të lidhur me faktorë socialë: disa shoqëri kanë pjesëmarrje dhe organizim më të lartë civil se disa shoqëri të tjera. Në këtë përpjekje do të vihet në dukje se çështja e besimit social është e lidhur sa me faktorët individualë aq edhe me ata socialë: niveli i besimit është lidhur ngushtë me atë se çfarë niveli besimi/mosbesimi na ka injektuar konteksti ku jetojmë. Me këtë nivel besimi, ne bazojmë institucionet që arrijmë të ndërtojmë. Niveli i besimit është i lidhur ngushtë edhe me atë se çfarë bëjnë institucionet sociale që ne t'u besojmë apo mos t'u besojmë atyre.

Në këtë sens, mund të thuhet se janë demokratë ata që ndërtojnë institucione demokratike, në atë masë që institucionet demokratike prodhojnë demokratë. Institucionet e strukturojnë informacionin si e mendojnë ata vetë. Ata shkëmbejnë aq informacion sa u shërben atyre vetë dhe përcaktojnë rregulla e sanksione. Në këtë kuptim, ata përcaktojnë edhe një pjesë të sjelljes së individëve. Nëse ti më ndëshkon po të ndërtoj pa leje, unë nuk jam më i prirur të ndërtoj pa leje. Në këtë mënyrë institucionet sociale nxisin sjellje komformiste, individuale dhe besim. Por, nëse qytetarët ndjejnë se nuk trajtohen drejtësisht nga autoritetet ose institucionet, ata zhvillojnë mosbesim në institucionet dhe në të gjithë të tjerët. Nëse një palë e shoqërisë nuk ka besim në palën tjetër, përse pala e dytë duhet të ketë besim në të parën? Ne hyjmë kështu në gjeratoren e ndërlikuar të vuajtjes nga ai fat që e ndërtojmë vetë. Kështu jemi të kapur në çarkun social: bëjmë atë që na leverdis individualisht ose institucionalisht në çast, dhe në një çast tjetër do të ankohe mi për faktin që pala tjetër po bën ndaj nesh atë që ne kemi bërë dikur, dhe e cila tani nuk na leverdis. Dhe faktin do ta quajmë fat. Dhe do ankohe mi për fatin kur duhet të ankohe mi për

faktin. Dhe kështu fakti do të bëhet fat i përbashkët. Dhe kështu do ta mallkojmë fatin, faktin që kemi lindur këtu, që kemi këtë gjuhë, që kemi hero Skënderbeun, që kemi shpallës të pavarësisë kombëtare Ismail Qemalin, që kemi këtë udhëheqës apo atë tjetrin, etj.

Një studiues ka bërë pyetjen e rëndësishme nëse mund të krahasohet besimi në një person me besimin në një institucion. Sigurisht që këto lloj besimesh nuk janë e njëjta gjë, por edhe një lidhje duket ta kenë. Në përpjekje për t'i shpëtuar shikimit ndarazi të besimit ndërpersonal me besimin në institucionet, në vijim do të përpiqem t'i shoh të lidhura këto dy gjëra duke vënë në dukje të dhëna që burojnë nga Sondazhi Botëror mbi Vlerat.

Besimi social përbën, mesa duket, një faktor esencial për formimin e insitucioneve që kanë autoritet dhe që performojnë në dobi të qytetarëve. Por krahas kësaj, serioziteti i punës dhe performanca e insitucioneve kanë një ndikim të dukshëm në zhvillimin e besimit qytetar.

2.3.2. Marrëdhëniet e besimit social me kapitalin social

Besimi shihet nga studiues të ndryshëm si një mekanizëm që mbështetet në marrëdhëniet shoqërore, në normat që krijohen në strukturat e këtyre marrëdhënieve, dhe në institucionet shoqërore¹³. Çështja e besimit social shihet si një çështje e rëndësishme në proceset shoqërore. Që njerëzit të mund të arrijnë objektiva bashkarisht, ata duhet të jenë të lidhur me njëri tjetrin dhe që të jenë të lidhur me njëri-tjetrin, ata duhet ta njohin dhe të kenë besim te njëri-tjetri. Besimi, rezulton të jetë një faktor i rëndësishëm në përpjekjet e përbashkëta për arritjen e ëllimeve të përbashkëta. Kjo formulë duket e thjeshtë por nuk është kështu: kush na garanton se edhe tjetri do ta dojë qëllimin e përbashkët siç mund ta dua unë, kush na garanton se ai tjetri nuk do ta shfrytëzojë përpjekjen e përbashkët për përfitime personale, kush na garanton se ai tjetri nuk do të na mashtrrojë? Pra, që njeriu të zhvillojë besim te tjetri, nuk është e lehtë. Mirëpo, pa besim social nuk mund të kesh kapitalit social: njerëzit nuk lidhen me njëri tjetrin dhe nuk zhvillojnë norma.

Zhvillimet e dekadave të fundit në fushat e sociologjisë, politologjisë dhe psikologjisë sociale në vendet e përparuara na tregojnë se zhvillimi demokratik është shumë i lidhur me kapitalin social, element thelbësor i të cilit është besimi social. Besimi social është një kusht zhvillimi për një shoqëri moderne, të hapur, është kusht për një shoqëri inkluzive, është kusht për rritjen e investimeve, është kusht për rritjen e ndjenjës së lumturisë dhe të mirëqenies.

Siç do të trajtohet dhe gjetiu, çështja e kapitalit social, ashtu siç është formuluar nga teoricienët që janë marrë me të, por edhe nga studiuesit aplikativë, ka të bëjë me grupet dhe rrjetet, me besimin dhe solidaritetin, me veprimin kolektiv dhe bashkëpunimin, me informimin dhe komunikimin, me kompaktësinë sociale dhe përfshirjen, me veprimin politik¹⁴. Marrëdhënia midis besimit dhe kapitalit social shihet në mënyra të ndryshme. Disa studiues e shohin besimin si një parakusht për të pasur kapital social, ndërsa disa të tjerë e shohin atë si një produkt të kapitalit social.

¹³ Coleman. James, cituar në "Social Capital in Post-Communist Societies: Running Deficits?", artikull i Olena Nikolayenko, University of Toronto.

¹⁴ Nora Dudwick, Kathleen Kuehnast, Veronica Nyhan Jones, and Michael Woolcock, "Analyzing social capital in context: A Guide to Using Qualitative Methods and Data", World Bank Institute Washington, D.C. Copyright © 2006 The International Bank for Reconstruction and Development/The World Bank 1818 H Street, N.W. Washington, D.C. 20433, U.S.A.

E vërteta është se ekziston një paqartësi jo e vogël në lidhjen mes kapitalit social dhe besimit social. Në fakt nuk ka një mirëkuptim të përgjithshëm përse i përket çështjes nëse besimi është kusht për kapital social [siç mendojnë Coleman (1988), Putnam (1993), dhe Fukuyama (1995)], apo nëse besimi është produkt i kapitalit social [siç mendon shkencëtari Field (2003)]. Pra a duhet të kemi besim, që të kemi edhe kapital social, apo duhet të kemi kapital social, që të kemi besim, apo ato kushtëzojnë reciprokisht njëri-tjetrin?

Ata që e shohin besimin si parakusht të kapitalit social, pohojnë se marrëdhëniet, bashkësitë, bashkëpunimi, angazhimi etj., që karakterizojnë kapitalin social, nuk do të ekzistonin nëse mes njerëzve nuk do të kishte një nivel të caktuar besimi. Kësisoj mendohet se pa besim nuk ka kapital social. Nga ana tjetër studiuesit që mendojnë se besimi është produkt i kapitalit të caktuar social, mendojnë se besimi është produkt i marrëdhënieve dhe se, si produkt i tyre, ai është edhe produkt i vetë kapitalit social.

Sido që të jetë, mesa duket marrëdhënia midis besimit dhe kapitalit social duket të jetë një marrëdhënie e ndërlikuar, si për implikimet e shumta që ajo ka në jetë, ashtu edhe për ato që lidhen me studimin e saj. Kjo do të thotë se për të priten studime të mëtejshme shkencore. Por gjithsesi ajo është një marrëdhënie e rëndësishme për proceset shoqërore në të cilat siç vërehet, kapitali social dhe besimi social luajnë një rol me peshë.

2.3.3. Shteti ligjor, autoriteti i ligjit, autoriteti institucional

Megjithëse studimi në fjalë nuk do të merret posaçërisht me çështje me karakter teorik, për nevoja të tij do të përshkruhen kuptimet në të cilat do të përdoren më tej këto koncepte. Vëmë në dukje se këto koncepte janë përkufizuar në mënyrë operationale, megjithëse janë bazuar në dokumente juridike.

Shteti ligjor nënkupton qeverisjen nëpërmjet ligjeve dhe rregullave të përcaktuara dhe të njohura paraprakisht. Ky përcaktim që më parë i rregullave dhe kjo njohje publike e tyre e bën të mundur që shtetasit ta dinë që më parë se si do të veprohet dhe në këtë mënyrë ata parashikojnë edhe veprimet e tyre. Në këtë kuptim, është e vërtetë ajo se në kuptimin e shtetit ligjor modern sundon ligji dhe jo personat që e administrojnë atë¹⁵.

Autoriteti i ligjit është ndjesia se ligji duke qenë i vendosur mbi parimet e drejtësisë është neutral dhe nuk mban anën e një pale në dëm të palës tjetër. Si neutral, ai qëndron mbi palët dhe shihet me respekt prej tyre. Por, kur ligji ndjehet se është vjetëruar, se e ka humbur neutralitetin, se mban më shumë anën e një pale në dëm të palës tjetër, ai e humbet autoritetin: shtetasit fillojnë ta shkelin dhe ta përqeshin atë.

¹⁵ Shih G.Elezi "The rule of law in post-communist Albania", University of Sussex, United Kingdom, f.7.

Kutia 2: Diskutim për shtetin ligjor në dyqanin e djathit¹⁶

Duke diskutuar për çështjen e shtetit ligjor disa e morën seriozisht dhe u përfshinë në diskutim, disa të tjerë nënqeshën, një grup i tretë filloi të bënte qyfyre.

Dikush pyeti: a e keni fjalën për shtetin ligjor apo për shtetin maliqor? Këto janë dy lloje të ndryshme shtetesh. E kemi fjalën për shtetin që dëshiron të jetë shtet ligjor dhe ku Maliqi të mos dalë mbi ligjin.

Shteti ligjor sipas meje është një shtet i drejtë në kuptimin që zbaton ligjin për të cilin kemi rënë dakord të gjithë, që e përmirëson atë nëse ligji e humbet fuqinë për të qenë i drejtë për të gjithë, që nuk lejon njeri të dalë përmbi vullnetin e tij, që e sheh ligjin si rrugën e vetme të sigurtë për mirëqenie.

Sipas meje ka edhe një shtet tjetër, që është shteti maliqor. Shteti maliqor është shteti ku një individ ose një grup përdor forcën për të imponuar një ligj që i shërben më shumë disave, një shtet që nuk e ndryshon ligjin nëse ndryshimi nuk i shërben atij individit ose grupit, një shtet ku lihen hapësira që dikush të dalë përmbi vullnetin e ligjit, një shtet ku rruga e pëlqyer për të arritur mirëqenie është shfrytëzimi i mundësive cilatdo që të jenë ato.

A e ndërtojmë dot ne një shtet të tillë? Ne mund ta ndërtojmë këtë shtet me një kusht: të mos kemi kushurinj. Se kushurinjtë e prishin shtetin. Ne jemi fshat i vogël. Dhe në fshat ka shumë kushërinj. Mirëpo kushërit nuk ia prish dot qejfin se prishesh pastaj me të. Dhe po u prishe me kushërinin nuk lidhesh dot më shumë me atë tjetrin që nuk e ke gjë. Kushëriti është kushëri. Shqipëria është fshat i vogël me shumë kushërinj. Për ne kushëriti është gjë e madhe. Po gjë e madhe është edhe ai që unë e njoh. Prandaj kur të më vijë në dyqan një kushëri ose një njeri të cilin unë e njoh, unë do t'i shërbej më parë kushëritit dhe atij të njohurit. Pastaj të tjerëve. A është ky favoritizim? Patjetër që kushëriti favorizohet.

Kuptimi i kushëritit që favorizohet në dëm të atij që nuk e kam gjë? Unë i shërbej atij që njoh. Me atë që nuk e njoh unë nuk kam shumë punë. Të presë radhën që të blejë djathin e vet. Unë i shërbej atij kushëritit tim, mikut, atij që e kam nga fshati, atij që e kam në partinë time. Këta do ma shpërblejnë nderin që u bëj. Po sikur të mos ma shpërblejnë? Yti mishin mund të ta hajë, por kockën do të ta ruajë.

Në mënyrën më të qartë epërsinë e sistemit socialist përmbi ligjin e ka shprehur njëri nga presidentët e parë të Gjykatës së Lartë të BRSS, i cili në vitin 1927 ka shkruar se “komunizëm do të thotë jo thjesht fitore e ligjeve socialiste, por fitore e socializmit mbi çdo ligj”¹⁷. Kuptimi i kësaj direktive komuniste duket qartë me suspendimin për disa dekada të Ministrisë së Drejtësisë në Shqipërinë komuniste.

Autoriteti institucional nënkupton ndjesinë se institucioni gëzon autoritet të mjaftueshëm përmbi qytetarët dhe njëherësh edhe respektin e tyre për veprimtarinë që kryen. Kuptimi i shtetit ligjor në lidhje me qytetarët të cilëve ky u shërben, është formimi i një kornize rregullash dhe përzgjedhja e personave të zotë për të pikasur shkeljet e rregullave, për të vënë përpara përgjegjësisë ligjore shkelësit dhe për të mbrojtur kështu rendin e vendosur. Shteti ligjor detyron qytetarët të paguajnë taksat dhe zyrtarët t'i administrojnë mirë ato. Siç do të shihet kjo alternativë, edhe pse duket me vend dhe logjike, nuk është kaq e lehtë që të zbatohet. Ku t'i gjesh policët dhe gjyqtarët aq të

¹⁶ Diskutim i zhvilluar pjesërisht gjatë fokugrupit të dytë, mars 2011.

¹⁷ Cituar nga Elezi G. në “The rule of law in post communist Albania”, University of Sussex, United Kingdom, f.10

ndershëm që ta kryejnë pastërtisht këtë veprim në një shoqëri, ku gatishmëria për të korruptuar dhe për t'u korruptuar është shqetësim? Ndërtimi i institucioneve ligjore kryhet me bashkëveprim dhe me atë kapital social që ne kemi. Analistët politikë të viteve të fundit, por edhe njohës të vendeve të perëndimit, jo rrallë duke shprehur pakënaqësinë për zhvillime të caktuara në Shqipëri, përmendin si shembuj vendet e zhvilluara të perëndimit: Amerikën, Gjermaninë, Italinë për arritje të caktuara të tyre. Këto krahasime janë të dobishme nëse nuk harrohet se zhvillimet e atyre vende janë rezultat i konteksteve të tyre historike e aktuale, e faktit që kanë qytetarët që kanë dhe institucionet që kanë.

2.4. Aplikime të koncepteve mbi besimin social e kapitalin social në studimin e konteksteve të ndryshme

Kutia 3: Rruga e gjatë nga Moska në Stokholm¹⁸

Zyrtari tha se kishte dëgjuar që në Suedi taksapaguesit i paguanin të gjitha faturat e taksave. Sipas asaj që kishte dëgjuar ai, nga përfaqësues të autoriteteve të taksimitaksave, qytetarët paguanin 98% të detyrimeve të tyre në arkën e qeverisë. Zyrtari i ish-bllokut pohoi se, sipas autoritetit të tatimtaksave të vendit të tij, qeveria arrinte të mbledhte 66% të tatimeve e taksave. Dhe ishte fjala vetëm për tatimet e taksat që dihet se duhet të paguhen dhe jo për ekonominë gri ose të zezë. Zyrtari vuri në dukje një diferencë të madhe në gatishmërinë për të paguar tatimet e taksat reale në dy vendet.

Sipas zyrtarit të ish-bllokut, kjo diferencë nuk shpjegohet dot vetëm me dëshirën e qytetarëve të njërit vend për të paguar taksat e tatimet dhe me mosdëshirën e qytetarëve të vendit tjetër për t'i paguar ato. Ai nuk mendonte se qytetarët e vendit të vet ishin më të pandjeshëm për detyrimet e tyre publike, nuk mendonte që ata ishin e janë më të pandershëm se qytetarët e Suedisë.

Sipas tij, qytetarët e vendit të vet dëshironin t'i paguanin detyrimet e tyre sepse kuptonin se me fondet që grumbulloheshin, realizoheshin shërbime publike (shëndetësore, arsimore, etj.). Por qytetarët e vendit të tij nisesin nga dy rrethana për të paguar de facto detyrimet: rrethana e parë ishte se ata nuk besonin që edhe të gjithë taksapaguesit e tjerë do t'i paguanin detyrimet e tyre, kështu që nuk pëlqenin të ishin të vetmit që sillleshin ndershëmrisht. Me një nivel të ulët të pagesave të tatimtaksave shërbimet publike nuk ofrohen dot. Rrethana e dytë ishte se qytetarët besonin se autoritetet e tatimtaksave ishin të korruptuara dhe kështu që edhe nëse qytetarët do t'i paguanin taksat e tyre, një pjesë e madhe e parave nuk do të shkonin kurrë për ndërtimin e spitaleve, rrugëve e shkollave, por në xhepat e zyrtarëve të korruptuar.

- Në të dyja rastet, duket se besimi te tjetri është në nivel shumë të ulët dhe se kjo sjell një nivel shumë të lartë korrupsioni.
- Shumica e autoriteteve të tatim-taksave janë të ndershëm dhe nuk duan që korrupsioni të vazhdojë. Ata janë gati të mos marrin rryshfete nëse binden që edhe zyrtarët e tjerë nuk marrin rryshfete.
- Pra është përsëri çështje besimi? Besimi te njëri-tjetri dhe besimi te institucionet.
- Është çështje besimi.

¹⁸ Përshtatur sipas Bo Rothstein "Trust, Social Dilemmas and Collective Memories", në Journal of Theoretical Politics

- Nëse është çështje besimi, atëherë kjo do të thotë se suedezët i paguajnë 98% të detyrimeve të tyre ngaqë besojnë se edhe qytetarët e tjerë i paguajnë ato, dhe se pagesat e tyre administrohen mirë. Unë kam lexuar sondazhe për evazionin fiskal në Suedi që thonë se besimi i qytetarëve se të tjerët i paguajnë detyrimet e tyre, bën që ata të jenë më të prirur të paguajnë detyrimet personale. Këtë e dëshmojnë edhe shumë sondazhe të kryera në vende të tjera të botës: unë e kapërcej tundimin për të mbajtur për vete atë para që më duhet ta paguaj si taksë nëse edhe të tjerët e kapërcejnë këtë tundim; unë i paguaj më me lehtësi detyrimet e mia nëse burokratët nuk pasurohen me paratë e mia. Kështu?

- Kështu.

- Atëherë në Suedi qytetarët besojnë më shumë sesa në vendin tuaj dhe si pasojë e kësaj del se atje paguhen 98% të detyrimeve dhe në vendin tuaj qytetarët besojnë më pak dhe pasojë e kësaj është se në vendin tuaj paguhen vetëm 66% e detyrimeve. Pra problemi ekziston edhe në Suedi edhe në vendin tuaj, por në nivele të ndryshme. Si mund të bëhet që të lëvizet nga një shoqëri me nivel më të ulët besimi në një shoqëri me një nivel më të lartë besimi? Si mund të lëvizet nga një shoqëri ku ekziston një ekuilibër joefiçent drejt një shoqërie me ekuilibër eficient?

Ky është një rreth vicioz nga i cili është e vështirë të dilet: qytetari nuk do të paguajë taksat duke thënë se paratë e tij majmin të tjerë dhe ai nuk merr shërbimet, ndërsa institucionet nuk mund të ofrojnë shërbime më të mira nëse nuk janë paguar taksat.

Si mund të dilet nga ky rreth? Si mund të krijohet besimi i nevojshëm se edhe qytetarët e tjerë do të paguajnë? Si mund të krijohet besimi te ai që nuk e njohim? Si mund të krijohet besimi i nevojshëm se zyrtarët që administrojnë paratë e taksapaguesve nuk do ta keqpërdorin atë para? Si mund të krijohet besimi te institucionet shoqërore?

Si mund t'i shtohet ndershmërisë që qytetarët kanë edhe besimi se të tjerët dhe institucionet do të sillen me të njëjtën ndershmëri?

Studiuesi Newton¹⁹ ka vënë në dukje se besimi social është përmendur dhe argumentuar si një faktor i rëndësishëm për ndërtimin e institucioneve të forta shoqërore. Për këtë qëllim është analizuar marrëdhëniet ndërmjet: besimit social dhe besimit politik, besimit social dhe pjesëmarrjes në organizata vullnetare, ndryshimeve të individëve në predispozicionet e tyre për të besuar apo për të qenë mosbesues.

Edlund²⁰ ka argumentuar se një element i rëndësishëm i besimit në institucionet publike, lidhet me perceptimet e publikut për kapacitetin e shtetit të tyre. Në këtë lidhje, është bërë e qartë se nëse qeveria është efikase, e drejtë dhe e besueshme, atëherë ajo gëzon edhe një mbështetje më të madhe nga publiku dhe, në të kundërt, nëse ekzistojnë ndjenja ineffiçence, korrupsioni, padrejtësia dhe arbitrariteti, atëherë edhe mosbesimi në të është më i madh.

Studiuesi Dmitry Khodyakov²¹ ka vënë në dukje se prirja për t'i ndarë shtetet, si shtete ku besimi social në institucionet publike është i lartë dhe në shtete ku ky besim është i ulët, është një ndarje mekanike dhe se midis këtyre dy ekstremeve dallohen një sërë faktorësh të tjerë veprues

¹⁹ Newton, Kenneth, *International Political Science Review* (2001), Volume 22, No. 2, 201–214.

²⁰ Edlund, *Acta Sociologica*, 2006, Department of Sociology, Umeå University, Umeå, Sweden

²¹ Khodyakov, Dmitry, *Sociology*, Copyright © 2007, BSA Publications Ltd®, Volume 41(1): 115–132, DOI: 10.1177/0038038507072285, SAGE Publications, London, Thousand Oaks, New Delhi.

që e bëjnë besimin të jetë një proces, pra që besimi social rezulton të jetë jo thjesht një kategori momentale, por një madhësi e ndikuar nga e kaluara, nga e tashmja dhe nga e ardhmja që një shoqëri aspiron për veten e vet.

Studiuesit Herreros dhe Criado²² duke u marrë me rolin që kanë institucionet në sigurimin e besimit të publikut, sugjerojnë se shteti mund të luajë një rol pozitiv në krijimin e besimit të nevojshëm si faktor për nxitjen e marrëdhënieve kontraktuese private.

Studiuesi Richey²³ ka argumentuar ndikimin e korrupsionit qeveritar mbi besimin në përgjithësi. Sipas tij rritja e korrupsionit qeveritar çon në uljen e besueshmërisë të tjerët.

Studiuesi Kim²⁴ duke studiuar lidhjen midis kapitalit social dhe besimit politik, ka vënë në dukje se pjesëmarrja aktive në shoqata dhe besimi social lidhen negativisht me besimin në institucionet politike dhe në angazhimin për të votuar. Këto marrëdhënie negative janë të ndikuara nga perceptimet negative të realizimeve jo të mira të institucioneve. Ai del në përfundimin se performanca institucionale është faktor përcaktues për angazhimin politik.

Studiuesit Raiser, Wallace dhe Haerpfer²⁵ kanë publikuar të dhënat e para në lidhje me kapitalin social në vendet e Evropës Qendore dhe Lindore dhe argumentojnë se treguesit e besimit social dhe të pjesëmarrjes civile në këto vende janë ndjeshëm më të ulëta se ato të vendeve të Europës Veriore dhe Perëndimore. Ata zbulojnë se në këto vende, besimi nuk lidhet me rritjen ekonomike, por me pjesëmarrjen civile.

Studiuesit Ahn dhe Esarey²⁶ kanë vënë në dukje se besimi rritet nëse njerëzit kanë të dhëna të sigurta për të dalluar midis gjërave që duhet të besojnë dhe atyre që nuk u duhet zënë besë. Në anën tjetër, studiuesit Shen dhe Williamson²⁷, duke studiuar faktorë të rëndësishëm përcaktues për nivelet e perceptuara të korrupsionit kanë argumentuar se treguesit e të drejtave politike, të lirive civile dhe të lirisë së shtypit që janë tregues të demokracisë, se forca e shtetit, dhe ekonomia e hapur kanë një ndikim pozitiv në nivelet e perceptuara të korrupsionit.

Studiuesi Nuissl²⁸ është marrë me rëndësinë që ka besimi midis sipërmarrësve të vegjël dhe të mesëm për zhvillimin ekonomik. Ai thekson se ekonomitë post-socialiste kanë shumë nevojë për

²² Francisco Herreros and Henar Criado, "The State and the Development of Social Trust", *International Political Science Review*(2008), Vol. 29, No. 1, 53–71.

²³ Sean Richey, "The Impact of Corruption on Social Trust", *American Politics Research*, 2010, Department of Political Science, Georgia State University, 38 Peachtree Center Ave. Suite 1005, Atlanta, USA

²⁴ Ji-Young Kim, "Bowling Together isn't a Cure-All: The Relationship between Social Capital and Political Trust in South Korea", *International Political Science Review* (2005), Vol 26, No. 2, 193–213.

²⁵ Martin Raiser, Christian Haerpfer, Claire Wallace 'social capital in transition: a first look at the evidence', *European Bank for Reconstruction and Development*, One Exchange Square, London.

²⁶ T. K. Ahn and Justin Esarey, "A dynamic model of generalized social trust", *Journal of Theoretical Politics* 20(2): 151–180 Copyright _ 2008 Sage Publications, <http://jtp.sagepub.com>

²⁷ Ce Shen, John B. Williamson "Corruption, Democracy, Economic Freedom, and State Strength, A Cross-national Analysis", *International Journal of Comparative Sociology* 2005 46: 327.

²⁸ Henning Nuissl, "Trust in a post-socialist region - a study of East German Inc entrepreneurs: willingness to trust each other", *UFZ Centre for Environmental Research*, Germany.

besim. Në të njëjtin kontekst, studiuesi Pehlivanova²⁹, duke studiuar nivelin e besimit krahasuar me nivelin e pjesëmarrjes sociale, me zhvillimin ekonomik dhe strukturën e familjes, del në përfundimin se në vende të tilla si Bullgaria e Rusia marrëdhëniet ndërpersonale gjenerojnë më shumë besim sesa institucionet e shtetit.

Studiuesi Goldsmith³⁰, i cili është marrë me reformën në sektorin e policisë, vëren se një nga vështirësitë që hasen është mungesa e besimit publik në punën e policisë. Autori thekson se sigurimi i besimit në punën e policisë nuk mund të shkëputet nga mjedisi ku ndodh policimi dhe se ky është i lidhur edhe me besimin ndaj mjeteve që përdor policia për të ndërtuar besimin.

Studiuesit Letki dhe Evans³¹ duke u marrë me shoqëritë postkomuniste, vënë në dukje se këto vende kalojnë si tranzicione pushteti edhe tranzicione ekonomike dhe konkludon se në këto shoqëri nivelet e besimit lidhen më shumë me proceset nga lart poshtë dhe jo me ato nga poshtë lart, siç ndodh me shoqëritë me demokraci të hershme.

Në një tjetër perspektivë studiuesi Rothstein dhe Eek³² kanë eksperimentuar në lidhje me ekzistencën e niveleve të ndryshme të besimit në vende të ndryshme, dhe kanë arritur në përfundimin se besimi i njerëzve në autoritetet ndikon në perceptimet e besimit që ata do të kenë ndaj njerëzve të tjerë, duke mbështetur hipotezën se besimi vertikal ndikon në besimin horizontal.

Këtu u paraqit shkurt fenomeni i besimit social i lidhur me një numër faktorësh siç rezultojnë ata nga studime të spikatura të botuara në revistat më prestigjioze të politologjisë, psikologjisë e sociologjisë së kohës sonë. Por kjo listë studimesh në lidhje me kapacitetin personal e social për të besuar, dhe faktorët që ndikojnë në të, mund të zgjatet edhe më tej. Megjithë dobinë e saj, paraqitja shteruese e tyre përbën një ndërmarrje e cila i tejkalon objektivat e këtij studimi.

Eshtë e sigurt se kapitali social nuk përbën zgjidhjen magjike të fatit të një shoqërie, aq më shumë të problemeve të saj të mëdha në periudha kthesash shoqërore. Kjo është shumë e vërtetë në nivelin makrosocial. Në nivelin mikrosocial, kapitali social duket se përbën një parakusht të rëndësishëm për zhvillimin e iniciativës për sipërmarrje, për bashkëpunim, për angazhim.

²⁹ Plamena Pehlivanova "The Decline of Trust in Post communist Societies: The Case of Bulgaria and Russia", *Contemporary Issues* (Suvremene teme), issue: 2 / 2009, pages: 3247.

³⁰ Andrew Goldsmith, "Police reform and the problem of trust", *Theoretical Criminology*, © 2005 SAGE Publications, London, Thousand Oaks, and New Delhi. (Flinders University, Australia).

³¹ Natalia Letki, Geoffrey Evans, "Endogenizing Social Trust: Democratization in East-Central Europe", *British Journal of Political Sociology*, 35, 515–529 Copyright © 2005 Cambridge University Press, doi:10.1017/S000712340500027X Printed in the United Kingdom.

³² Bo Rothstein, Daniel Eek, "Political corruption and social trust: an experimental approach" *Rationality and Society* Copyright, 2009 Sage Publications. Volume 21 (1): 81–112. <http://rss.sagepub.com>

2.5. Marrëdhëniet ndërmjet besimit ndërpersonal dhe atij institucional

Kutia 4: Kriza e firmave piramidale³³

Në Shqipëri lulëzoi një treg informal kreditimi. Ai përbëhej pjesërisht prej kambistësh të huaj dhe pjesërisht prej kompanish që merrnin kursime dhe jepnin hua. Ato u rritën deri në nivelin e një sistemi kreditimi. Dallimi midis një tregu informal kreditimi dhe skemave piramidale është jetik, por për një kohë të gjatë ka qenë e vështirë të vihej re ky dallim. Të dy këto sisteme i siguruan burimet në kursimet e individëve në vend dhe në kursimet që emigrantët u kanë dërguar familjeve të tyre në atdhe.

Ky treg u tolerua nga autoritetet e asaj kohe. Edhe autoritetet edhe vëzhguesit e huaj, përfshirë këtu edhe FMN-në, i kanë parë kompanitë huadhënëse si të mira, dhe kanë vlerësuar kontributin e tyre në rritjen e kushteve për zhvillim. Kur bankat kishin mangësi, këto kompani kanë shërbyer si ndërmjetësi më i mirë për kursimet e shqiptarëve dhe investimet e financuara prej tyre kanë qenë ndër më fitimprurëset.

Bashkë me kompanitë informale të huadhënies, ndonjëherë edhe të maskuara prej tyre, vepronin edhe një numër kompanish që morën para me interesa të larta, por të cilat i investuan vetë dhe nuk i dhanë me interes. Ishin pikërisht këto që ishin ose u bënë skema piramidale. Kompania e parë dhe më e madhja, filloi aktivitetin në vitin 1991-1992 duke grumbulluar menjëherë para. Deri në fund të vitit 1995, këto kompani ofruan interesa 4-5% në muaj. Se ku u investuan këto para, ende nuk dihet. Ato u përfshinë në disa investime produktive të dukshme dhe, në disa raste, besohet se paratë e marra janë përdorur për të financuar aktivitete kriminale: trafikime, emigracion të paligjshëm, drogë, prostitucion dhe trafikim armësh. Nuk dihet nëse ato fitonin më shumë nga investimet dhe aktivitetet jo ligjore, sesa nga ç'u jepnin depozituesve. Ka mundësi, që ato të kenë qenë skema piramidale që në ditën e themelimit. Sido që të jetë, edhe nëse nuk kanë qenë të tilla, ato u shndërruan në skema piramidale gjatë vitit 1996.

Kuadri ligjor në dispozicion të autoriteteve për të luftuar skemat piramidale ka qenë i pamjaftueshëm. Kompanitë kanë qenë biznese të licencuara dhe pretendonin se funksiononin sipas Kodit të Punës, i cili e lejonte huamarrjen. Ka të dhëna se problemi nuk ka qenë një problem ligjor, por një problem i qeverisjes. Gjatë zgjedhjeve të vitit 1996 disa nga kompanitë dhanë kontribute elektorale, funksionare politikë shfaqeshin publikisht pranë kompanive. Kjo tolerancë pasqyrohej në neglizhimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Financave, dhe në mbështetjen e hapur të presidentit për kompanitë kryesore.

Dy ngjarje të rëndësishme të vitit 1996 përcaktuan skenën për maninë e skemave piramidale. E para kishte të bënte me sanksionet e OKB-s për Republikën Federatën Socialiste të Jugosllavisë në dhjetor 1995, dhe e dyta ishte fushata për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri në maj 1996. Asokohe, thuhej sheshit se përmes Shqipërisë edhe në kohën e embargos në Serbi, trafikohej naftë e mallrat e tjera nga Shqipëria. Përfshirja e kompanive të skemave piramidale në këto trafikime nuk është provuar, por besohet se ka pasur një lloj përfshirjeje. Një muaj pas heqjes së sanksioneve kompanitë huamarrëse rritën interesat deri në 6% në muaj. Zgjedhjet e majit patën një ndikim më të drejtpërdrejtë. Me hyrjen në treg të skemave të reja piramidale, këto i rritën sërisht interesat deri në 8% në muaj. Rezultati i zgjedhjeve pati edhe ai ndikimin e vet. Ato u konsideruan të stisura dhe rizgjedhjet e tetorit morën një

³⁰ Përshtatje e bazuar në studimin e Pelinku A., "The change of social capital channels and the new forms of interaction from the bottom", Master thesis (Based in Jarvis Ch. 2000. "The Rise and Fall of Albania's Pyramid Schemes". Finance and Development. Volume 37, No. 1 23)

rëndësi edhe më të madhe. Duke mos dashur t'u japë njerëzve surpriza të tjera të pakëndshme, duke injoruar rritjen e skemave piramidale, duke shpresuar se nuk do të ndodhte ndonjë gjë e keqe, e keqja u përforcua. Në fillim të 1996 në skenë hynë skema të tjera piramidale dhe depozituesit u shtuan, interesat u ngritën dhe autoritetet u bënë më konfuzë.

Tre kompanitë më të mëdha, VEFA, Gjallica, dhe Kamberi, që ofronin 4-5% interes në muaj në gjashtëmujorin e parë të 1996 i rritën ato në 6-10%. Këto tri kompani kishin investime dhe aktivitete ekonomike reale. Në 1996 këtyre iu shtuan dhe kompanitë Populli e Xhaferri. Kompania e Sudes që ekzistonte që më parë, i rriti interesat në 12-19% në maj 1996, por nuk kishte investime. Kjo bëri që të shtoheshin depozituesit. Vefa kishte rreth 85000 depozitues, Xhaferri dhe Populli tërhoqën mbi një milion depozitues për disa muaj. Shtimi i depozituesve rriti presionin mbi skemat piramidale për të rritur interesat. Ekzistenca e firmave piramidale bëri që autoritetet të bënin një dallim fals midis tyre dhe kompanive që kishin investime reale. Në gjysmën e dytë të vitit 1996, Kamberi i rriti interesat në 10% në muaj; Populli filloi të ofronte 30% në muaj; Xhaferri ofroi trefishimin e principalit në tre muaj dhe Sudja dyfishimin e principalit në dy muaj. Këto interesa tërhoqën masa të reja depozituesish, sidomos ato që ofronin interesa më të larta. Në radhët e depozituesve gjendeshin jo vetëm njerëz të thjeshtë, por edhe të tillë që besonin se firmat piramidale kishin mbështetjen e qeverisë ose që paratë buronin nga aktivitete ilegale.

Efektet sociale të firmave piramidale ishin të konsiderueshme: njerëzit humbën kursimet e krijuara me mund, ata humbën apartamentet, shtëpitë dhe bagëtisë e shitura. Në ngjarjet që pasuan humbën jetën 2000 vetë. Dhuna dëmtoi prona dhe institucione. Armatosja e popullsisë rriti nivelin e aksidenteve dhe të krimit. U godit gjithashtu edhe besimi: para krizës së piramidave Shqipëria kishte qenë e varfër, por krenare dhe e vendosur të ecte përpara. Për disa vite pas krizës Shqipëria mbeti mbrapa. Besimi në institucionet ra, kriminaliteti dhe korrupsioni u rrit, niveli i sigurisë ra.

Kriza e piramidave nuk është studiuar thellësisht. Megjithatë, ajo u ka mësuar shqiptarëve në ç'mënyrë mund të krijohen fitime, se si mund të investohet, se si duhen ruajtur kursimet, se sa u duhet besuar normave të larta të interesit, se sa e dobishme do të ishte për ta nëse paralajmëroheshin më herët nga institucionet publike

Tabela 1: Përmbledhje e situatës së skemave kryesore piramidale në Shqipëri

Emri i kompanisë	Data e fillimit të huamarrjes	Interesi mujor i ofruar	Numri i kreditorëve në momentin e rënies	Detyrimet ndaj kreditorëve (milion lek)	Vlera e asetëve	Borxhi i përgjithshëm (milion USD)	Mesatarja për kreditor (USD)
Vefa	1994	8	85,000	67,929	4,999	655	7,707
Gjallica	1993	10	82,000	51,467	495	496	6,053
Kamberi	1994	10	6,330	519	61
Silva	1994	10	15,000	3,332	871	32	2,142
Cenaj	1994	10	7,021	750	68
Xhaferri	1996	47	1,188,000	30,833	16,033	297	250
Populli	1996	39	304,000	6,310	3,786	61	200
Sude	1994	41	13,000	3,900	0	38	2,893

Besimi ndërpersonal dhe besimi institucional

Nga pikëpamja teorike, studiuesit dallojnë dy lloj besimi: besimin në përgjithësi dhe besimin ndërpersonal ose në veçanti. Besimi ndërpersonal përkufizohet si: “*Një besim i bazuar në eksperiencë i cili ndërtohet me anë të ndërveprimit të vazhdueshëm me persona konkretë gjatë një periudhe kohore të caktuar.*”³⁴ Në themel të kësaj forme besimi është shuma e të gjitha eksperiencave të përbashkëta, që ne në mënyrë të ndërgjegjshme i përfshijmë në një marrëdhënie³⁵. Nga ana tjetër, angazhimi qytetar dhe besimi ndërpersonal ndërmjet anëtarëve të një shoqërie, kontribuojnë në rritjen e përgjithshme të besimit social në atë shoqëri³⁶. Kjo pjesë strukturohet si vijon. Së pari analizohen tendencat e besimit ndërpersonal gjatë viteve të tranzicionit post-komunist në Shqipëri, dhe më pas shqyrtohet lidhja ndërmjet këtij besimi dhe besimit tek institucionet.

Familja në kuadër të besimit social

Kjo pjesë, analizon lidhjen ndërmjet familjes, nivelit besimit social dhe përfshirjes në politikë dhe në aksion politik. Familja përbën një tipar të rëndësishëm të besimit social dhe besohet se ajo ka ndikuar gjerësisht në kompleksitetin e marrëdhënieve ndërmjet besimit social dhe atij institucional. Familja shpesh zëvendëson rolin e institucioneve, duke qenë se ajo mundëson pasjen e vlerave prioritare të përbashkëta dhe burimet morale për vetë realizimin³⁷. Kjo teori, duket se vërtetohet më së tepërmi në Shqipëri ku gjaku yt, kushëriri, miku dhe i njohuri prevalojnë mbi një institucionin, të panjohurit dhe tjetrin. Kjo pjesë analizon së pari disa tendenca të familjes shqiptare si dhe vëzhgon raportin e këtyre me përfshirjen në politikë.

Marrëdhëniet ndërmjet kënaqësisë nga jeta, përfshirjes në politikë dhe pjesëmarrjes në veprime politike.

Përsa i përket lumturisë nga jeta (*happiness from life*): Psikologjia pozitive përshkruan tre lloj lumturish: kënaqësia (përjetimi i ndjesive pozitive), angazhimi (marrëdhënia me familjen, romancën dhe hobit personalë) dhe kuptimi (përdormi i forcave personale për t'i shërbyer një qëllimi më të madh). Kënaqësia nga jeta (life satisfaction) përfshin tipare të tilla si: marrëdhëniet dhe ndërveprimi social, statusi civil, punësimi, liria demokratike, përfshirja fetare, të ardhurat, afërsia ndaj ndjesisë së lumturisë të njerëzve ekstravertë, shëndeti, optimizmi, endorfina e çliruar prej veprimtarisë fizike etj³⁸. Këto koncepte janë përdorur si sinonime bazuar në përkufizimin e Easterlin (2001) i cili thekson se: “*Lumturia dhe kënaqësia nga jeta janë terma të njehësueshëm*”³⁹.

³⁴ Salaj, Berto, 2006, Social trust: Croatia 1995-2003, Politicka misao, Vol.XLII, No.5, pp.77-98, Pregledni lanak,323.21(497.5), Primljeno: 20. kolovoza 2006, fq. 82

³⁵ Freitag, Markus and Bühlmann Marc, Crafting Trust: The Role of Political Institutions in a Comparative Perspective Comparative Political Studies Dhjetor 2009 42: 1537-1566, f.1538

³⁶ Blind K. Pery, (2007) Building trust in government in the twenty-first century, UNDESA, 7th Global Forum on Reinventing Government, 26-29, Vienë, Austri, f.6

³⁷ Pehlivanova, Plamena, The Decline of Trust in Postcommunist Societies: The Case of Bulgaria and Russia», Contemporary issues, pages: 32-47, UDK: 32.019. 5(497.2 +470) Pregledni Rad, Primjeno: 17.8. 2009, f. 40

³⁸ Grinde, Bjorn (2002).”Happiness in the Perspective of Evolutionary Psychology,” Journal of Happiness Studies, Springer, vol. 3(4), 331-354. f. 331

³⁹ Easterlin, Richard, (2001). Income and happiness: towards a unified theory. The economic Journal, 111, 465-484, Royal Economic Society 2001. Published by Blackwell Publishers, 108 Cowley Road, Oxford, OX41,JE,UK and 350 Main Street, Malden, MA 021 48, USA, f. 465

Pjesëmarrja ose përfshirja në politikë i referohet mekanizmave të ndryshëm që ndihmojnë publikun të shprehë opinione dhe të ushtrojë ndikim përsa i përket menaxhimit, politikës, ekonomisë ose dimensioneve të tjera sociale. Kjo mund të ndodhë gjatë çdo fushe të aktivitetit shoqëror njerëzor⁴⁰. Gjatë këtij kapitulli, ne jemi fokusuar në angazhimin në politikë.

Pjesëmarrja në veprim politik mund të marrë shumë forma që variojnë që nga votimi për përfaqësues të caktuar në intervale të rregullta deri tek votimi për politika të caktuara përmes referendumit, pjesëmarrja në grupime të ndryshëm politikë dhe përfshirja në protesta të ligjshme e të paligjshme, pjesëmarrja në firmosjen e një peticioni si dhe përfshirja në forma të tjera veprimi politik, disa prej të cilave analizohen gjatë kësaj pjese. Individët që përfshihen në pjesëmarrjen në veprime politike, shpresojnë që të ndikojnë mbi politika të ndryshme të cilat i konsiderojnë si të rëndësishme për ta. Pavarësisht kësaj, efekti i pjesëmarrjes politike mund të mos kufizohet vetëm në sjelljen e këtyre pasojave, duke pasur parasysh se pjesëmarrja në veprime politike ndikon gjithashtu dhe kënaqësinë nga jeta të individëve. Nga ana tjetër mundet edhe që kënaqësia nga jeta të ndikojë në pjesëmarrjen politike⁴¹. Studiues të ndryshëm si p.sh. Veenhoven (1995), konkludojnë se demokracia politike dhe liria e shtypit lidhen ngushtë me kënaqësinë nga jeta. Ata theksojnë se individët të cilët jetojnë në regjime që u japin atyre liri më të mëdha politike janë më të kënaqur sesa ata që jetojnë nën regjime të tjerë më të kufizuara. Në të njëjtën linjë Schyner (1998) argumenton se të drejtat politike, barazia gjinore, dhe individualizmi, lidhen të gjitha ngushtësisht me kënaqësinë. Edhe Frey dhe Stutzer (2000) duke konsideruar të dhëna nga Zvicra zbulojnë se individët të cilët kanë më shumë mundësi për pjesëmarrje në demokraci direkte janë më të kënaqur me jetën e tyre sesa ata që nuk e kanë këtë mundësi⁴². Kjo pjesë analizon së pari marrëdhënien ndërmjet përfshirjes në politikë dhe kënaqësisë nga jeta, së dyti konsideron marrëdhënien ndërmjet kënaqësisë nga jeta dhe pjesëmarrjes në aksion politik dhe së fundmi, analizohet marrëdhënia ndërmjet perceptimeve për jetën dhe përfshirjes në veprime politike.

Besimi në përgjithësi dhe sjelljet sociale

Besimi në përgjithësi përkufizohet si besimi tek njerëzit që nuk i përkasin rrethit tonë familjar, shoqëror ose fqinjëve. Offe (1999) dhe Salaj (2006) theksojnë se me besim në përgjithësi kuptohet: *“Besimi tek anëtarët e komunitetit tonë politik që nuk i njohim personalisht, pra besimi tek ata të cilët janë disi të huaj për ne”*⁴³. Sipas të njëjtit burim që citon Robert Putnam: *“Besimi në përgjithësi na mundëson ne që të zgjerojmë qëllimin e besimit përtej rrethit të atyre që ne nuk i njohim personalisht.”*⁴⁴ Siç është theksuar nga shumë studiues të mirënjohur në fushën e besimit social dhe sjelljeve sociale, besimi në përgjithësi mendohet se rrit efikasitetin e proceseve politike dhe ekonomike, ndihmon në zbatimin e kontratave dhe forcon ndjesinë

⁴⁰ Arnstein, S. (1969) “A ladder of citizen participation” Journal of the American Planning Association 1969 35, f. 237. [On Line] at: <http://www.see-educoop.net/aeiq/outputs/annotated%20bibliography.pdf>. Parë për herë të fundit në 11 janar 2011, f. 237

⁴¹ Po aty, f. 11-12

⁴² Po aty, f. 11-12

⁴³ Salaj, Berto.(2006). Social trust: Croatia 1995-2003, Politicka misao, Vol.XLII, No.5, pp.77-98, Pregledni clanak, 323.21(497.5), Priljeno: 20. kolovoza 2006, f. 82

⁴⁴ Salaj, Berto. (2006). Social trust: Croatia 1995-2003, Politicka misao, Vol.XLII, No.5, pp. 77-98, Pregledni clanak,323.21(497.5), Priljeno: 20. kolovoza 2006, f. 81

komunitare ndërmjet qytetarëve (shiko p.sh. Fukuyama, (1995), Knack and Keefer, (1997) dhe Putnam (1993) të cituar tek Salaj, (2006)⁴⁵. Megjithatë, argumentohet edhe se besimi në përgjithësi, sjell në përfundimin e mësipërm vetëm nëse të tjerët janë gjithashtu besues. Për më tepër, pandershmëria ndërmjet anëtarëve të një shoqërie në kombinim me sjellje të tjera sociale si krimi, korrupsioni dhe aktivitetet e paligjshme, në përgjithësi kontribuon në uljen e marrëdhënieve të besimit në një shoqëri të caktuar⁴⁶.

Sjelljet shoqërore (ose ndryshe sjelljet qytetare) përbëjnë në koncept të vështirë për t'u përkufizuar pasi nëse analizohen sjelljet brenda një shoqërie është e vështirë të përcaktohet se çfarë është tipike/ normale/e pranueshme. Megjithatë, duke diskutuar në përgjithësi, mund të thuhet se sjelljet shoqërore mund të përcaktohen si diçka e ndryshme nga ajo që bëjnë zakonisht të tjerët. Kriteret që psikologët përdorin për të përcaktuar ata të cilët shfaqin dhe ata që nuk shfaqin sjellje tipike përfshijnë: a) kriterin statistikor (një sjellje e pa-zakontë / jo frekuente), b) kriterin psikologjik (shfaqje të stresit) dhe c) kriterin moral (diçka që është krejtësisht e pa pranueshme).

Gjatë analizimit të sjelljeve shoqërore do të bazohemi mbi atë që Letki (2006) përcakton si kriteri moral, duke anashkaluar në këtë mënyrë kriteret e tjera të përmendura më sipër. Letki (2006) përkufizon moralin qytetar si: “ *...një zakon etik i lidhur me besimin i cili i referohet ndjenjës së përgjegjësisë civile për mallin e përbashkët duke përfshirë bindjen ndaj rregullave dhe sjelljen e ndershme dhe të përgjegjshme.*”⁴⁷ Për më tepër, argumentohet se morali qytetar e ka origjinën në anëtarësinë në komunitet që implikon pranimin e detyrave si të dhëna nga shoqëria. Kjo është në kundërshtim të pandershmërisë, korrupsionit dhe sjelljeve të tjera morale të pazakonta dhe të paligjshme, dhe si e tillë i ndalon qytetarët nga përfshirja në krim, korrupsion dhe aktivitete të tjera të pa ligjshme. Qytetarët me standarde morale të larta janë më pak të prirur që të mashtrojnë njëri-tjetrin. Për studimin e burimeve të moralit qytetar jepen dy qasje: ajo kulturore (që i referohet vlerave dhe normave individuale që mësohen nëpërmjet pjesëmarrjes në jetën shoqërore) dhe qasja institucionale (e cila lidh moralin qytetar me cilësinë e rendit publik dhe performancën e zyrtarëve publikë dhe të atyre që mbajnë poste publike)⁴⁸. Bazuar në këndvështrimin kulturor të mësipërm, kjo pjesë analizon lidhjen ndërmjet besimit në përgjithësi dhe sjelljeve shoqërore. Kapitulli shikon së pari nivelet e besimit në përgjithësi në Shqipëri dhe më pas analizon marrëdhënien ndërmjet besimit ndërpersonal dhe rrjeteve informale. Në vazhdim, konsiderohet marrëdhënia ndërmjet besimit në përgjithësi dhe sjelljeve shoqërore dhe mbyllet me disa gjetje rreth lidhjes ndërmjet sjelljeve shoqërore dhe atyre politike.

⁴⁵ Po aty f. 83

⁴⁶ Letki, Natalia, 2006. Investigating the Roots of Civic Morality: Trust, Social Capital, and Institutional Performance. Department of Political Science, Collegium Civitas, Plac Defilad 1, PKiN, XII p.00-901 Varshavë, Poloni, f. 2

⁴⁷ Letki, Natalia, 2006. Investigating the Roots of Civic Morality: Trust, Social Capital, and Institutional Performance. Department of Political Science, Collegium Civitas, Plac Defilad 1, PKiN, XII p.00-901 Varshavë, Poloni, f. 2

⁴⁸ Po aty , f. 4

2.5.1. Marrëdhënia ndërmjet besimit ndërpersonal dhe atij institucional

Siç u theksua dhe më sipër, besimi ndërpersonal përbën një element kryesor në studimin dhe matjen e implikimeve të besimit social dhe autoritetit institucional. Përsa i përket besimit ndërpersonal, të dhënat që jepen nga të dyja valët e SBV-së, tregojnë një ulje progresive të tij nga vala në valë. Kështu sipas tabelës 2, rezulton se perceptimi i shqiptarëve për të tjerët është kryesisht negativ sa i përket besimit. 72% e njerëzve në vitin 2002 besojnë se “duhet pasur kujdes” në marrëdhëniet me njerëzit, çka tregon një mungesë të theksuar besimi ndërmjet shqiptarëve.


Tabela 2: Besimi ndërpersonal 1998 dhe 2002 në %

Viti	1998	2002
Njerëzve mund t’u besohet	27	24.7
Duhet pasur kujdes	73	75.3

Burimi: SBV, Vala e 3-të dhe 4-t

Të dhënat nga dy valët e analizuara të SBV-së tregojnë fakte interesante të cilat theksojnë se sa më i ulët të jetë besimi ndërpersonal aq më i ulët është besimi tek qeverisja dhe institucionet qeverisëse. Kjo mund të interpretohet në Figurën 2, ku kuptojmë se marrëdhënia ndërmjet besimit ndërpersonal dhe besimit tek qeveria është e drejtpërdrejtë edhe për rastin e Shqipërisë.

Figura 2: Besimi ndërpersonal dhe besimi tek qeveria 1998 dhe 2002 në %



Burimi: SBV, Vala e 3-të dhe e 4-t

Megjithatë, duhet theksuar se në shoqëritë perëndimore njerëzit nuk besojnë njëri-tjetrin si individë, por si pjesë e një kuadri ligjor të përbashkët, i cili garanton dhe mbron të drejtat e tyre

dhe i dallon ata qartësisht nga grupe të tjera (shtete)⁴⁹. Levi (1998) ka propozuar një model të ngjashëm të 'miratimit kontingjencial', që tregon transformimin e besimit ndërpersonal tek zyrtarët publikë në besueshmërinë institucionale, duke prekur nivelin e bashkëpunimit të qytetarëve me kërkesat dhe rregullat e vendosura nga qeveria e tyre. Ky model, tregon se besimi publik në qeveri kushtëzohet nga fakti se qytetarët besojnë qeverinë e tyre vetëm atëherë kur ata mendojnë se përfaqësuesit e institucioneve po veprojnë në përmbushje të interesave të tyre⁵⁰. Një grup i dytë studiuesish, megjithatë, theksojnë se besimi i reduktuar tek institucionet ka shkaktuar mungesë të besimit ndërpersonal në vend të se kundërtës. Lidhur me faktorët më të rëndësishëm kontekstualë, studiuesit vlerësojnë se vendet, autoritetet e së cilave shikohen si të pa-korruptueshme dhe interesat politike të së cilave përfaqësohen në mënyrë proporcionale me peshën e tyre, kanë qytetarë të cilët ka më shumë gjasa që të krijojnë marrëdhënie besimi ndërmjet njëri-tjetrit⁵¹.

Sa i përket marrëdhënies ndërmjet besimit dhe institucioneve, është e nevojshme të përmendet gjithashtu se besimi lidhet ngushtë me fizionominë e institucionit. Imazhi i një zyrtari të lartë i një institucioni në Shqipëri, duket se perceptohet tek publiku në formën ku individ i përfaqëson të gjithë institucionin në fjalë. Pra, besimi tek drejtuesit e institucionit pasqyron besimin tek vetë institucioni. Në kontekstin tonë, është e dukshme se shqiptarët priren të identifikojnë institucionet me ata të cilët i drejtojnë këto të fundit dhe jo me strukturën dhe punën e saj në vazhdimësi gjatë një periudhe kohore të caktuar. Si rrjedhojë, mungesa e besimit në elitat e pa-ndryshueshme dhe vazhdimisht në riciklim të shoqërisë shqiptare gjatë 20 vjetëve të fundit të demokracisë çon në mungesën e besimit në institucione, siç theksohet dhe gjatë diskutimeve të Fokusgrurit të dytë. Përsa i përket kontekstit shqiptar, duhet gjithashtu të theksohet se stabiliteti socio-politik varet gjithnjë e më shumë nga besimi tek institucionet, dhe jo nga besimi ndërmjet individëve. Pra, siç theksohet prej shumë studiuesve, (Luhman 1988; Dunn 1984; Giddens 1990; Seligman 1997) "*institucionet vibruese kanë më shumë rëndësi për demokracitë bashkëkohore sesa cilësia e marrëdhënieve ndërpersonale ndërmjet qytetarëve*"⁵². Si rrjedhojë, në një shoqëri moderne, besimi në institucione është më i rëndësishëm se besimi ndërpersonal, duke qenë se institucionet e saj mund të kenë më shumë burime për pajisjen e njerëzve me mënyrat për të arritur disa prej qëllimeve të tyre⁵³.

Pjesëmarrja në grupet sociale

Ajo që tregohet nga analiza e të dy valëve të marra në konsideratë të SBV-së, është se mungesa e besimit ndërpersonal dhe atij institucional në Shqipëri lidhen gjithashtu me shifra të ulëta të pjesëmarrjes në organizata jo-politike. E njëjta tendencë, konfirmohet gjithashtu edhe nëse shikohet një sondazh kombëtar ndërmarrë nga Civicus dhe IDM gjatë vitit 2009 i cili thekson se vetëm 18.4 përqind e të anketuarve perceptojnë veten e tyre si anëtarë aktivë të organizatave

⁴⁹ Elezi, Gentian, 1999, The rule of law in Post Communist Albania, University of Sussex, United Kingdom, f. 9

⁵⁰ Kim. Seok-Eun, (2005) The Role of Trust in the Modern Administrative State, Administration and Society. Vol 7, 2005

⁵¹ Freitag, Markus & Bühlmann Marc, Crafting Trust: The Role of Political Institutions in a Comparative Perspective Comparative Political Studies Dhjetor 2009 42: 1537-1566, f. 1537

⁵² Herreros, Francisco. (2008) The State and the Creation of an Environment for the Growing of trust, DOI: 10.1177/1043463108096790., Rationality and Society Copyright © 2008 Sage Publications. Vol. 20(4): 497-521 <http://rss.sagepub.com> DOI: 10.1177/1043463108096790, fq. 500

⁵³ Khodiakov. D, 2007, Trust as a Process: A Three-Dimensional Approach Sociology 41: 115-132

shoqërore dhe kulturore të tilla si klubet sportive, ose organizatat vullnetare ose të atyre që ofrojnë shërbime dhe që kanë karakter jo politik. Për më tepër bazuar në të njëjtin burim, theksohet se niveli i angazhimit qytetar në Shqipëri mbetet i ulët⁵⁴.


Tabela 3: Pjesëmarrja në grupime jo –politike 2002 në %

2002	Lu përkasin Sindikatave	Lu përkasin grupeve kulturore dhe arsimore	Lu përkasin grupeve të drejtave të njeriut	Lu përkasin organizatave ambientaliste
Yes	9.4	13.5	6.4	14.5
No	90.6	86.5	93.6	85.5

Burimi: Vala e 4-t e SBV-së (2002)

Një mosbesim i tillë (ndërpersonal dhe institucional) besohet se prek drejtpërdrejt zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile të cilat besohet se janë një faktor i rëndësishëm që kontribuon në zhvillimin ekonomik dhe politik, ashtu siç theksohet edhe nga veprat e shumë studiuesve (Putnam, 1993; Fukuyama, 1995). Në lidhje me këtë, vendet të cilat kanë një nivel më të ulët të besimit social ashtu sikundër Shqipëria janë më pak të prirura që të ndërtojnë një shoqëri civile vibrante e cila të nxisë performancën e lartë të qeverisë. Një tjetër arsye për mungesën e motivimit dhe pjesëmarrjes së ulët në aktivitetet e shoqërisë civile mund të jetë dhe nepotizmi i masës së gjerë të shoqërisë sonë si dhe mungesa e besimit se zëri i qytetarëve do të dëgjohet siç u theksua dhe gjatë Fokusgrupit të Dytë.

Figura 3: Besimi tek shtypi 2002 në përqindje



Burimi: SBV, Vala e 3-të dhe e 4-t

Në vijim të diskutimit të mësipërm, të dhënat e SBV-së tregojnë se edhe besimi tek shtypi në

⁵⁴ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe CIVICUS, (2010) Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë. Në Kërkim të qytetarit dhe ndikimit. fq.13


Shqipëri, është në nivele relativisht të ulta, ku shumica përbëhet nga ata që nuk besojnë shumë dhe ata që nuk besojnë fare, siç tregohet dhe nga Figura 3 më sipër. Në vijim të këtij diskutimi në sondazhin Balkan Monitor të vitit 2010, janë vënë re këto rezultate në lidhje me besimin ndaj medias lokale: në vitin 2008 69% besonin në media, në vitin 2009 besimi ishte 61% dhe në 2010 besimi shkante në 68%⁵⁵.

Besimi në institucionet ndërkombëtare

Një tjetër tendencë që vërehet gjatë analizimit të të dhënave për të dy valët e SBV-së, që janë parë gjatë këtij studimi (1998, 2002), është se nivelet e ulëta të besimit ndërpersonal shoqërohen me besim të ulët në institucionet lokale, siç do të qartësohet edhe më poshtë. Kjo tendencë duket se bën që të lindë një fenomen i veçantë: rritja e besimit kundrejt institucioneve ndërkombëtare të tilla si BE dhe NATO siç tregohet dhe më poshtë nga Figura 4. Nga ana tjetër, të dhënat nga Gallup Balkan Monitor Survey 2010, tregojnë se Shqipëria dhe Kosova janë dy vendet në rajon që perceptojnë si më pozitivisht hyrjen në BE. Në këtë rast Shqipëria vendoset përpara vendeve si Bosnja, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Kroacia. Nga ana tjetër, i njëjti burim thekson gjithashtu se brenda këtyre vendeve, po rritet gjithnjë e më tepër perceptimi se qytetarët e BE-së nuk duan që këto dy vende të anëtarësohen në union⁵⁶. Do të ishte interesante të shikohej megjithatë se cilat janë shkaqet e një mos-besimi në rritje kundrejt shqiptarëve?

Duke u kthyer sërish tek grafiku ynë, mund të thuhet se besimi i madh ndaj institucioneve ndërkombëtare, dëshmon ekzistencën e dy tendencave gjatë tranzicionit post-komunist shqiptar. Së pari ka një tendencë në rënie të besimit ndërpersonal që shoqërohet nga një rënie e besimit ndaj institucioneve kombëtare, siç do të argumentohet dhe më poshtë më hollësisht. Së dyti boshllëku i lënë nga kjo mungesë besimi mbushet, duke besuar tek institucionet ndërkombëtare, të cilët shpesh perceptohen si struktura të distancuara e të drejta që punojnë e vlerësojnë më mirë sesa institucionet tona.

Figura 4: Besimi në institucionet ndërkombëtare 1998 dhe 2002 në %



Burimi: SBV, Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së

⁵⁵ Gallup: Balkan Monitor: insights and perceptions-voices of the Balkans, 2010, f. 31


⁵⁶ Gallup: Balkan Monitor: insights and perceptions-voices of the Balkans, 2010, fq. 22 dhe 33

Duke vazhduar diskutimin e mësipërm, theksohet se kjo tendencë mund të përbëjë bazat për argumentimin se pas viteve 1990 në Shqipëri u zhvillua perceptimi se çdo gjë e mirë vjen prej ndërkombëtarëve, dhe kjo ndodhi edhe si rrjedhojë e mungesës së organizimit institucional të institucioneve të brendshme të vendit. Për më tepër, retorika e diskutimit politik në Shqipëri gjatë tranzicionit ka ndikuar në krijimin e perceptimit qytetar se legjitimitimi i elitave të brendshme certifikohet prej ndërkombëtarëve duke zëvendësuar shpesh edhe vetë qytetarët e këtij vendi. (FG 2)

Besimi tek institucionet e brendshme

Duke dhënë një vlerësim të përgjithshëm, theksohet se përveç faktit që besimi në qeveri është rritur lehtësisht, të dhënat tregojë se besimi në institucione paraqet tendenca rënieje. Një indikator i rëndësishëm që tregon rënien e besimit tek institucionet është dhe rënia e besimit tek policia nga njëra valë tek tjetra e SBV-së, siç konfirmohet edhe nga Figura 5.

Figura 5: Besimi tek Policia 1998 dhe 2002 në %



Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së


Rënia e besimit tek policia është me mjaft rëndësi, pasi ajo së bashku me institucionet ligjvënëse ka një funksion të veçantë, që është gjetja dhe ndëshkimi i atyre që shkelin ligjin duke përdorur strategji oportuniste ose duke kryer sjellje të rrezikshme. Në këtë kuadër, sistemi i drejtësisë dhe policia janë të përfshira në mbrojtjen e qytetarit dhe kjo ushtron ndikim të madh kundrejt tipareve shoqërore të besimit.

Në vijim, një sistem drejtësie i pavarur përbën gjithashtu një tjetër shtyllë besimi për shoqërinë. Drejtësia, si mbrojtës i të gjithë ligjeve të vendosura në një shoqëri ka një rol kryesor në vendosjen dhe ruajtjen e shtetit të së drejtës. Ideja e shtetit të së drejtës, implikon se çdo ushtrim i kompetencave publike duhet mbështetur nga legjislativi i qëndrueshëm i bërë publik dhe i zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët. Në shoqëritë ku gjyqësori perceptohet si i korruptuar dhe jo efikas autoriteti i ligjit është i cenuar dhe si rezultat do të prevalojë mosbesimi (Figura 6)⁵⁷.

⁶⁰ Paldam, M. (2000) "Missing Social Capital and the transition in Eastern Europe", Journal for Institutional Innovation, Development and Transition. [On Line]. Available at: http://research.asb.dk/ws/fbspretrieve/250/00-5_gts.pdf. f. 769

⁶¹ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe CIVICUS, (2010) Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë. Në Kërkim të qytetarit dhe Ndikimit. fq.13


Figura 6: Besimi tek drejtësia 2002 në %



Burimi: Vala e 4-t e SBV-së

Për të parë në mënyrë krahasuese nivelin e zhvillimit të besimit në institucionet publike, ne kemi analizuar për të dy valët e SBV-së (1998 dhe 2002) besimin në Qeveri, Polici, Parlament dhe Forcat e Armatosura. Siç tregon dhe Figura 7, në një kohë që besimi në qeveri ka njohur një rritje të lehtë, situata e besimit lidhur me institucionet publike duket se ka regjistruar tendenca në zbritje nga 1998 në vitin 2002 përsa i përket Policisë, Parlamentit dhe Forcave të Armatosura. Sipas një tjetër burimi, për periudhën 2008-2010 besimi ndaj Forcave të Armatosura ishte 47% në vitin 2008, 68% në vitin 2009 dhe 63% në vitin 2010. I njëjti burim thekson se besimi ndaj qeverisë ka qenë respektivisht 36% në 2008, 51% në 2009, dhe në 2010 40%⁵⁸.

Figura 7: Besimi tek Policia, Parlamenti dhe FA 1998 dhe 2002 në %



Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së

⁵⁷ Blind K. Pery, Building trust in government in the twenty-first century, UNDESA, 7th Global Forum on Reinventing Government, 26-29 qershor 2007, Vienë, Austri

⁵⁸ Gallup: Balkan Monitor 2010: insights and perceptions-voices of the Balkans, 2010

Një situatë e tillë, shpjegohet dhe nga Ullman-Margalit (2004: 65) e cila argumenton se në shoqëritë moderne, shteti vepron si një zëvendësues për besimin, sepse mungesa e zbatimit nga ana e tij e kontratave të detyrueshme me ligj, jo vetëm që nuk gjeneron besim, por në fakt i heq shoqërisë nevojën për të. Pra, studiuesit që argumentojnë në këtë mënyrë, mbrojnë ekzistencën e një lloj tregtie ndërmjet rolit të shtetit si një palë e tretë zbatuese e marrëveshjeve kontraktuale private dhe zhvillimit të besimit social⁵⁹. Në këte kuadër, nuk është e rëndësishme të krijohen institucione formale por historia e perceptuar rreth veprimtarisë së tyre është ajo që ka rëndësi për krijimin e besimit. Megjithatë, në Shqipëri, një balancë e tillë nuk është arritur dhe ajo që është më shqetësuese, ka një thellim të boshllëkut të besimit tek institucionet.

Një tjetër tendencë që vlen të theksohet kur flasim për zhvillimin e besimit social në Shqipëri, është se besimi i ulët tek qeveria mund të vijë si rrjedhojë edhe e perceptimeve që individët kanë mbi pritshmëritë ndaj institucioneve. Duke pasur pritshmëri të ulta nga institucionet, njerëzit kanë prirje dhe janë të aftë të ushtrojnë veprimtari individuale ose në grup për të arritur qëllimet e tyre, në vend të presin që institucionet qeverisëse të ndikojnë në mirëqenien e tyre. Kjo qasje, bëhet edhe më e evidente kur krahasohen rezultatet e valës së tretë me ato valës së katërt të SBV-së përsa i përket përgjegjësisë së njerëzve dhe asaj të qeverisë si tregohet dhe në Tabelën 4:

Tabela 4: Përgjegjësia e njerëzve kundrejt asaj të qeverisë (1998 dhe 2002 në %)

	1998	2002
Përgjegjësia e njerëzve	26.7	36.1
Përgjegjësia e qeverisë	73.3	63.9

Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së

Ajo që mbetet për t'u parë, është se si të vendoset një lidhje funksionale ndërmjet atyre që besojnë në individualitetin e tyre dhe në përpjekjet dhe angazhimet personale, dhe se si ta pozicionojmë këtë besim në kontekstin institucional. Në lidhje me këtë, pavarësisht faktit se individët mund të jenë ambiciozë dhe të përgjegjshëm për qëllimet e tyre, nevojitet të mendohet se si këto burime mund të shfrytëzohen në aktivitetin e institucioneve, ose se si mund të institucionalizohen prirjet intelektuale të këtyre individëve⁶⁰. (FG 2)

Familja në kuadrin e besimit social


Sipas të dhënave të SBV-së, shqiptarët duket se vazhdojnë të konsiderojë familjen e tyre si institucionin më të rëndësishëm. Si rrjedhojë, një qasje e tillë ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi sjelljen e qytetarëve shqiptarë kundrejt institucioneve. Lidhjet e forta familjare, tradita e të jetuarit me prindërit dhe pesha që i vendoset çështjeve që lidhen me familjen në jetën e njerëzve, mbeten çështjet kryesore të cilat kanë influencuar edhe zhvillimin e besimit social dhe autoritetit institucional gjatë viteve. Siç shikohet nga të dhënat e SBV-së që paraqiten më poshtë shqiptarët

⁵⁹ Herreros, Francisco, (2008) The State and the Creation of an Environment for the Growing of trust, DOI: 10.1177/1043463108096790., Rationality and Society Copyright © 2008 Sage Publications. Vol. 20(4): 497-521 <http://rss.sagepub.com> DOI: 10.1177/1043463108096790, f.498

⁶⁰ Diskutim i dalë gjatë fokus grupit 2


duket se respektojnë dhe duan gjerësisht familjet e tyre, harxhojnë një sasi të madhe kohe me to dhe se shumica e tyre jeton me prindërit (shiko Figurat 8, 9 dhe 10 më poshtë).

Figura 8: Respekti dhe dashuria për prindërit 1998 dhe 2002 në %




Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së

Figura 9: Koha e lirë kaluar me familjen shokët, kolegët e me të tjerë 2002 në %



Burimi: Vala e 4-t e SBV-së

Figura 10: Ata që jetojnë me prindërit dhe ata që jetojnë vetëm 1998 dhe 2002

Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së

Ndjenja e fortë e përkatësisë tek institucioni i familjes mund të ketë gjithashtu pasoja për institucionet formale. Megjithatë, një qasje e tillë nuk është tipike për Shqipërinë. Edhe shumë vende të tjera në Evropë (sidomos në atë qendrore dhe lindore) shprehin besim të lartë ndaj familjes dhe shokëve dhe kanë tendencën e mosbesimit kundrejt strukturave sociale dhe politike⁶¹. Në shoqëritë industriale të zhvilluara, njerëzit janë anëtarë të një diversiteti më të madh grupesh, me përfshirje të limituar tek secili, dhe besimi bazohet në një nivel më të ulët mbi besimin personal, dhe më shumë tek kushtet e performancës institucionale të ligjeve dhe zbatimit të tyre, tek ndërmjetësit e të gjitha llojeve, dhe tek tipare komplekse të varësisë së ndërsjelltë⁶².

Siç theksohet dhe nga disa autorë (psh., Ledeneva 2001), institucionet informale mund të jenë të forta sepse ato punojnë atje ku institucionet formale dështojnë. Si rrjedhojë shpërndarja e tyre mund të jetë një kompensim racional për të kompensuar performancën e varfër të institucioneve formale. Pavarësisht kësaj, institucionet informale si familja nuk janë domosdoshmërisht pengesë për transformimin e shoqërisë, duke qenë se ata mund të bashkë-ekzistojnë paralelisht me institucionet formale. Megjithatë informacioni i shpërndarë gjerësisht mbi sjelljet informale që devijojnë nga normat e sjelljes formale, universale, që pranohen prej të gjithëve dhe të vendosura me ligj, nuk prekin modernizimin dhe burokratizimin e shoqërisë ndërkohë që ajo i nënshtrohet rregullit dhe sundimit të ligjit⁶³. Në këtë këndvështrim shqiptarët që jetojnë me


⁶¹ Pehlivanova, Plamena «The Decline of Trust in Postcommunist Societies: The Case of Bulgaria and Russia», Contemporary issues, (Suvremene theme), pages: 32-47. UDK: 32.019. 5(497.2 +470) Pregledni Rad, Primjeno: 17.8. 2009, f.42

⁶² Nooteboom, B. (2006) "Social Capital, Institutions and Trust", Tilburg University, The Netherlands. [On-line] At: <http://arno.uvt.nl/show.cgi?fid=53911>. Parë në janar 2011, fq.2

⁶³ Mungiu, Pippidi, Alina, (2005) Deconstructing Balkan Particularism: The Ambiguous Social Capital Of Southeastern Europe Southeast European and Black Sea Studies Vol. 5, No. 1, Janar 2005, 49–68 ISSN 1468–3857 © Taylor & Francis Ltd, DOI: 10.1080/1468385042000328367, f.51

prindërit janë më pak të prirur për të firmosur një peticion, apo të marrin pjesë në aksione politike siç tregohet edhe nga Figura 11.


Figura 11: Ata që jetojnë me prindërit dhe ata që firmosin një peticion 2002



Burimi: Vala e 4-t e SBV-së

Sa i përket lidhjes ndërmjet familjes dhe aktivizimit politik mund të thuhet se ajo është e drejtpërdrejtë. Siç mund të shihet, ata të cilët jetojnë me prindërit e tyre, janë më pak të përfshirë me aktivitetet sociale/politike dhe të komunitetit sesa ata që jetojnë vetëm (Figura 12). Kjo mund të argumentohet me kulturën e tyre për të konsideruar familjen si një institucion të rëndësishëm në të gjitha drejtimet, si dhe me faktin se shqetësimet e tyre kryesore lidhen me sigurimin e kushteve të mira të jetesës dhe me sigurinë brenda familjes dhe jo me shoqërinë në tërësi.

Figura 12: Jeta vetëm, jeta me njerëz të tjerë dhe angazhimi civil



Burimi: Vala e 4-t e SBV-së

Siç rezulton edhe nga sa më sipër, mosdobësimi i respektit ndaj prindërve, shpenzimi i kohës së lirë më shumë me familjen sesa me shokët dhe pjesëmarrja më e vogël në aksione shoqërore politike si firmosja e një peticioni e atyre që jetojnë me prindërit, janë tregues të një peshe që ka familja krahasuar me atë të institucioneve shoqërore. Një studim i ngjashëm është duke u kryer në këtë fushë dhe deri tani është vërtetuar se të rinjtë që votojnë për herë të parë kanë prirjen që të votojnë ngjashmërisht me mënyrën si votojnë prindërit e tyre dhe se kjo prirje vjen duke u dobësuar me dobësimin e ndikimit të familjes mbi ta⁶⁴.

Këto gjetje marrin një rëndësi të veçantë po të shihen edhe në një rafsh më të gjerë. Më poshtë veçohen dy mundësi të tilla:

E para, shoqëria shqiptare është një shoqëri për të cilën familja përbën një nga gjërat më të shenjta. Kështu e kanë familjen edhe shoqëri të tjera. Ky qëndrim ndaj familjes dhe një sërë vlerash që lidhen me të, kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve të cilët e kanë pozuar çështjen e shikimit të shoqërisë shqiptare si një shoqëri klanore, pra ku lidhjet e gjakut janë të fuqishme, çmohen, mbështeten dhe mbrohen. Siç mund të merret me mend, kur shoqëria është klanore dhe kur institucionet publike janë të brishta, niveli i besimit në to dhe niveli i pjesëmarrjes sigurisht që pritet të jenë më të ulta.

E dyta, sipas një studimi interesant, pas entuziazmit fillestar të kalimit nga komunizmi në demokraci në Rusi dhe në Bullgari dhe gjatë viteve të vështira të tranzicionit u vu re që individët forcuuan lidhjet e tyre me familjet, pasi familja mbeti qeliza që kompensonte ato që institucionet nuk i ofruan dot: siguri, besim, vlera⁶⁵.

2.5.2. Kënaqësia nga jeta, përfshirja në politikë dhe pjesëmarrja në aksion politik

Apatia, mosbesimi dhe (mos)përfshirja në politikë

Një tjetër çështje që influencën nivelin e ulët të besimit në qeveri dhe institucionet publike është edhe apatia në rritje e qytetarëve, kundrejt strukturave shtetërore gjatë tranzicionit të gjatë. Me fjalë të tjera, prezenca e shtetit si rregullator, nuk forcon në mënyrë të drejtpërdrejtë zhvillimin e besimit, por krijon një ambient ku besimi mund të rritet. Ndërsa mungesa e shtetit ose paaftësia e tij, pengon rritjen e besimit dhe ul pritshmëritë e qytetarëve kundrejt shtetit dhe strukturave politike⁶⁶. Në këtë mënyrë pretendohet se qytetarët të cilët nuk kanë besim tek qeveria, kanë më pak vullnet për të votuar dhe për të marrë pjesë në politikën elektorale, por preferojnë më së shumti të monitorojnë dhe kontrollojnë aktet e qeverisë me anë të organizatave monitoruese, të cilat kërkojnë një dhënie llogarie më të lartë nga qeveria dhe udhëheqësit e saj të zgjedhur⁶⁷. Pavarësisht kësaj, teoria në fjalë nuk i përshtatet rastit shqiptar duke pasur parasysh se interesi

⁶⁴ Studim doktoral i MA Blendi Çeka. Çështja është diskutuar në fokusgrupin e parë të zhvilluar për nevojat e këtij studimi.


⁶⁵ Plamena Pehlivanova "The Decline of Trust in Post communist Societies: The Case of Bulgaria and Russia", Contemporary Issues (Suvremene teme), issue: 2 / 2009, f. 3247

⁶⁶ Herreros, Francisco, (2008) The State and the Creation of an Environment for the Growing of trust, DOI: 10.1177/1043463108096790., Rationality and Society Sage Publications. Vol. 20(4): 497–521 <http://rss.sagepub.com> DOI: 10.1177/1043463108096790, fq.498

⁶⁷ Kim. Seok-Eun, The Role of Trust in the Modern Administrative State, Administration and Society. Vol 7, 2005


i shqiptarëve në politikë gjatë viteve është ulur (shiko figurën 13 më poshtë), ndërsa njerëzit kanë tendencë të jenë më pak të asociuar me partitë politike dhe/ose organizatat qytetare, siç argumentohet kur flitet për anëtarësinë në grupet sociale dhe në partitë politike. Grafikët më poshtë tregojnë respektivisht nivelin në rënie të interesit të shqiptarëve në politikë (Figura 13) dhe nivelin relativisht në rënie të pjesëmarrjes në zgjedhjet parlamentare të fundit siç tregohet nga raportet e OSBE/ODIHR-it (Figura 14).

Figura 13: Frekuencat e interesimit për politikën gjatë 1998 dhe 2002 në %



Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së


Figura 14: Pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare 1998, 2001, 2005 dhe 2009 sipas OSBE/ODIHR



Burimi: OSBE, ODIHR

Paralelisht, duket se shqiptarët kanë perceptime negative në rritje sa i përket sistemit qeverisës, i cili vlerësohet negativisht nga popullsia përgjatë viteve. Gjatë të dyja valëve të SVB-së, popullsia ka mbetur skeptike përsa i përket sistemit politik qeverisës.

Figura 15: Vlerësimi i sistemit politik 1998 dhe 2002



Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së

Për sa i përket anëtarësisë në partitë politike, SBV-ja jep mundësinë që ky trend të shikohet vetëm për 2002 dhe ai paraqitet relativisht i ulët (Tabela 5). Megjithatë, sipas një burimi tjetër më të vonët në kohë, niveli i anëtarësimi politik gjatë vitit 2009 arrin në 24.5, përqind çka tregon një rritje të lehtë krahasuar me gjetjet e SBV-së për vitin 2002 si tregohet më poshtë⁶⁸.

Tabela 5: Anëtarësimi në partitë politike (2002) në %


Anëtarësimi në partitë politike	2002
Nuk i përkasin	85.5
I përkasin	14.5

Burimi: Vala e 4-t e SBV-së

⁶⁸ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim & CIVICUS, (2010) Indeksi i Shqërisë Civile për Shqipërinë. Në Kërkim të qytetarit dhe ndikimit. F.15

Marrëdhëniet ndërmjet kënaqësisë nga jeta dhe përfshirjes në politikë

Figura 16: Kënaqësia nga jeta dhe anëtarësia në partitë politike (2002) në %



Burimi: vala e 4-t e SBV-së

Figura 16 tregon marrëdhënien ndërmjet kënaqësisë nga jeta dhe anëtarësisë në partitë politike gjatë vitit 2002 për rastin e Shqipërisë. Duket se njerëzit të cilët perceptojnë vetveten si shumë të lumtur dhe ata të cilët perceptohen si “*aspak të lumtur*” priren të kenë një nivel më të ulët anëtarësie në partitë politike, krahasuar me ata që shprehin një nivel të moderuar kënaqësie. Kjo gjetje, mund të shpjegohet duke përdorur dy qasje: atë psikologjike dhe atë socio-ekonomike.

Nga këndvështrimi psikologjik, theksohet se ata të cilët deklarohen si aspak të lumtur jetojnë nën stres dhe kanë tendencë depressive. Kjo bën që ata të mos marrin pjesë aktivisht në politikë. Ata të cilët deklarohen si “*shumë të lumtur*”, nga ana tjetër, qëndrojnë larg politikës sepse ndihen të kompletuar dhe nuk e shohin të nevojshme pjesëmarrjen në parti politike⁶⁹. Ky konkluzion u mbështet edhe gjatë Fokusgrurit të parë, ku pjesëmarrësit argumentuan se këta individë janë konformistë dhe si të tillë qëndrojnë larg politikës.

Nga ana socio-ekonomike Easterlin (2001) argumenton se burimi i lumturisë përcaktohet nga tre faktorë kryesorë: sigurimi i jetesës, jeta familjare dhe shëndeti⁷⁰. Si rrjedhojë grupi i atyre që ndihen “*aspak të lumtur*” përbëhet prej shtresave të varfra dhe të margjinalizuara të cilët janë shumë të shqetësuar për mbijetesën e përditshme dhe nuk kanë as kohën e dëshirën që të merren me politikë. Duke ndjekur këtë linjë mendimi, pjesëmarrësit e Fokusgrurit të parë argumentuan se të marxhinalizuarit dhe të lënit mënjane nga shoqëria, tregojnë nivele të ulëta pjesëmarrjeje sepse ata janë të preokupuar kryesisht për sigurimin e jetesës së përgjithshme.

⁶⁹ Weitz-Shapiro, Rebecca & Winters, Matthew S. 2008. Political participation and quality of life, Research Department Working Papers; 638. Inter-American Development Bank. 1300 New York Avenue, N.W. Washington, DC 20577, f.12

⁷⁰ Easterlin, Richard, 2001, Income and happiness: towards a unified theory. The economic Journal, 111 (July), 465-484, Royal Economic Society 2001. Published by Blackwell Publishers, 108 Cowley Road, Oxford, OX41, JF, UK and 350 Main Street, Malden, MA 021 48, USA, f.466

Për më tepër u argumentua se një tjetër faktor i cili ndikon në pjesëmarrjen e ulët në politikë të këtij grupi është mungesa në pjesëmarrjen politike si rrjedhojë e lidhjeve klienteliste dhe përjashtuese që karakterizojnë pjesëmarrjen në politikë në Shqipëri.

Përsa i përket nivelit të ulët të pjesëmarrjes së atyre që vetëperceptohen si “shumë të lumtur” sipas këndvështrimit socio-ekonomik studiues të ndryshëm parashikojnë se pasojat që lidhen me pjesëmarrjen politike dhe angazhimin qytetar do të jenë më të larta për ata që shfaqin nivele të moderuara kënaqësie. Duke qenë se pjesëmarrja politike motivohet pjesërisht edhe nga pakënaqësia me situatën aktuale politike, ata të cilët janë shumë të kënaqur, mundet që të mos perceptojnë nevojën për ndryshim⁷¹. Në një diskutim gjatë Fokusgrupit të parë, u theksua se ata të cilët ndihen shumë të lumtur janë dhe ata të cilët ndihen shumë të pasur dhe ata të cilët kanë biznese të suksesshme. Këto biznese shpesh varen nga lidhjet informale që këta kanë me njërin ose tjetrin grup politik. Për më tepër, të frikësuar se një përkatësi politike e qartë mund të ndikojë mbi bizneset e tyre kur qeveria të ndërrohet, këta stepen të marrin pjesë në njërin ose tjetër parti politike haptazi dhe preferojnë të deklarojnë se nuk kanë përkatësi politike.

Një tjetër kategori njerëzish e cila është e lumtur por qëndron larg angazhimit në u theksua gjatë diskutimeve të fokusgrupit të dytë dhe shpjegohet në Kutinë 5 më poshtë.

Kutia 5: Shumë të kënaqur por të lodhur me politikën


Gjatë diskutimeve në fokusgrupin e dytë u identifikua një tjetër kategori e cila mund të jetë e kënaqur me jetën, por që gjithsesi nuk dëshiron të marrë pjesë në politikë. Kjo kategori, u korrespondon atyre ekspertëve të pavarur të cilët lihen shpesh mënjanë nga politikanët dhe politikëbërësit gjatë viteve të fundit të tranzicionit. Këta ndihen të zhgënjyer dhe të lënë mënjanë dhe preferojnë që t'i qëndrojnë larg politikës dhe retorikës së saj dhe si rrjedhojë nuk paraqesin interes sa i përket pjesëmarrjes në parti politike ose në politikë.

Marrëdhënia ndërmjet kënaqësisë nga jeta dhe pjesëmarrjes në aksion politik

Pjesëmarrja në aksion politik, nxirret nga pyetje të cilat pyesin të anketuarit nëse do të merrnin pjesë në veprime të tilla si demonstratat e ligjshme dhe të pa ligjshme dhe firmosja e peticioneve ndërsa kënaqësia nga jeta llogaritet bazuar në pyetjen: Duke konsideruar gjithçka, sa të kënaqur jeni me jetën tuaj në përgjithësi sot.


⁷¹ Klandermans, B. (1989), “Does happiness soothen political protest? The complex relation between discontent and political happiness”. In: Veenhoven, R. (1989), “How harmful is happiness consequences of enjoying life or not”; Universitaire Pers; Rotterdam, the Netherlands. f.135 [On-Line] at: <http://www2.eur.nl/fsw/research/veenhoven/Pub1980s/89a-C7-full.pdf>. Aksësuar në 30 12. 2010.

Figura 17: Kënaqësia nga jeta dhe firmosja e peticioneve në 2002 në %



Burimi: Vala e 4-t e SBV-së

Figura 18: Kënaqësia nga jeta dhe pjesëmarrja në demonstrata të ligjshme 2002




Burimi: Vala e 4-t e SBV-së

Marrëdhënia ndërmjet kënaqësisë nga jeta dhe pjesëmarrjes në dy aksione politike si pjesëmarrja në firmosjen e peticionit dhe pjesëmarrjes në demonstrata të ligjshme, tregohet në Figurat 17 dhe 18 më sipër. Duket se ata që i përkasin grupit pak të kënaqur kanë një nivel më të lartë pjesëmarrjeje në aksion politik sesa ata që i përkasin grupit pak të kënaqur. Një tjetër tendencë që të bie në sy është disproporcioni ndërmjet atyre që thonë se kanë bërë dhe atyre që thonë se do të bëjnë një nga veprimet politike të mësipërme. Duket se këtu ka një kontradiktë ndërmjet dëshirës për të marrë pjesë në një aksion politik dhe asaj çka ndodh në praktikë. Kjo kontradiktë ndërmjet dëshirës dhe realizmit të saj në praktikë të bën të pyesësh. Sa të lirë ndihen

qytetarët shqiptarë për të marrë pjesë në veprime politike ose e thënë ndryshe: A kanë këta liri të mjaftueshme shprehjeje dhe kontrolli?


Figura 19: Niveli i perceptuar i lirisë së zgjedhjes dhe përfshirja në firmosjen e një peticioni 1998 dhe 2002



Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së


Figura 19 më sipër analizon marrëdhënien ndërmjet nivelit të perceptuar të lirisë dhe kontrollit dhe gatishmërisë për ndërmarrjen e një veprimi politik (firmosje peticioni) për vitin 1998 dhe 2002. Gjatë vitit 1998 duket se kemi një lidhje direkte dhe gjatë 2002 duket se lidhja është indirekte.

Figura 20: Pjesëmarrja në aksione politike (1998)



Burimi: Vala e 3-të e SBV-së

Figura 21: Pjesëmarrja në aksione politike (2002)



Burimi: Vala e 4-t e SBV-së

Figura 20 dhe 21 më sipër tregojnë qasjen kundrejt tre aksioneve politike: firmosja e peticionit, marrja pjesë në bojkot, marrja pjesë në demonstratë të ligjshme gjatë vitit 1998 dhe 2002. E njëjta tendencë konfirmohet gjithashtu dhe nga CIVICUS 2010 sipas së cilit kur pyetet për pjesëmarrjen në aksionet politike të tilla si firmosja e peticionit, marrja pjesë në bojkot dhe marrja pjesë në demonstratë të ligjshme, mesatarisht rreth 28.2 përqind e të anketuarve thekson pjesëmarrjen në këto veprime gjatë pesë viteve të fundit i.e. 2004-2009⁷². Shifrat e grafikëve të mësipërm tregojnë më konkretisht disproporcionin ndërmjet atyre që thonë se kanë marrë pjesë dhe se mund të marrin pjesë që u theksua dhe më sipër. Ajo që bie në sy gjithashtu është se ka një numër të madh anketuesish që theksojnë se nuk do të marrin pjesë në bojkote dhe në greva të paligjshme. Ndërkohë dihet se në periudhën e anketuar bojkoti politik ka qenë një fenomen gjerësisht i praktikuar nga politikanët dhe publiku shqiptar sidomos në vitin 1996 kur opozita e atëhershme u tërhoq nga zgjedhjet e në vazhdim. Nga ana tjetër, që nga vitet 1990 gjithashtu dhe grevat e urisë, si dhe gjithfarë mitingjesh më të vona të paligjshme, janë organizuar gjerësisht dhe njerëzit kanë marrë pjesë në to.

Ekziston edhe një kontradiktë tjetër e dukshme nga grafikët e mësipërm. Në periudhën e të dhënave, por edhe më vonë, Shqipëria duket të jetë e orientuar drejt informalitetit. Kështu së fundmi një raport i CIA, World Fact Book thekson se niveli i informalitetit për Shqipërinë është 50%⁷³. Duke marrë shkas nga ky pohim mund të theksojmë se në vitin 1998 kur shteti ende po merrte veten nga kolapsi i piramidave të një viti më parë dhe institucionet po riformoheshin pas kolapsit të përgjithshëm që pësuan, sistemi i mbledhjes së taksave që shumë më i dobët sesa sot, ndërkohë niveli i informalitetit mund të ketë qenë edhe më i lartë. Arsye që shpjegojnë pjesëmarrjen e ulët në forma normale dhe demokratike të veprimeve politike, siç u theksua edhe në Fokusgrupin e parë, janë mungesa e eksperiencave dhe niveli i ulët i kulturës politike. Gjatë fokusgrurit të dytë, pjesëmarrësit vërejtën se në përgjithësi ka shumë pjesëmarrje kur vjen

⁷² Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe CIVICUS, (2010) Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë. Në Kërkim të qytetarit dhe ndikimit., 14

⁷³ <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/al.html>

fjala për të dhënë ide, por mungon pjesëmarrja politike konkrete sepse asnjë nuk do të paguajë faturën e të qenit politikisht aktiv duke marrë pjesë në veprime politike.

Arsye të tjera që mund të shpjegojnë mospjesëmarrjen në aksione politike përfshijnë edhe zhgënjimin nga integriteti moral i politikanëve. Për më tepër, në fokusgrupin e dytë u theksua se njerëzit po bëhen të ndërgjegjshëm se pritshmëritë e tyre nuk arrijnë të realizohen plotësisht nga shteti. Sipas kësaj pikëpamjeje, efektiviteti i ulët që shteti ka në politikat sociale, kombinuar edhe me integritetin e ulët moral të klasës politike duket se e bën diçka normale nivelin e ulët të pjesëmarrjes politike.


Kontradikta ndërmjet praktikimit të lartë dhe pranueshmërisë së ulët të pjesëmarrjes në aksione politike mund të shpjegohen deri diku dhe nga kultura e dobët e intervistimit në Shqipëri. Pra, sipas kësaj qasjeje, mund të argumentohet se të intervistuarit disa herë frikësohen të tregojnë të vërtetën duke u frikësuar se pohimi i tyre për pjesëmarrje në ndonjë aksion politik mund të ketë pasoja për ta. Në këtë rast, duket se ky grup ka një nivel të ulët perceptimi të lirisë dhe kontrollit për të vendosur.

2.6. Besimi në përgjithësi, qëndrimet politike dhe sjelljet shoqërore

Besimi në përgjithësi në Shqipëri

Besimi në përgjithësi është një koncept i cili gjendet duke analizuar pyetjen e SBV-së: “Në përgjithësi a mendoni se shumica e njerëzve mund të besohen apo mendoni se duhet pasur kujdes”⁷⁴. Figura 22 më poshtë, tregon nivelin e besimit në përgjithësi në Shqipëri gjatë viteve 1998 dhe 2002. Gjatë vitit 1998, vetëm 24.3% e të anketuarve theksojnë se shumicës së njerëzve mund t’u besohet dhe gjatë vitit 2002, kjo shifër ulet edhe më shumë duke arritur në 23.2%. Një tjetër sondazh zhvilluar në vitin 2009, tregon se trendi i besimit në përgjithësi është edhe më i ulët me 92.5% të të anketuarve që thonë se duhet pasur kujdes dhe me vetëm 7.5% të të anketuarve të cilët thonë se njerëzve mund t’u besohet⁷⁵.

Figura 22: Besimi në përgjithësi 1998, 2002 në %



Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së

⁷⁴ Paldam, M. (2000) “Missing Social Capital and the transition in Eastern Europe”, Journal for Institutional Innovation, Development and Transition. [On Line].: http://research.asb.dk/ws/fbspretrieve/250/00-5_gts.pdf. f. 20

⁷⁵ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjeësim dhe CIVICUS, (2010) Indeksi i Shqërisë Civile për Shqipërinë. Në Kërkim të qytetarit dhe ndikimit. f.28

Besimi në përgjithësi në Shqipëri duket se është i ulët edhe kur krahasohet me vendet ish-komuniste të Evropës Lindore. Kështu, për shembull, në vitin 1998, 51% e të intervistuarve nga New Democracies Barometer në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore theksuan se shumicës së njerëzve mund t'u besohet⁷⁶. Gjithashtu, duke krahasuar në periudhë kohore tendencat e ndryshimit në nivelet e besimit në përgjithësi të Shqipërisë dhe disa vendeve ish- komuniste, duket se Shqipëria shfaq tendenca përkeqësuese. Kështu p.sh. në Rusi gjatë vitit 2000 të intervistuarit që theksuan se shumica e njerëzve mund të besoheshin ishin 66% krahasuar 34% gjatë vitit 1998⁷⁷. Të dhënat që jepen nga SBV për Shqipërinë gjatë periudhës 1998 dhe 2002 dhe ato që jepen nga sondazhi i vitit 2009 më sipër tregojnë se besimi në përgjithësi në Shqipëri ka ardhur duke u ulur nga 24.3% në vitin 1998 në 23.2% në vitin 2002.

Një situatë disi më optimiste paraqitet kur besimi në përgjithësi në Shqipëri krahasohet me vendet e rajonit siç tregohet në Tabelën 5 më poshtë. Nga kjo tabelë shikohet se Shqipëria renditet pas Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnjës dhe përpara Maqedonisë dhe Kroacisë. Pra shohim se Shqipëria qëndron në mes të renditjes rajonale dhe nuk është vendi i fundit sa i përket nivelit të besimit në përgjithësi në rajon.

Tabela 6: Besimi i përgjithësuar në rajon (1996-2002) in %

	Shqipëria		Bosnja		Kroacia		Maqedonia		Mali i Zi		Serbia	
	1998	2002	1998	2001	1996	1999	1998	2001	1996	2001	1996	2001
Njerëzve mund t'u besohet	24.7	23.2	24.8	24.8	22.8	17.9	7.5	13.1	30.4	32.9	28.4	18.3

Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së

Duke përgjithësuar, mund të thuhet se pavarësisht variacioneve të ndryshme, niveli i besimit tek njerëzit mbetet i ulët në vendet post-komuniste të EQL-së, nëse krahasohet me vendet e Evropës Perëndimore. Një faktor që mund ta shpjegojë nivelin e ulët të besimit në përgjithësi, është edhe e ashtuquajtura *“trashëgimi nga komunizmi”*. Në lidhje me këtë, Ackerman (2006) thekson dy argumente që ndihmojnë për shpjegimin e mungesës së besimit në tërësi në shoqëritë në tranzicion nga socializmi drejt demokracisë. Së pari, argumentohet se dështimi i përgjithshëm i ekonomive të planifikuara, ka çuar drejt një bashkëpunimi më të ngushtë ndërmjet familjes dhe shoqërisë, si strategji për të anashkaluar këtë mosfunksionim, dhe se pikërisht kjo ka forcuar ndjesinë e jetës në komunitet. Kjo ndjesi e kushtëzuar, u shpërbë gjatë lëvizjes drejt ekonomisë së tregut dhe demokracisë, duke sjellë si pasojë një mungesë të besimit dhe një rritje të oportunitizmit. Faktori i dytë, lidhet me mungesën e legjitimitetit të qeverive komuniste. Sipas këtij arsyetimi qeveritë komuniste ishin të imponuara dhe jo të ardhura në fuqi me anë të zgjedhjeve të lira. Kjo bënte që qytetarët të perceptonin se aktorët zyrtarë shtetërorë ishin në shërbim të vetes së tyre dhe

⁷⁶ Ackerman, S.R. (2001) “Trust, Honesty, and Corruption: Theories and Survey Evidence from Post-Socialist Societies Towards a Research Agenda for a Project of the Collegium Budapest” [On Line]: <http://www.colbud.hu/honesty-trust/rose/pub01.PDF> Accessed on December 2010 , f.5

⁷⁷ Po aty, f.13

rregullat që ata krijojnë ishin gjithashtu të padrejta. Kjo ka kontribuar në uljen e besimit social tek institucionet dhe organet shtetërore⁷⁸.

Përsa i përket kontekstit shqiptar të besimit, në përgjithësi mund të argumentohet se ai influencohet si nga faktorë të së shkuarës, edhe të së tashmes. Duke folur për të shkuarën para-komuniste, mund të theksohet se si shkak i vonësive në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, Shqipëria e fillim shekullit të 20-të karakterizohej nga tipare të theksuara të feudalizmit dhe nga një zhvillim i vonuar institucional. Sipas Fischer (1996) *“Atje [në Shqipëri] ishte krijuar një kuptim shoqëror i kristalizuar në mosbesimin e madh kundrejt shtetit dhe jetës në komunitet. (...).”*⁷⁹

Përsa i përket Shqipërisë, gjatë periudhës së tranzicionit, të dhënat tregojnë se besimi në përgjithësi ka pasur tendencë të jetë më i lartë sesa gjatë periudhës komuniste. Sipas një pyetësori zhvilluar nga AIISS në vitin 2010, 68% e të intervistuarve theksojnë se besimi në përgjithësi ishte i ulët ose shumë i ulët, ndërsa përsa i përket të sotmes, mund të thuhet se 83.1% e të anketuarve kanë theksuar se ata besojnë njëri-tjetrit në nivele të ulëta ose shumë të ulëta⁸⁰. Në lidhje me këtë, një ide interesante u nda gjatë fokus grupit të dytë sipas së cilës komunizmi në Shqipëri synonte më së shumti një bindje sociale dhe ideologjike sesa forcimin gradual të besimit social në përgjithësi.

Siç u tregua dhe më sipër, besimi në përgjithësi mbetet në nivele të ulëta, edhe gjatë periudhës së tranzicionit post-komunist. Një faktor i rëndësishëm, i cili influencon këtë tendencë, është dhe mbyllja e fabrikave dhe uzinave gjatë tranzicionit të cilat krijojnë kushte për forcimin e ndjenjës së komunitetit, për shkak se përfshinin grupe të mëdha punëtorësh që punonin pranë njëri-tjetrit. Për më tepër, e kjo sidomos në zonat rurale, mbyllja e qendrave të kulturës, teatreve, kinemave dhe aktiviteteve kulturore gjatë periudhës së tranzicionit, influencuan në uljen e ndjesisë së komunitetit dhe në forcimin e individualizmit, çka mund të ndikojë edhe në uljen e besimit ndaj të tjerëve⁸¹. Në lidhje me këtë gjatë fokus grupit të dytë u theksua se organizatat sociale dhe strukturat sociale kanë një rol gjithnjë e më të ulët në shoqërinë shqiptare, dhe organizimet me karakter social po ngushtohen gjithnjë e më shumë. Kjo ka kontribuar në rritjen e ndjesisë individualiste dhe në uljen kohezionit social si dhe në rënien e besimit në përgjithësi. Për më tepër si faktorë të tjerë që kanë kontribuar në uljen e besimit mund të renditen një sërë fenomenesh që lidhen me problemet me pronësinë, lëvizjen demografike të pakontrolluar dhe masive, zënia e tokës etj, të kombinuara këto edhe me dështimin e shtetit dhe institucioneve, për të vepruar si rregullatorë për këto çështje, duke kontribuar gjithashtu për rritjen e mosbesimit dhe uljen e besimit social⁸².

⁷⁸ Ackerman, S.R. (2001) “Trust, Honesty, and Corruption: Theories and Survey Evidence from Post-Socialist Societies Towards a Research Agenda for a Project of the Collegium Budapest” [On Line]: <http://www.colbud.hu/honesty-trust/rose/pub01.PDF> Accessed on December 2010, fq. 1.

⁷⁹ Fischer, B. (1996) “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri”, Tiranë, Shtëpia Botuese Cabej, f. 55.

⁸⁰ AIISS, (2010). “Twenty Years After: Rethinking Democracy and State in Albania”. Tiranë, Dhjetor 2010


⁸¹ Fuga, A. (2004). “Shoqëria periferike” Botimet Ora: Tiranë, f. 63.

⁸² Gajo, A. (2001). “Shqipëria, demokraci në deficit.” Tiranë: Qendra Europiane për Kërkim dhe Zhvillim. f. 53.

2.6.1. Besimi në përgjithësi, besimi ndërpersonal dhe rrjetet informale

Për të analizuar raportin ndërmjet besimit në përgjithësi dhe atij ndërpersonal ky seksion krahason rëndësinë që i jepet familjes dhe shokëve në njërin anë dhe nivelet e besimit në përgjithësi nga ana tjetër. Duket se rëndësia e madhe që i vendoset familjes dhe rrethit shoqëror (shiko Figurën 23) është në disproporcion me nivelet e ulëta të besimit në përgjithësi.

Figura 23: Rëndësia e familjes, shokëve dhe besimi në përgjithësi në 1998 dhe 2002 në %



Burimi: Vala e 3-të dhe 4-të, SBV-së

Rëndësia e madhe që shqiptarët i atribuojnë familjes dhe rrethit të ngushtë të miqve, mund të merren edhe si formë përfaqësuese të rrjeteve informale të besimit ndërpersonal. Studiues të ndryshëm argumentojnë se për të bërë jetesën e tyre të përballueshme, njerëzit që jetojnë në shoqëri të korruptuara, duhet që të zhvillojnë shumë kontrata sociale me njerëz të cilëve mund t'u besojnë. Mungesa e normave detyruese duket se zhvillojnë mosbesim, zili, pesimizëm kundrejt njerëzve në përgjithësi. Lloji i besimit që ata mund të zhvillojnë nën këto rrethana është tek persona të afërt të cilëve ata mund t'ju besojnë. Por në anën tjetër ata duket se kanë zhvilluar një mosbesim, zili dhe pesimizëm kundrejt “njerëzve në përgjithësi”. Ky lloj besimi kontribuon për krijimin e asaj që quhet prej Ahn dhe Esseray si “besimi ndërpersonal”, çka do të thotë që njerëzit besojnë vetëm shokët dhe kushërinjtë por nuk besojnë njerëzit jashtë rrethit të tyre të ngushtë⁸³.

Niveli i lartë i rëndësisë që i kushtohet familjes dhe lidhjeve miqësore në Shqipëri, shpjegohet dhe nga fakti se individët kanë tendencë që të vlerësojnë më shumë personat me të cilët ata ndajnë të njëjtat objektiva, dhe me të cilët ata kanë një besim të përbashkët në vlera të përbashkëta morale⁸⁴. Disproporcioni ndërmjet rëndësisë së madhe që i jepet familjes e shokëve dhe niveleve të ulëta të besimit në përgjithësi, mund të shpjegohet edhe nga fakti se sot hapësira shoqërore është ngushtuar tej mase. Për shembull, pjesa më e madhe e bizneseve organizohen në baza familjare. Në këtë mënyrë, marrëdhëniet e punës shpesh përzihen me ato familjare, çka kontribuon në një pjesëmarrje

⁸³ Ahn, T. K. and Esseray, J. (2008). “A dynamic model of Generalized Social Trust.” *Journal of Theoretical Politics* 20(2): 151–180. [On Line]: <http://jtp.sagepub.com>, f. 153.

⁸⁴ Braithwaite, V. (1998). Communal and exchange trust norms, their value base and relevance to institutional trust. In V. Braithwaite & M. Levi (Eds.), *Trust and governance*. New York: Russell Sage (pp. 46-74). [On Line]. Available at: <http://vab.anu.edu.au/pubs/1/trustandgov.pdf>. f. 58.


të ulët në jetën publike dhe influencon në nivele të ulëta të besimit në përgjithësi. Kjo pikëpamje u nxor në pah gjithashtu gjatë Fokus Grupit të dytë të realizuar në kuadër të kësaj problematike.

Përgjithësimet e mësipërme lidhur me Shqipërinë mbështeten gjithashtu edhe nga studime të tjera që lidhen me vendet ish-komuniste. Kështu, Paldam (2000), për shembull, thekson se në shoqëritë komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore, duke qenë se organizatat formale dështonin vazhdimisht në kryerjen e funksioneve të tyre, bashkëveprimi ndërmjet familjes, shokëve, etj., ishte e vetmja mënyrë për t'i bërë gjërat funksionale. Si rrjedhojë, njerëzit përgjithësonin besimin që ata kishin në këto rrjete informale edhe për të tjerët në shoqëri. Duke qenë se besimi ishte dyshues gjatë komunizmit, ai i rezervohej kryesisht familjes dhe rrethit të ngushtë miqësisë ndërsa besimi në përgjithësi ka vuajtur nga një erozion i gjerë⁸⁵.

2.6.2. Sjelljet sociale dhe besimi në përgjithësi

Liria individuale për të zgjedhur shtohet nga fakti se shoqëritë bashkëkohore karakterizohen nga ekzistenca e shumë opsioneve të ndryshme. Në thuajse të gjitha sferat e jetës opsione potenciale zgjerohen dhe thellohen gjatë ushtrimit të lirisë së zgjedhjes dhe zgjedhjes së mundësive alternative, njerëzit shpesh bazohen tek besimi në përgjithësi.⁸⁶ Roli i lirisë së zgjedhjes është i dukshëm sidomos sa i përket marrëdhënies ndërmjet besimit në përgjithësi dhe sjelljeve qytetare/atipike. Rothstein dhe Urslaner (2005) theksojnë se besimi në përgjithësi mund të shpjegohet, ndër të tjera, edhe me nivelin e pabarazisë në shoqëri. Në këtë aspekt është interesante të shikohet qëndrimi kundrejt sjelljeve të shoqërisë shqiptare duke u fokusuar në ato sjellje të cilat kanë të bëjnë me tjetrin, të të ndryshmes dhe që mund të kontribuojnë për rritjen e pabarazisë shoqërore.

Figura 24: Pranueshmëria e sjelljeve shoqërore morale 1998 në %




Burimi: Vala e 3-të, SVB-së

⁸⁵ Paldam, M. (2000) "Missing Social Capital and the transition in Eastern Europe", Journal for Institutional Innovation, Development and Transition. [On Line]. Available at: http://research.asb.dk/ws/fbspretrieve/250/00-5_gts.pdf. f. 769

⁸⁶ Salaj, Berto Social trust: Croatia 1995-2003, Politicka misao, Vol.XLII, No.5, f. 77-98, Pregledni clanak, 323.21 (497.5), Prilijeno: 20. kolovoza 2006, f. 86.

Figura 25: Pranueshmëria e sjelljeve sociale morale 2002 në %




Burimi: Vala e 4-të, SBV-së

Duke parë të dhënat e figurave 24 dhe 25, mund të thuhet se në përgjithësi gjatë periudhës së shqyrtuar vërehet se shqiptarët priren të jenë jotolerantë përkundrejt sjelljeve të tilla shoqërore si prostitucioni dhe homoseksualiteti, ndërkohë që priren të jenë më tolerante dhe të justifikojnë abortin apo divorcin. E njëjta prirje është vënë re në sondazhet e vitit 1998 dhe 2002. Shoqëria shqiptare karakterizohet nga përjashtimi i madh që i bën homoseksualëve dhe atyre të infektuar me HIV/AIDS. Kur merren parasysh të njëjtat lloje sjelljeje, një tjetër sondazh organizuar prej IDN dhe Civicus brenda kornizës së Indeksit të Shoqërisë Civile tregon se niveli i pranueshmërisë për abortin(3.48), divorcin(5.04), homoseksualitetin(2.15) dhe prostitucionin(1.77), nëse vlerësohen në një shkallë nga 1 në 10 ku 1 është i papranueshëm dhe 10 është i pranueshëm ⁸⁷. Kjo ndodh më së shumti, pasi shoqëria jonë priret t'i shohë këto fenomene si degradim moral ndërsa të dytat si një lloj sëmundje infektive të ngjashme me gripin. Gjithsesi, nuk do të futemi në detaje për të shpjeguar sjelljet shoqërore të lartpërmendura meqenëse kjo shkon përtej synimit të këtij studimi. Ato janë sjellë këtu për të treguar se shoqëria shqiptare priret të shfaqë pozicione përjashtuese kundrejt grupeve të marginalizuara, çka dobëson kohezionin dhe barazinë sociale. Ajo për të cilën jemi të interesuar kur analizojmë sjelljet shoqërore, janë ato sjellje që krijojnë njëfarë lidhjeje me pozicionin politik të shoqërisë, që do të trajtohet në seksionin pasardhës.

⁸⁷ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe CIVICUS, (2010) Indeksi i Shqërisë Civile për Shqipërinë. Në Kërkim të qytetarit dhe ndikimit. F. 24


Sjelljet shoqërore kundrejt qëndrimeve politike

Figura 26: Pranueshmëria e sjelljeve politike 1998 në %



Burimi: Vala e 3-të e SBV-së

Figura 27: Pranueshmëria e sjelljeve atipike 2002 në %



Burimi: Vala e 4-t e SBV-së

Disa sjellje shoqërore si p.sh. qëndrimi kundrejt mashtrimit me taksat, pranimit të rryshfetit, pretendimi për përfitime nga qeveria që analizohen në Figurat 25 dhe 26 krijojnë lidhje me qëndrimet politike të individëve. Të dhëna nga SBV-ja tregojnë se një numër i madh të

intervistuarish perceptojnë si të papranueshme sjellje të tilla si mashtrimi me taksa, pranimi i ryshfetit, mospagesa e biletës në transport publik dhe blerja e mallrave të vjedhur. E njëjta tendencë konfirmohet gjithashtu nga një tjetër sondazh lokal i cituar më poshtë i cili vlerëson pranueshmërinë e sjelljeve të përmendura më sipër sipas një shkalle vlerësimi 1-10 ku një do të thotë e pajustificueshme dhe 10 do të thotë plotësisht e justifikueshme. Disa prej rezultateve që bazohen në këtë vlerësim tregohen në tabelën e mëposhtme. Edhe këtu shikohet se niveli i justifikueshmërisë ndaj këtyre sjelljeve mbetet në nivele të ulëta.

Tabela 7: Pranimi i disa sjelljeve shoqërore me implikime politike

Mospagesa në shërbimin publik	2.27
Evitimi i taksave	2.23
Pretendimi për përfitime nga qeveria	1.95
Korrupsion në detyrë	1.68

Burimi: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe CIVICUS, (2010) Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë. Në Kërkim të qytetarit dhe Ndikimit.

Kur konsiderohet niveli i pranueshmërisë së sjelljeve shoqërore, duket se në shoqërinë shqiptare ekziston një kontradiktë e fortë. Nga njëra anë shumica e shqiptarëve të pyetur nuk pranojnë sjelljet negative shoqërore si evazoni fiskal dhe pranimi i ryshfetit. Nga ana tjetër të dhëna të tjera tregojnë se niveli i korrupsionit dhe evazionit fiskal mbetet i lartë në realitetin shqiptar, pavarësisht përpjekjeve inkurajuese gjatë viteve të fundit dhe një përmirësimi të lehtë (shiko pikën 5.6.6.4 për disa gjetje rreth korrupsionit).

Në mënyrë që të gjejmë shkaqet, nga një këndvështrim teorik, mund të thuhet se ato janë të natyrave të ndryshme. Dy nga këto ja vlen ti përmendësh në konteksti tonë. E para është se ndërsa shumica e të anketuarve besojnë sinqerisht se veprimet si korrupsioni dhe mashtrimi me taksat janë të papranueshme në teori, kjo tendencë nuk pasqyrohet në sjelljet e tyre të përditshme. Gjatë së përditshmes siç kemi theksuar dhe më përpara shumica e njerëzve pranojnë ose japin ryshfet ose përdorin forma të evazionit fiskal. Mund të jetë që kjo është ajo e cila mishëron kontradiktën ndërmjet funksionimit të institucioneve dhe qëllimeve morale të qytetarëve. Gjithashtu mundet që një pjesë e institucioneve të shihen si burime përfitimi nga një pjesë e qytetarëve.

Arsyeja e dytë për shfaqjen e kësaj kontradikte ka të bëjë edhe me perceptimin e gabuar që ekziston në Shqipëri për sondazhet. Siç kemi theksuar, pyetësorët të cilët përfaqësojnë Shqipërinë i përkasin periudhës 1998 dhe 2002, një kohë kur shqiptarët ende nuk ishin mësuar të shpreheshin lirshëm duke e konceptuar sondazhin siurvejim. Ky perceptim i gabuar është një fenomen tipik për vende si post-komuniste si Shqipëria. Vijmë nga një sistem i egër stalinist ku çdokushurvejonte gjithkënd. Në këto rrethana, sidomos gjatë periudhës 1990-2000 dhe disi më pak në ditët e sotme, shumica e subjekteve besonin se përgjigjet e tyre do të raportoheshin diku dhe se kjo mund të kishte pasoja për të ardhmen e tyre.

Kutia 6: Kundërshtia mes të praktikuarit dhe të pranuarit të vlerave

Kur pyeten mbi disa prej arsyeve që shpjegojnë kontradiktën midis praktikimit dhe pranimit të sjelljeve atipike, pjesëmarrësit e Fokus Grupit u përgjigjën se: *“Shoqëria shqiptare ka standard të dyfishta kur vjen puna tek sjelljet atipike. Teorikisht ata pranojnë rregullat dhe ligjet dhe thonë se nuk tolerojnë sjellje të tilla ndërkohë që në fakt i praktikojnë këto sjellje në momentin që interesi i tyre personal preket”.*


Për më tepër, pjesëmarrësit e Fokus Grupit të dytë pranuan gjithashtu se: *“Raporti ndërmjet standardeve morale dhe atyre realisht të aplikuara është në një pozitë tejet kritike në shoqërinë aktuale shqiptare”.* Sipas të njëjtit burim kjo kontradiktë është e dukshme në shoqërinë shqiptare për sa kohë *“rezulton të ketë probleme në përkufizimin e rregullave dhe normave në shoqërinë e sotme”.* Vlerat kalojnë përmes një procesi transformimi para se të pranohen nga shoqëria dhe janë rezultatet e proceseve të tilla sesa diçka të imponuar mekanikisht nga lartë poshtë dhe të shkruara në gur si të pandryshueshme”.

Tranzicioni në ekonominë e tregut ka krijuar një boshllëk të thellë midis të pasurit dhe mos të pasurit. Njerëzit e gjykojnë qeverinë nga efikasiteti i saj në përforcimin e drejtësisë. Por të dhënat në terren sugjerojnë pikërisht se sistemi politik favorizon disa njerëz, që këta të jenë mbi ligjin dhe ky model zgjat pavarësisht ndryshimeve në qeveri. Qartësisht, kjo nuk mund të ndihmojë në krijimin e kapitalit shoqëror; ajo vetëm sa përforon partikularizmin dhe sjelljen informale dhe gjeneron në rreth vicioz, siç u deklarua edhe në diskutimin me fokus grupin e dytë. Është e kupueshme që pozicionime të tilla influencojnë negativisht besimin tek drejtësia dhe institucione të ndryshme, dhe si të tilla përbëjnë një erozion për besimin e përgjithësuar në veçanti dhe besimin social në përgjithësi.

Korrupsioni në Shqipëri

Gjetjet që rezultojnë nga Sondazhi Botëror mbi Vlerat, si edhe nga shumë instrumente të tjera si Gallup, Balkan Monitor, IDRA, Banka Botërore, etj., sugjerojnë se korrupsioni përbën një dukuri të përhapur megjithë përpjekjet që bëhen për ta luftuar atë.


Figura 28: Indeksi i korrupsionit në Shqipëri në vite⁸⁸ (WB, Aggregate Governance Indicators 1996-2006)



⁸⁸ Burimi i këtij informacioni është një tufë indikatorësh për 6 dimensione të qeverisjes. Këta indikatorë janë ndërtuar duke përdorur një metodologji të posacme. Sipas saj përdoren gjashtë indikatorë të qeverisjes të cilët rankojnë nga -2.5 në 2.5, në të cilët vlerat më të larta korrespondojnë me rezultate më të mira në qeverisje. Referencë për këtë projekt kërkimor është: Daniel Kaufmann, Aart Kraay and Massimo Mastruzzi (2007). “Governance Matters VI: Governance Indicators for 1996-2006”. World Bank Policy Research #4280 July 2007

Mentaliteti i përhapur në vend është se korrupsioni ekziston në nivelet e larta të administratës dhe të ekipeve drejtuese në përgjithësi, ndërsa në anën tjetër nuk bie shumë në sy fakti i përhapur i korrupsionit të vogël, i cili korrumpion gjithashtu në përmasa më të vogla, por më masive dhe që nuk tërheq shumë vëmendjen e publikut. Kjo vihet re me qartësi në grafikun e mëposhtëm i cili pasqyron prirjen në rritje të korrupsionit mes zyrtarëve publikë në intervalin 2005-2009.

Figura 29: Korrupsioni ndërmjet zyrtarëve publikë



Burimi, IDRA, Albania, 2010⁸⁹

Në këto kushte, vihet në dukje se çështja e korrupsionit mund të shihet në dy aspekte. Aspekti i parë është korrupsioni faktik, pra ai i cili është i dëshmuar, i gjykuar dhe i ndëshkuar ose i pandëshkuar. Aspekti i dytë është perceptimi mbi korrupsionin, gjë që në fakt nuk është perceptim, por besim mbi korrupsionin. Në një shoqëri ku besohet se ka një nivel shumë të lartë korrupsioni, edhe nëse ky nivel nuk ekziston, por është i fryrë nga indinjata e të pafuqishmëve dhe nga interesat e luftës së politikës së ditës, prapëseprapë besimi mbi nivelin e lartë të korrupsionit prodhon terrenin për lulëzimin e tij. Në përgjithësi studimi i nivelit të korrupsionit bëhet duke matur nivelin e besimit në ekzistencën e tij. Nivelet e larta të korrupsionit duket se janë të lidhura me nivele të ulëta të besimit publik dhe të pjesëmarrjes qytetare.

Mund të thuhet se besimi ndërpersonal dhe ai institucional janë të dy në nivele të ulëta në Shqipëri. Nga ana tjetër, besimi në institucionet e brendshme duket se është zhvendosur tek institucionet ndërkombëtare. Kjo lidhet shumë me perceptimet e njerëzve për institucionet e brendshme si jofunksionale krahasuar me institucionet ndërkombëtare ashtu edhe me faktin se në vlerësimin e institucioneve të brendshme ndodh shpesh të nisemi nga fakti se kush është personi që i drejton ato.

Nivelet e ulëta të besimit në përgjithësi dhe atij institucional janë në kontrast me nivelet e larta të besimit në familje dhe në rrethin e afërt miqësor. Kjo tregon, se shoqëria shqiptare mbetet tradicionale, shumë e lidhur me familjen dhe lidhjet e gjakut dhe me një nivel të konsiderueshëm

⁸⁹ IDRA, Corruption in Albania: perceptions and experiences, 2009, f.11.

mosbesimi kundrejt institucioneve. Edhe pse nevojiten studime të mëtejshme mund të thuhet se besimi i madh në familje dhe në rrethet shoqërore të ngushta mund të jetë një lloj tipari vendosës i krijuar si pasojë e zhvillimit të vonuar dhe të ngadaltë si dhe mungesës së një performance institucionale të mirë para, gjatë dhe pas komunizmit.

Marrëdhëniet ndërmjet kënaqësisë nga jeta dhe përfshirjes në politikë dhe pjesëmarrjes në aksion politik janë të dyfishta. Niveli i kënaqësisë influencon pjesëmarrjen në politikë sidomos për grupet e kënaqura dhe të pakënaqura. Nga ana tjetër, pjesëmarrja ndikon në nivelin e lumturisë, por në mënyrë që të shpjegohet kjo lidhje nevojiten më shumë të dhëna që të mbulojnë një periudhë më të gjatë kohe. Marrëdhënia ndërmjet kënaqësisë/lumturisë dhe pjesëmarrjes politike nuk duket të jetë shumë e qartë: për këtë nevojiten studime të mëtejshme që të sqarojnë nëse një kënaqësi më e lartë nga jeta shoqërohet edhe me një pjesëmarrje më e madhe në procesin politik dhe e anasjellta. Studimi i kësaj çështjeje kërkon analizën e ndërhyrjes edhe të faktorëve të tjerë.

2.7. Shteti Ligjor në Shqipëri: hartimi, zbatimi i ligjit dhe ndikimi në besimin social

Rishikimi i ligjeve dhe zbatimi i tyre mori një tjetër rrjedhë pas rënies së regjimit komunist, duke sjellë ndryshim në përbërjet dhe funksionimin e parlamentit, si dhe në të njëjtën kohë të të gjithë sistemit të zbatimit të ligjit në vend. Sektori ligjor nuk mund të përbente një përjashtim nga ndryshimet radikale, duke nisur që nga procedurat formale të bërjes së ligjeve, deri në praktikat e zbatimit dhe ndëshkimit të ligjit. Në këtë pjesë të studimit do të realizojmë një analizë të çështjeve kryesore që kanë të bëjnë me zhvillimet e shtetit ligjor në Shqipërinë post-komuniste dhe marrëdhënia e tyre me besimin social. Procesi i rishikimit të kornizës ligjore, nga përgatitja deri në aprovim, si dhe praktikat e zbatimit të ligjit do të trajtohen për të zbuluar implikacionet në zhvillimin e besimit social në Shqipëri gjatë 20 viteve të fundit.

2.7.1. Procedurat nga draftimi te miratimi i ligjeve

Rishikimi i ligjeve aktuale dhe bërja e ligjeve të reja nevojitet të ndjekë një proces institucional strikt si dhe në të njëjtën kohë të përmbushë kërkesa specifike. Së pari ligji duhet 'të sjellë risi dhe ndryshim', pra të funksionojë si instrument ndryshimi duke reflektuar një program të qeverisë, duke synuar një situatë problematike rrjedhojë e zbatimit të keq ose mungesës së ligjit, ose për të mbuluar çështje të caktuara ekonomike apo sociale. Në të njëjtën kohë ligji i ri mund të prekë një domosdoshmëri në procesin e integritimit europian ose një nevojë për të adresuar një problem kushtetues, i identifikuar nga Gjykata Kushtetuese apo institucione të tjera. Në këtë proces është me mjaft rëndësi të vlerësohen disa aspekte kritike si: a garanton ligji i ri respektimin e dispozitave themelore kushtetuese, a respekton kushtet ligjore si përshembull anulimi i të gjitha ligjeve që mund të bien në konflikt me ligjin e ri, a janë ligjet e reja efektive dhe të aplikueshme, a kanë implikacione negative gjatë implementimit etj. Në këtë kuadër, ligji nuk mund quhet thjesht një deklaratë normative që ka si qëllim të edukojë publikun, por një

instrument që duhet të sjellë ndryshim dhe si rrjedhojë duhet analizuar në kontekstin e zbatimit dhe përfshirjes së interesave të qytetarëve dhe aktorëve të interesuar.⁹⁰

Kompetencat për të iniciuar bërjen e një ligji, sipas kushtetutës, mund të realizohet nga organizmat qeveritarë, parlamenti apo populli. Neni 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i njej të drejtën qytetarëve për të ushtruar këtë pushtet direkt apo indirekt. Më specifikisht, Neni 82 i Kushtetutës përcakton të drejtën për të ushtruar një iniciativë ligjore nga 20 000 votues. Më tej 50 000 qytetarë kanë të drejtën për të apeluar një ligj dhe t'i kërkojnë presidentit mbajtjen e një referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë. Ndërkohë Kuvendi Popullor, me propozimin e jo me pak se 1/5 e deputetëve, ose me propozim të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë që një çështje ose një projekt-ligj i rëndësisë së veçantë të kalojë për referendum⁹¹.

Ligjet janë produkt i një procesi kompleks ndërveprimi dhe koordinimi me aktorë të ndryshëm të përfshirë në procesin legjislativ. Si rrjedhojë cilësia e ligjeve varet në mënyrë të veçantë në organizimin e procesit legjislativ dhe bashkëpunimin me aktorë të tjerë. Përgjithësisht në një sistem parlamentar si i joni, është qeveria që mbulon iniciativat legjislative pasi qeveria gëzon mbështetjen politike, bazuar në një program të caktuar që synohet të implementohet. Si pasojë në vendin tonë rishikimi i ligjeve dhe procesi i përgatitjes realizohet kryesisht nga Këshilli i Ministrave dhe ministritë përkatëse. Për të organizuar procesin në tërësi, një plan legjislativ vjetor përpilohet paraprakisht çdo vit, nën kompetencat e Departamentit të Koordinimit pranë Kryeministrit, dhe në bashkëpunim me departamentet përkatëse në ministri dhe organet e pushtetit qëndror. Bazuar në Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”⁹², çdo ministri ndërton një grup pune, kryesisht me staf juristësh, për të planifikuar ndërhyrjet në kornizën legjislative. Ministria propozon aktet ligjore në bazë të kompetencave përkatëse dhe aktivitetëve të agjencive ndërqeveritare dhe institucionet e pushtetit qëndror. Në këtë mënyrë, në pjesën dërrmuese projekt-ligjet përgatiten nga departamentet juridike të ministrive përkatëse, përgjegjëse për rishikimin e kornizës ligjore. Këto organe supozohet të studiojnë dhe analizojnë situatën dhe ndërhyrjet ligjore si dhe në të njëjtën kohë të organizojnë seksione konsultative me të tjerë aktorë dhe grupe interesi në mënyrë që të qartësojnë implikacionet që lindin nga aprovimi i një ligji të ri.

Kutia 7: Hapat në procesin legjislativ

- Hartimi paraprak;
- Konsultime të brendshme mes organizmave qeverisë;
- Konsultime me aktorë të tjerë dhe ekspertë të jashtëm;
- Diskutimi dhe Aprovimi nga Këshilli i Ministrave;
- Shqyrtimi në Komisionet Parlamentare;
- Votimi dhe aprovimi në Parlament
- Dekretimi nga Presidenti i Republikës dhe publikimi në Fletoren Zyrtare;
- Mbikqyrje e procesit të implementimit.

⁹⁰ Sokol Berberi, anëtar i Gjykatë Kushtetuese, Intervistë, Prill 2011

⁹¹ Zaka. E & Cani, Open Parliaments: The Case of Albania; in E Smilov. D (Ed), Open Parliaments, Fredrich Erbert Stiftung, 2010

⁹² Ligji Nr. 9000, Datë 30.01.2009 “Mbi Këshillin e Ministrave”

Kur një autoritet qeveritar përgatitet për një projekt-ligj, duhet paraprakisht të konsultojë të tjera organizma shtetërore mbi tekstin e tij. Si rrjedhojë një projekt-ligj sëbashku me një memorandum spjegues duhet t'i dërgohet ministrive dhe institucioneve publike që kanë interes në këtë ligj. Një raport i dorëzohet edhe Ministrisë së Drejtësisë, çka nevojitet për të dhënë një opinion mbi legalitetin e përmbajtjes dhe formës së këtij drafti. Dështimi për të respektuar këto kërkesa, mund të rezultojë në kthim të draftit nga ana e Sekretarisë së Përgjithshme të Këshillit drejt ministrive përkatëse, për të rishqyrtuar projekt-ligjin bazuar në komentet përkatëse.

Koherenca e sistemit ligjor mund të lehtësohet ndjeshëm duke themeluar prioritetet legjislative afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjata nëpërmjet një planifikimi të përshtatshëm. Këto programe reflektojnë edhe rrugën e aktivitetit legjislativ, pra shamngin situatën kur një ligj i veçantë nuk mund të aplikohet si pasojë e mungesës së akteve normative shoqëruese.

Rregullorja e Këshillit të Ministrave përcakton që një ndër kërkesat që ligji duhet të plotësojë përpara se të aprovohet në parlament është një vlerësim i detajuar i efekteve, kostos dhe përfitimeve që priten. Megjithatë, aktualisht mësohet se këto praktika nuk realizohen në mënyrë strikte nga organizmat kompetentë në vend. Ndërkohë një projekt-ligj me implikacione ekonomike apo financiare duhet që në të njëjtën kohë të dorëzohet për këshillim edhe në Ministrinë e Financave apo në Ministrinë e Ekonomisë për të analizuar kostot financiare që kërkohen. Hapa të tjerë të nëvojshëm në procesin legjislativ janë dorëzimi i draftit në Ministrinë e Integritit Europian, e cila ka për detyrë të vlerësojë dhe analizojë përputhshmërinë e ligjit të ri me *acquis communitaire*.

Konsultimet e brendshme e të jashtme

Përgatitja e legjislacionit nuk duhet që në princip, të kufizohet ekskluzivisht nga organizmat shtetërore. Procesi legjislativ duhet të jetë transparent dhe duhet të lejojë konsultimet nga ekspertë të jashtëm, grupet e interesit, shoqërisë civile dhe publikut në përgjithësi. Konsultimet përbëjnë një mjet të nevojshëm për vlerësimin e efekteve të legjislacionit, duke përcaktuar ndikimin e vërtetë dhe efektet e mundshme anësore⁹³. Në këtë kuadër hapa të rëndësishëm duhet të ndërmerren për të siguruar që interesat e atyre grupeve që do të preken nga ky ligj, dhe në të njëjtën kohë të sigurojë që efektet pozitive të ligjit të jenë të balancuara ndaj efekteve negative.⁹⁴ Megjithatë, siç do të shohim në vazhdim, në rastin e Shqipërisë këto vlerësime ose nuk realizohen si duhet, ose nuk respektojnë procedurat dhe standartet e përcaktuara.

Kutia 8: Marrëveshja Kufitare mes Shqipërisë dhe Greqisë

Marrëveshja e përcaktimit të kufirit detar në detin Jon, ku të dy kufijtë shtetërorë ndahen, u nënshkrua nga autoriteteve shqiptare dhe greke pa kaluar në një proces konsultimi dhe transparence. Në 25 Mars 2010, Komisioni Parlamentar i Çështjeve Ligjore aprovoi pa pjesmarrjen e opozitës kalimin për miratim në parlament të këtij Pakti Detar. Shoqëria civile dhe media kundërshtuan fuqishëm këtë akt, bazuar në argumentat e ekspertëve të pavarur. Në 26 Janar Gjykata Kushtetuese rrëzoi vendimin pasi konstatoi se ishte në kundërshtim me

⁹³ Kellerman, A; Guidelines on Quality of EU Legislation and its Impact on Albania, European Journal of Law Reform , Vol. X, no. 2, pp 183-218

⁹⁴ Kellerman, A; Guidelines on Quality of EU Legislation and its Impact on Albania, European Journal of Law Reform , Vol. X, no. 2, pp 183-218

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke cilësuar parregullsi në procedurat e këtij procesi, ku një element ishte fshehtësia që e karakterizoi. Një çështje me interes të gjerë publik duhej të bëhej transparente për shtetasit. Marrëveshja u anulua dhe aktualisht është në proces rishikimi.

Pasi grupet përkatëse të ministrive përfundojnë procesin e draftimit të ligjit, projekt-ligji shkon për rishikim në ministritë linjë dhe në Departamentin e Kodifikimit (Ministria e Drejtësisë). Departamenti i Kodifikimit përgatit opinione juridike për projekt-ligjet, marrëveshjet ndërkombëtare dhe të tjera projekt-akte normative me qëllim që të sigurojë përshtatjen me ligjet aktuale. Edhe pse kjo procedurë është e formalizuar, ka patur mjaft raste kur projekt-ligjet janë prezantuar pa kaluar këtë procedurë fikse⁹⁵. Në fazën e fundit projekt-ligji dorëzohet në Komisionet Parlamentare me juridiksion në fushën përkatëse që ligji mbulon. Është parlamenti, ai që ka thënien e fundit në këtë proces duke e votuar ligjin, i cili ka nevojë të dekretohet nga Presidenti i Republikës, dhe të nisë zbatimin e tij 2 javë pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Me mjaft rëndësi në këtë proces janë konsultimet e jashtme që mundësojnë shprehjen e mendimeve dhe opinioneve mbi ligjet e propozuara, nga një spektër i gjerë aktorësh. Kjo konsiston një mënyrë efikase ekspozimi politik ndaj çështjeve sociale duke i vënë në axhendën e politikbërësve. Konsultimet janë një instrument i nevojshëm për të realizuar vlerësimin e efekteve të mundshme të legjislacionit tek grupe të ndryshme. Në të njëjtën kohë kjo përbën një mundësi për të konstatuar këndvështrimet e ndryshme të atyre që do të preken në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga ky legjislacion⁹⁶. Megjithatë, korniza ligjore nuk arrin krijon hapësira formale për pjesmarrjen e publikut në vendim-marrjen qeveritare apo parlamentare⁹⁷.

Në vitin 2004 u themelua Komisioni për Reformën Ligjore⁹⁸ i cili kishte si qëllim përmirësimin e kualitetit dhe transparencës së procesit legjislativ. Komisioni, i përbërë nga ekspertë të fushës së ligjit, iu ngarkua detyra për të siguruar koherencën e ligjeve të reja, si me sistemin ligjor ekzistues në vend, edhe me atë europian e ndërkombëtar. Në të njëjtën kohë ky organizëm propozon dhe implementon mekanizmat e nevojshëm për të garantuar një nivel të përshtatshëm të informimit publik dhe pjesmarrjes së aktorëve të interesuar. Megjithatë edhe ky organizëm është kritikuar për mungesë të konsultimeve me grupe të tjera të interesit⁹⁹.

Mund të theksohet se në vitet e fundit Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e hartuesit të ligjit si dhe në të njëjtën kohë për të rritur bashkëpunimin ndër-ministror. Për këtë qëllim është përgatitur edhe një manual mbi teknikat e hartimit të ligjit. Ky manual përfshin si domosdoshmëri konsultimin e grupeve të interesit gjatë përgatitjes së një akti ligjor.¹⁰⁰

⁹⁵ Frasheri, E, Transformation and Social Change: Legal Reform in the Modernization Process, Harvard Law School, 9.5.2008

⁹⁶ EURALIUS & Ministry of Justice & European Council, LawDrafting Manual in Albania – A guide to the legislative process, May 5 2006

⁹⁷ Frasheri, E, Transformation and Social Change: Legal Reform in the Modernization Process, Harvard Law School, 9.5.2008

⁹⁸ Vendim i K.M Nr. 90, date 16.04.2004 “Per themelimin dhe funksionimin e grupit te eksperteve per reformen ligjore”

⁹⁹ European Commission, Albania 2010 Progress Report, Brussels

¹⁰⁰ EURALIUS & Ministry of Justice & European Council, Law Drafting Manual in Albania – A guide to the legislative process, May 5 2006

Hartimi dhe rishikimi i ligjeve: eksperiencia shqiptare**Kutia 9: Akcizat në Shqipëri: Në 9 vjet i rishikuar 12 herë**

Ligji “Për akcizat”, është një tjetër shembull që ilustron situatën problematike të rishikimit të ligjit dhe vështirësitë që shkaktojnë ndryshimet e shpeshta të ligjit gjatë procesit të zbatimit. Që prej vitit 2002 ligji është rishikuar plot 12 herë për mospërputhje dhe probleme gjatë zbatimit.

Për më tepër vërehet se ne raste të caktuara, me iniciativën e Këshillit të Ministrave, ligji është ndryshuar 4 herë brenda një viti, çka flet për procesin kaotik dhe aspak efektiv të rishikimit të ligjit në Shqipëri.

Më së shumti ndryshimet kanë synuar përfshirjen apo përjashtimin e produkteve dhe artikujve të rinj nga lista e produkteve të akcizës. Shpesh ligji ka nxitur protestat e komunitetit të biznesit që nuk ka është bërë pjesë e konsultimeve. Aktualisht ligji mbetet i diskutueshëm pasi versioni i fundit i aprovuar në Mars 2011, është kthyer mbrapsht nga Presidenti i Republikës, si pasojë e shkeljeve të mundshme me Marrëveshje e Stabilizim Asociimit që Shqipëria ka nënshkruar me Bashkimin Europian. Konkretisht neni 33 i kësaj marrëveshjeje thotë se që nga dita e hyrjes në fuqi të marrëveshjes, asnjë detyrim doganor shtesë duhet të vendoset mbi importet dhe eksportet europiane, diçka që pretendohet se nuk respektohet në rishikimin e fundit. Në anënt tjetër edhe organizatat e biznesit e kanë kritikuar këtë vendim që sipas tyre prek interesat dhe të drejtat e tyre. Dhoma e Tregtisë pretendon se ky ligj çënon negtivisht prodhimin e brendshëm. Ligji pritet të rridhë për të 13 herë brenda 9 viteve. Pavarësisht situatës aktuale, ky ligj ka shkaktuar paqartësi dhe vështirësi për të dy palët: institucionet shtetërore si dhe komunitetin e Biznesit.

Ligji Nr. 8967, Date 12.12.2002

Ligji Nr. 9163, Date 18.12.2003

Urdhër i K.M Nr. 3, Date 10.2.2004

Ligji Nr. 9328, Date 06.12.2004

Ligji Nr. 9546, Date 29.5.2006

Ligji Nr. 9598, Date 27.7.2006

Ligji Nr. 9714, Date 16.04.2007

Ligji Nr. 9765, Date 9.7.2007

Ligji Nr. 9854, date 26.12.2007

Ligji Nr. 10067, date 2.2.2009

Urdhëri i K.M Nr. 31, Datë 26.5.2009

Ligji Nr. 10147, date 28.9.2009

Ligji Nr. 10404, date 24.03.2011

Pas rënies së komunizmit, procesi i demokratizimit u zhvillua paralelisht me rishikimin e kornizës ligjore, si një domosdoshmëri për të ngritur themelin e demokracisë: zbatimin e shtetit ligjor. Si rrjedhojë, ligji ishte në epiqendër të tranzicionit, jo si një instrument ndryshimi, por si një qëllim për transformim, i veshur me karakteristika formale dhe shpesh duke mos reflektuar kontekstin e brendshëm. Edhe pse Shqipëria është një Republikë Parlamentare, qeveria ka dominuar jetën politike dhe aktivitetin e institucioneve shtetërore, përfshirë edhe procesin e hartimit të ligjit në parlament. Është Këshilli i Ministrave propozon ligjet dhe rrjedhimisht është

edhe përgjegjës për implementimin e tyre. Rreth 94%¹⁰¹ deri në 99%¹⁰² e ligjeve janë projektuar nga Këshilli i Ministrave gjatë 20 viteve të fundit. Pavarësisht faktit se anëtarët e parlamentit gëzojnë kompetenca për të iniciuar një ligj të ri, shumë pak ligje janë propozuar nga deputetët duke i dhënë ekzekutivit gati monopolin e hartimit të legjislationit. Madje edhe në ditët e sotme, numri i ligjeve të hartuara nga ministritë konsiderohet padrejtësisht si një matës për efektivitetin e aktivitetit të këtij institucioni, dhe si shenjë produktiviteti dhe suksesi¹⁰³. Në anën tjetër e drejta për të ushtruar një iniciativë legjislative nga 20 000 votues është ekzekutuar vetëm një herë në vitin 2006 për të mundësuar kornizën ligjore mbi dhunën në familje. Iniciativa për të thirrur një referendum mbi një çështje që prek interesat e të gjithë shoqërisë apo të kërkojë anullimin e një ligji në fuqi nga presidenti, nuk është aplikuar asnjëherë gjatë 20 viteve të fundit në Shqipëri.

Pavarësisht zhvillimeve të kapaciteteve administrative dhe procedurave institucionale që vërehen gjatë 20 viteve të fundit, hartimi dhe aprovimi i legjislationit mund të konsiderohet problematik, në veçanti për sa i përket proceseve të konsultimit në fazën përgatitore dhe diskutimit në parlament. Procesi shpesh mekanik i adoptimit të ligjeve ka shkaktuar një numër të madh të ligjeve të aprovuara brenda një kohe të shkurtër.

Llogaritet që nga viti 1990 deri në vitin 2005, më tepër se 3000 ligje të reja dhe mijëra akte nën-ligjore janë adoptuar, në mënyrë për të krijuar një kornizë ligjore të plotë e nevojshme për funksionimin e sistemit të ri demokratik dhe shoqërisë. Situata ka evoluar në një rreth vicioz që përjetëson një nevojë për të adoptuar gjithmonë e më shpesh legjislation të ri, që praktikisht nuk mund të përvetësohet nga administrata dhe aq më tepër nga qytetarët. Ndryshimi i shpeshtë në strukturën legjislative, moskohërenca që karakterizon sistemin ligjor dhe ekzistenca e ligjeve që konfliktohen mund të sjellin vështirësi në aplikimin e ligjeve dhe forcimin e shtetit ligjor¹⁰⁴. Si pasojë e implikimeve financiare dhe kapaciteteve institucionale, prioriteti i administratës publike ka qenë i lidhur ngushtë me implementimin dhe zbatimin e ligjit, duke lënë praktikisht në hije kontributin në hartimin e ligjeve të reja çka reflekton direkt në cilësinë e ligjit¹⁰⁵.

Vlen të theksohet se gjatë 20 viteve të fundit në procesin e hartimit dhe implementimit ka luajtur role kryesor përafrimi i legjislationit shqiptar me atë europian ose siç njihet ndryshe '*acquis communautaire*'. Në kontekstin e integritimit europian, termat 'përaftrim' dhe 'harmonizim' i referohen procesit të adaptimit të sistemeve ligjore të vendit me *acquis communautaire* dhe siç përmendëm më parë, përfshin jo vetëm adoptimin por edhe implementimin e duhur të tyre. "Transplantimi ligjor" siç përkthuhet nga studiues të ndryshëm, është fenomeni i huazimit të normave legale nga vende të tjera të zhvilluara. Ky proces përfshin transferimin e ligjeve të rëndësishme e njëkohësisht të nevojshme; por që kanë një risk të lartë për të marxhinalizuar institucionet publike dhe qytetarët në tërësi. Si rrjedhojë besohet se ligjet e hartuara nga nevojat e brendshme janë më të suksesshme në aplikim se sa ato që përkthehen dhe përshtaten nga

¹⁰¹ Zaka, E & Cani, Open Parliaments: The Case of Albania; in E Smilov, D (Ed), Open Parliaments, Fredrich Erbert Stiftung, 2010

¹⁰² Frasher, E, Transformation and Social Change: Legal Reform in the Modernization Process, Harvard Law School, 9.5.2008

¹⁰³ Po aty

¹⁰⁴ Konda, Gj, Reforma Institucionale ne Shqipëri, IFC

¹⁰⁵ Kellerman, A; Guidelines on Quality of EU Legislation and its Impact on Albania, European Journal of Law Reform, Vol. X, no. 2, pp 183-218

vende të tjera të marra si model. Historia ka treguar se ligjet e transplantuara nëse nuk janë të adoptuara në mënyrë të përshtatshme, mund të bien në konflikt me normat ekzistuese kulturore, sociale e politike¹⁰⁶. Në këtë kuadër ekzistojnë mjaft debate e diskutime mbi implikacionet morale dhe praktike të 'transplantimit të ligjeve' të cilat konsiderohen si shtojcë në imponimin e shtetit ligjor. Në shtetet perëndimore që Shqipëria ka marrë si model në 20 vitet e fundit, zhvillimet legjislative kanë ndodhur paralelisht me zhvillimet politike, sociale dhe ekonomike. Ndërkohë në vendin tonë, shteti ligjor është rezultat i ndryshimit të sistemit dhe shpesh si një qëllim për t'u bërë pjesë e strukturave Euro-Atlantike. Si rrjedhojë ligjet e reja jo domosdoshmërisht reflektojnë situatën në praktikë, por kanë si qëllim të kënaqin kërkesat e ndërkombëtarëve dhe rregullojnë fasadën e shtetit ligjor në Shqipëri. Kjo situatë ka shkaktuar në vite një hendek mes autoritetit të ligjit dhe kontekstit dhe kushtet e brendshme që ai aplikohet.

Në fakt, përafrimi i legjislationit me atë europian si një obligim apo kushtëzim për mbështetjen ndërkombëtare, është i lidhur ngushtë edhe me marrëveshjet që Shqipëria ka nënshkruar me Bashkimin Europian siç mund të përmendet Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Rrjedhojë e presionit ndërkombëtar, procesi i *acquis communautaire* është imponuar nga institucionet europiane, dhe në interes të përshtetimit të integritimit europian, parlamenti në këto 20 vite nuk është kursyer në aprovimin e mjaft ligjeve të reja pa patur kohën dhe mundësitë në analizimin dhe përgatitjen e tyre. Si rrjedhojë, gjatë viteve të tranzicionit në Shqipëri qindra ligje janë propozuar nga komuniteti ndërkombëtar në kuadër të *acquis communautaire*. Si pasojë e nxitimit në adoptimin e ligjeve të tillë, shumë prej tyre u përkthyen rëndom, pa arritur një proces përshtatjeje dhe studimi të terrenit të aplikimit. Shumë ligje kanë kaluar në parlament pa analizën e nevojshme dhe vlerësimin e efektivitetit dhe efektit që do të kenë. Në këtë kuadër procesi legjislativ në Shqipëri gjatë 20 viteve të fundit mund të cilësohet kaotik, i nxituar duke i dhënë pak hapësirë aktorëve të interesuar për t'u përfshirë në procesin e hartimit¹⁰⁷.

Kjo situatë mund të ngrejë shqetësime mbi transparencën, analizimin dhe konsultimet në procesin e hartimit të ligjit, çka reflektohet në legjitimitetin e ligjeve të adoptuara. Duke lejuar pjesmarrjen e nevojshme në procesin e draftimit, administrata publike mund të shmangë kritika të shumta ndaj ligjit pasi ai të jetë aprovuar. Siç përmendëm, pushteti ekzekutiv ka gëzuar edhe privilegjin e hartimit të ligjeve të reja. Megjithatë grupet horizontale të punës sipas ministrive përkatëse jo gjithmonë kanë qenë të afta për të finalizuar ligje të mira si pasojë e kufizimit të procesit në pak aktorë¹⁰⁸. Rrjedhimisht mund të argumentohet se procesi ligj-bërës mund të perceptohet, të paktën formalisht, si i strukturuar institucionalisht, por problemi në realitet qëndron në kapacitetet institucionale, burimet njerëzore dhe trajnimin e personelit që merret me ligjet e reja. Këto mangësi reflektohen në mënyrë direkte në cilësinë e ligjeve dhe më pas në implementimin e tyre të vështirë.

Duke folur në aspektin juridik, procesi i hartimit nxit, por nuk detyron institucionet publike të qeverisjes vendore dhe komisionet parlamentare të konsultohen me aktorë e grupe të interesit,

¹⁰⁶ Zyberi. Gentian, Shteti Ligjor në Shqipëri: Midis aspiratave dhe realitetit, RSHSL Annual Conference 2008, www.ajls.org/doc/Abstrakt_GZyberi-Shteti-Ligjor-AJLS-2008.pdf

¹⁰⁷ OSCE, Legal Sector Report for Albania, 2004

¹⁰⁸ European Commission, Albania 2006 Progress Report, Brussels, 08.11.2006

edhe pse procedurat përpiqen të garantojnë njëfarë transparence në procesin e finalizimit. Si pasojë nuk ka asnjë ligj që t'u japë mundësi palëve për t'u bërë pjesë e procesit të hartimit, dhe kjo vlen për çdo ministri. Krahasuar me rregullat që mundësojnë transparencën në parlament, hartimi i ligjeve në nivelin qeveritar është pothuajse i mbyllur¹⁰⁹.

Pavarësisht mosekzistencës të kufizimeve ligjore për pjesmarrjen e aktorëve të jashtëm (shoqëria civile, ekspertë të pavarur, grupe të interesit etj) në hartimin e ligjit, shpesh pengesat burokratike bëhen shkas për të vonuar e për mos të lejuar pjesmarrjen e jashtme në konsultimet e përgatitjes së ligjeve të reja. Si rrjedhojë e mungesës së procedurave strikte detyruese për të përfshirë shoqërinë civile, marrëdhëniet mes organizmave qeveritarë dhe organizmave civil (OJQ-të, grupe interesi etj) varen më së shumti nga vullneti i titullarit të institucionit se sa nga një praktikë të konsoliduar. Duke ia deleguar kompetencat e hartimit të ligjit, vullnetit e angazhimit të përfaqësuesve shtetërorë, dhe duke lejuar një proces të mbyllur e të rezervuar vetëm për ministri specifike, krijohet një situatë ku zyrtarët publik krijojnë dhe imponojnë ligje për njerëzit të cilët ndihen të përjashtuar nga çdo pretendim. Njerëzve u mbetet thjesht të binden, çka krijon një hendek mes veprimtarisë së institucioneve publike dhe shoqërisë. Në këtë kuadër konsultimet janë esenciale për legjitimitetin e pushtetit, cilësinë e ligjit dhe rrjedhimisht esenciale edhe për zbatimin e tij.

Në tërësi të procesit të hartimit të ligjit, mund të veçohet procedura e argumentimit dhe justifikimit që realizohet nga organizmat përgjegjës në procesin e hartimit të ligjit. Kjo përpilohet në formën e një raporti nga Këshilli i Ministrave, por fatkeqësisht nuk është në dispozicion të publikut të gjerë dhe as nuk publikohet në Fletoren Zyrtare sëbashku me ligjin e amenduar. Ky raport depozitohet në Sekretarinë e Parlamentit, dhe nuk ka procedura të qarta se si mund të bëhet i disponueshëm për publikun si pjesë dokumenteve zyrtare që me ligj duhet të jenë të hapura për publikun¹¹⁰. Si pasojë publiku mund të quhet i përjashtuar, jo vetëm nga konsultimet, por edhe nga informacioni mbi implikacionet e ligjeve, duke iu servirur vendimi final, pa patur mundësi për ta kundërshtuar.

Kutia 10: Hartimi i ligjit në Parlament – Problematika Kryesore

- Shkalla e ulët e përgjigjeve të kërkesave zyrtare të adresuara.
- Vështirësi në marrjen e “Statutit të Monitoruesit” për OJF-të në mbledhjet e komisioneve
- Fakti se shumë aktivitete ndodhin paralelisht, është e vështirë për median t'i monitorojë
- Mungesa e hapjes së informacionit ndaj publikut mbi aktivitetet e parlamentit (raporte, buletine etj);
- Mungesa e informacionit mbi tema specifike (psh raportet e institucioneve ndërkombëtare nuk publikohen;
- Vështirësi në ndjekjen e aktiviteteve të komisioneve parlamentare.

Mendohet se ekziston një perceptim mbizotërues i gabuar mes zyrtarëve të qeverisë dhe parlamentit, se pjesmarrja e publikut mund ta vështirësojë procesin më tepër se sa ta përmirësojë atë. Për më tepër administrata publike ka tendencën të tregojë interes për

¹⁰⁹ Zaka. E & Cani, Open Parliaments: The Case of Albania; in E Smilov. D (Ed), Open Parliaments, Fredrich Erbert Stiftung, 2010

¹¹⁰ Ligj Nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit nga dokumentat zyrtare”

përfshirjen e publikut në procesin e hartimit të ligjit dhe politikave në përgjithësi vetëm në rastet kur pret që publiku të pranojë vendimet e synuara¹¹¹. Pavarësisht faktit se ka patur mjaft raste kur Komisionet Parlamentare kanë ftuar grupet e interesit për të marrë pjesë në diskutime, kjo nuk ka arritur të zhvillohet në një praktikë rutinë. Në terma të përgjithshëm, në Shqipëri procesit të hartimit dhe rishikimi të ligjit i mungon një kulturë dhe sjellje normative për të qenë të hapur ndaj konsultimeve dhe praktikave transparente, çka shkakton një situatë ku shumica e ligjeve kalojnë pa u vënë re.

Së pari, pasi një ligj dekretohet, të gjithë ligjet ekzistuese duhet të kontrollohen për përputhshmëri me ligjet ekzistuese. Por kjo kërkesë ka rezultuar e vështirë për t'u plotësuar duke konsideruar numrin e madh të ligjeve të adoptuar, e në një kohë të shkurtër, çka sjell një situatë të aprovimit të mjaft ligjeve që konfiktohen dhe mungesë e qartësisë gjatë implementimit¹¹². Duke iu referuar intervistave të realizuara me përfaqësues zyrtar të institucioneve publike bëhet me dije se pas aprovimit të ligjit në parlament dhe dekretimit nga ana e Presidentit, ligjet monitorohen dhe kontrollohen çdo 1-3 vjet mbi mënyrën e zbatimit dhe implementimit. Nëse konstatohen probleme, kërkohet të bëhet një analizë e plotë për të propozuar amendamentet e nevojshme. Një çështje e veçantë gjatë procesit të hartimit të ligjit, është përcaktimi se në çfarë mase dhe si ligjet e propozuara do të ndryshojnë skemën ekzistuese legjislative, cilat do të jenë pasojat për grupe të ndryshme të interesit, dhe cila do të jetë kostoja si për publikun dhe sektorin privat. Ndërkohë hapa konkret duhet të ndërmerren për të siguruar se interesat që do të preken nga ligji i propozuar dhe efektet e tij pozitive, të jenë të balancuara ndaj efekteve të saj negative¹¹³. Sidoqoftë në rastin e Shqipërisë, të tilla vlerësime konstatohen se nuk janë cilësore ose nuk respektojnë të gjitha standartet e përcaktuara në legjislacion. Përshembull vlerësimin nëse ligji i ka përmbushur objektivat e tij realizohet pak ose aspak nga strukturat përkatëse¹¹⁴.

Situata problematike reflektohet në numrin e madh të ligjeve që janë konsideruar në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Gjatë 10 viteve të fundit një numër i madh ligjesh janë marrë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese. Ndonëse jo të gjitha janë cilësuar në shkëlqje të kushtetutës, numri i lartë i rasteve të marra në shqyrtim nga ky institucion mund të quhet një indikator që tregon për vlerësimin e dobët në lidhje me respektimin e kushtetutës, që i janë bërë këtyre ligjeve nga institucionet përgjegjëse në fazën përgatitore. Në këtë kuadër Ministra e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave, por edhe Parlamenti, duhet të luajnë një rol më aktiv.¹¹⁵ Ndërkohë të tjera ligje, edhe pse nuk janë gjykuar në kundërshtim me kushtetutën, kanë rezultuar praktikisht të paaplikueshëm duke krijuar vështirësi në zbatimin e ligjit dhe forcimin e shtetit ligjor.

¹¹¹ Frasher, E, Transformation and Social Change: Legal Reform in the Modernization Process, Harvard Law School, 9.5.2008


¹¹² Konda. Gj, Reforma Institucionale ne Shqiperi, IFC

¹¹³ Kellerman, A; Guidelines on Quality of EU Legislation and its Impact on Albania, European Journal of Law Reform, Vol. X, no. 2, pp 183-218

¹¹⁴ Sokol Berberi, anëtar i Gjykatë Kushtetuese, Intervistë, Prill 2011

¹¹⁵ Po aty

Figura 30: Vendimet e Gjykatës Kushtetuese mbi veprimtarinë e Parlamentit dhe Këshillit të Ministrave



Burimi: Gjykata Kushtetuese

Aktiviteti i Parlamentit

Në veçanti gjatë fillimit të viteve 90, përqëndrimi i aktivitetit të parlamentit në hartimin dhe aprovimin e ligjeve të reja, la mënjanë të tjera detyra dhe kompetenca, si mbikqyrja e organizmave qeverisëse përse i përket implementimi të ligjeve. Si rrjedhojë parlamenti nuk arriti të themelojë një strukturë të konsoliduar komisionesh për të ushtruar kompetenca mbikqyrëse ndaj ekzekutivit në mënyrë që të sigurojë përgjegjshmërinë e tij¹¹⁶. Aktualisht në Kuvendin Popullor funksionon një zyrë ligjore me një staf të kufizuar (2-3 juristë), e cila merret me aspektet teknike të ligjeve të reja. Megjithatë për deputetët e parlamentit, nuk ka një personel legal për konsultime dhe këshillim gjatë procesit të hartimit dhe rishikimit të legjislacionit. Në rastet kur deputetët iniciojnë një projekt-ligj, teorikisht ata kanë mundësi për këshillim dhe ekspertizë nga Sekretaria e Parlamentit dhe zyra ligjore. Por në praktikë ky këshillim është i limituar, pasi stafi është i kufizuar, si në numër edhe në kapacitete, pasi juristët e saj nuk janë të specializuar për fusha specifike të ligjit. Në këtë kuadër deputetët kanë të drejtë të marrin informacion dhe konsultohen nga ekspertë të jashtëm që mund të përfshihen në procesin e hartimit të ligjit. Por, realisht as kjo mundësi nuk funksionon pasi koha që u jepet deputetëve dhe anëtarëve të komisioneve ligjore për të shqyrtuar projekt-ligjet është e pakët. Shpesh veprimtaria e komisioneve parlamentare kthehet në një rutinë, ku rrallë dikush lexon tekstin e aktit legjislativ të propozuar. Kjo vetëm nëse ligji i propozuar nuk ka natyrë politike. Në rast të kundërt ligjet adoptohen unanimitisht pa shumë debate¹¹⁷.

Një ndër çështjet e ngritura nga deputetët shqiptarë gjatë intervistave të kryera është mungesa e kohës së mjaftueshme akorduar atyre për të analizuar ligjet. Sipas tyre ka ligje që mbeten pezull

¹¹⁶ Biberaj, E, Shqipëria në Tranzicion: Rruga e veshit drejt Demokracisë, Westview Press (2001)

¹¹⁷ Frasher, E, Transformation and Social Change: Legal Reform in the Modernization Process, Harvard Law School, 9.5.2008

më shumë se dy vjet, si pasojë e mosmarrëveshjeve politike, ndërkohë identifikohen ligje me mjaft rëndësi që aprovohen brenda pak ditësh¹¹⁸. Proceset e hartimit të ligjit në parlament është gjithashtu i limituar për aktorët e interesuar. Në pjesën dërrmuese të rasteve, aktorët e interesuar nuk ftohen në mbledhjet e komisioneve parlamentare. Në një gjykim të përgjithshëm mund të dilet në konkluzionin se mungesa e konsensusit politik dhe traditës demokratike, sjellin shmangien e konsultimeve me palë të tjera. Shpesh edhe kur kjo ndodh, grupet e ftuara ndajnë të njëjtat pikëpamje me ato të qeverisë. Si rrjedhojë procesi mbyllet shpejt e pa diskutime thelbësore.

Kutia 11: Rasti i Kushtetutës

Pas rënies së regjimit komunist, Dispozitat Kryesore Kushtetues të aprovuara në vitin 1991, që lejuan ndryshimet demokratike në vend, u ndoqën nga përpjekjet për të themeluar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Një Komision Kushtetues punoi në vitin 1993-1994 për të zhvilluar dhe propozuar një draft të kushtetutës së re. Por partitë opozitare nuk u përfshinë në proces. Procesi i hartimit iu besua një rrethi të ngushtë organesh qeverisëse, ku duhet thënë se mungoi transparenca dhe konsultimi i grupeve të ndryshme të interesit dhe ekspertëve të pavarur. Partia Socialiste e Shqipërisë e sfidoi referendumin duke e çuar çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Por Gjykatat nuk e pranoi çështjen, para se referendumi të ndodhte. Megjithatë votuesit vendosën që mos të pranojë kushtetutën e re që hasi në kritika të forta të partive opozitare që u përjashtuan nga procesi i hartimit.

Një tjetër përpjekje për themelimin e dokumentit të Kushtetutës u bë vitin 1997 kur Parlamenti aprovoi strukturën që do të merrte përgjegjësinë e hartimit të projekt-kushtetutës. Parlamenti vendosi funksionimin e një komisioni parlamentar prej 21 anëtarësh për të drejtuar procesin. Procesi i hartimit përfshiu aktorët të ndryshëm politik, konsultime me ekspertë ndërkombëtarë, si dhe një këshillim nga Komisioni i Venecias. Megjithatë opozita përsëri refuzoi të marrë pjesë në proces duke e vënë në dyshim legjitimitetin e dokumentit bazë të sistemit ligjor. Pavarësisht bojkotit nga ana e opozitës dhe kritikizmit të saj, referendumi mbështeti kushtetutën e re, megjithëse edhe kësaj here pa votat dhe kontributin e partive opozitare.

Kjo tendencë ka ndikuar në mungesën e transparencës, dhe gjithashtu reflektohet në cilësinë e legjislativitetit të miratuar¹¹⁹. Pra, transparenca e procesit të hartimit të ligjit paraqitet e ulët duke ndikuar negativisht në sistemin në tërësi. Megjithatë vlen të theksohet se gjatë viteve të fundit transparenca në Parlament është rritur si pasojë e publikimit në faqen zyrtare në internet të Parlamentit, i transkripteve të mbledhjeve të Komisioneve Parlamentare. Por pavarësisht përcaktimit të procedurave dhe rregulloreve për të mundësuar një konsultim më të gjerë dhe norma transparenca të konsoliduara, raporte të ndryshme të shoqërisë civile dhe organizmave ndërkombëtarë tregojnë raste të vështirësive për t'u pajisur me lejen e nevojshme për të ndjekur mbledhjet e komisioneve parlamentare, dhe aq më pak për të marrë pjesë në diskutimet në nivel qeverie.

Si rezultat, procesi i hartimit të ligjit në parlament vuan pengesa të rëndësishme që kanë lidhje me ekspertizën, konsultimet dhe transparençën. Në përgjithësi ligjet dhe vendimet kalojnë pa diskutime dhe debate konstruktive, e pa marrë parasysh pasojat sociale e financiare, ose çështje të pashmangshme që kanë të bëjnë me implementimin e këtij ligji.

Çështje të tjera që kanë një ndikim negativ në procesin e përgatitjes dhe rishikimit të kornizës

¹¹⁸ Intervista me anëtarë të parlamentit, Tiranë, prill 2011

¹¹⁹ OSCE, Legal Sector Report for Albania, 2004

ligjore janë klima politike mjaft e ngarkuar dhe konfliktuale, si dhe mungesa e bashkëpunimit midis dy fraksioneve kryesore politike në vend. Duket se akti i votimit të projektligjeve vetëm nga maxhoranca, duke shpërfillur kërkesat e opozitës gjatë 20 viteve të fundit, lidhet drejtëpërdrejtë me dështimin e tyre në të ardhmen. Në këtë kontekst pretendohet se adoptimi i legjislacionit, pa respektuar normat e konsultimit dhe transparencës, i jep mundësi autoriteteve publike, që ose të mënjanojnë ndarjen e pushtetit, ose të keqpërdorin kompetencat e tyre¹²⁰. Kjo është më së shumti pasojë e axhendave politike konfliktuale në lidhje me procesin e rishikimit të legjislacionit, ku të dyja palët argumentojnë në favor të një pozicioni të palëkundur, që bazohet në axhendën e tyre politike, duke mos lënë hapësirë për diskutime dhe vendime konsensuale. Si rrjedhojë, diskutimet në parlament shpesh bien më tepër në nivelin e akuzave të ndërsjellta të bazuara në kontekstin politik, se sa diskutime konstruktive mbi thelbin e ligjit të propozuar siç janë efikasiteti, benefitet apo efektet e tij. Në vitet e fundit vërehet se praktika e adoptimit të ligjeve të reja thjesht me votat e njëres forcë politike që mban shumicën në parlament, është kthyer në procedurë normale. Sjelljet konfliktuale të partive politike gjatë tranzicionit, një fenomen që zgjat edhe sot pas 20 viteve, mund të konsiderohet si një ndër burimet kryesore të mosbesimit të popullsisë ndaj klasës politike dhe institucioneve qeverisëse.

2.7.2.Zbatimi dhe ndëshkimi ligjor

Respektimi dhe zbatimi i normave legale dhe rendit publik, përbëjnë një sfidë për zhvillimin e shoqërisë, institucioneve dhe strukturave shtetërore gjatë tranzicionit të zgjatur në Shqipëri. Në njërin anë një shtet demokratik nënkupton një sistem legal të përshtatshëm, i cili garanton respektimin e normave dhe të drejtave themelore që përcaktojnë funksionimin e organizimit social dhe mbështetësin implementimin e rregullave në shoqëri¹²¹. Në anën tjetër shteti ligjor përfshin shkallën e besimit të aktorëve për të kuptuar se sa i binden normave dhe ligjeve në fuqi, në veçanti me zbatimin e kontratave, të drejtat e pronës, marrëdhëniet me policinë dhe natyrisht institucionet e drejtësisë¹²². Megjithatë në rastin tonë mund të evidentohet një hendek i cili ndan procesin e hartimit të ligjit dhe implementimin e tij konkret. Mospërputhja mes këtyre dy proceseve mund të ndikojë thellë në legjitimitetin e shtetit dhe institucioneve të tij e rrjedhimisht edhe në besimin ndaj institucioneve.

Në këtë kontekst mund të vlerësohet se numri i madh i ligjeve të adoptuara në 15-20 vitet e fundit, ka qenë i shkëputur nga zbatimi në terren, duke krijuar pengesa në implementim. Raportet ndërkombëtare zbulojnë se qeveria dhe Këshilli i Ministrave kanë propozuar dhe amenduar ligje, pa arritur të sigurojnë kushtet e nevojshme për implementimin e tyre si fondin financiar dhe burimet që kërkohen¹²³. Numri i lartë i ligjeve të adoptuara çdo vit ka kontribuar në mangësitë e implementimit të ligjit. Aktet normative do të kishin më tepër mundësi për t'u

¹²⁰ FRIDE, Democracy Monitoring Report: Albania, April 2010

¹²¹ Osmo Lipponen, Analiza e Sistemit Ligjor ne Shqiperi, OSBE: 2004

¹²² Radin, Dagmar, Too Ill to Find the Cure?: Corruption, Institutions, and Health Care Sector Performance in the New Democracies of Central and Eastern Europe, East European Politics and Societies 2009 23: 105, <http://eep.sagepub.com/content/23/1/105>

¹²³ Worl Bank, "Poverty in Albania", 2003

implementuar nëse procesi i hartimit do të lejonte vendim-marrësit dhe palët e interesuara të shkëmbenin mendime dhe të zbulonin problematikën. Dhe një përjasje e tillë sigurisht që do të kishte përfitime të drejtpërdrejta në veshjen e sistemit me më tepër legjitimitet¹²⁴.

Kutia 12: Ligji kundër duhanit

Në vitin 2006 kur Këshilli i Ministrave propozoi ligjin “Mbi mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, mjaft konfuzion dhe diskutime nisën në Shqipëri mbi relevancën e këtij ligji. Por si evoloi implementimi i këtij ligji në vendin tonë? Si u zbatua dhe sa sukses pati?

Kujtoj kur një i huaj erdhi në Shqipëri, pa fshehur kuriozitetin, pyeti pse nëpër baret e qytetit tavllat e duhanit ishin zëvendësuar me pjata filxhani. Dikush duke buzëqeshur iu përgjigj: “... sepse ligji i ndalon tavllat e duhanit në ambiente publike” (jo pirjen e duhanit).

Ky ligj u prezantua në Shqipëri pak vite më vonë se sa në Europë, mes debateve dhe pakënaqësive. Fillimisht njerëzit u çuditën nga idea që nuk do të mund të tymosnin më në asnjë hapësirë publike. Si kudo tjetër ligji u kritikua nga popullsia në një kohë që zbatimi u vu në pikëpyetje që në fazën fillestare të implementimit, duke marrë në konsideratë edhe zakonet e përhapur të pirjes së duhanit tek shqiptarët. Më tepër se një iniciativë e brendshme e Këshillit të Ministrave, ligji i ri u prezantua si një nismë e komunitetit ndërkombëtar në kuadër të *acquis communautaire*. Bashkimi Europian mbështeti procesin e hartimit, që mund të quhet një klon i shqipëruar i ligjeve europiane kundër pirjes së duhanit në ambientet publike. Pavarësisht se ligji u konsiderua i mirë, duke u bazuar në Konventën e Kombeve të Bashkura për Kontrollin e Duhanit, u vërtetua se ishte i vështirë për t’u zbatuar dhe jorealiste në implementim.

Ligji u kritikua për mungesë relevance dhe aplikim i pamundur për kontekstin shqiptar. E megjithatë, ligji u aprovua nga Parlamenti dhe dekretua nga Presidenti i Republikës, pa ndërmarrë analizimin e duhur të efekteve që ky ligj do të ketë tek popullata, instrumentet për zbatimin e tij si dhe objektivat për të ardhmen. Vlen për t’u theksuar se ligjet e propozuara nga komuniteti ndërkombëtar në kuadër të *acquis communautaire*, rrallë janë refuzuar nga autoritetet shqiptare. Si pasojë ligji hyri në fuqi pa përpjekjet dhe masat nevojshme që nevojiteshin për ta zbatuar, duke rezultuar i dështuar jo vetëm përse i përket këtij rasti specifik, por për të gjithë sistemin, duke treguar mungesë autoriteti dhe paaftësie në zbatim të shtetit ligjor.

Çuditërisht të parët që nuk iu bindën ligjit të ri, ishin zyrtarët e administratës publike, të cilët vazhduan të tymosnin në ambientet e institucioneve, pavarësisht ligjit dhe ndëshkimit të përcaktuar për shkelësit e ligjit. Media raportoi se as në Ministrinë e Shëndetësisë, organizmi i caktuar për kontrollin dhe monitorimin e implementimit të këtij ligji, ligji nuk respektohej. Nëse vet zyrtarët shkelin ligjin, atëhere qytetarët e thjeshtë edhe më tepër. Pra adoptimi i këtij ligji të ri inovator, të transplantuar nga jashtë, solli efekte të kundërta: jo vetëm që nuk ndaloi duhanin në ambientet publike, por i dha një mesazh të gabuar qytetarëve mbi fleksibilitetin e mekanizmave të zbatimit të ligjit, çka dobëson autoritetin shtetëror dhe rrejdhimisht edhe besimin tek institucionet.

Duke marrë në konsideratë faktin se duhani shkakton pasoja të rënda në shëndetin e njerëzve dhe në veçanti tek ‘pirësit pasiv’, ligji synonte të rregullonte dhe disiplinonte këtë çështje kaq delikate. Megjithatë, për këtë qëllim nevojitej një proces serioz zbatimi, që asnjëherë nuk u realizua. Kontrollat e bëra nga autoritetet përgjegjëse në institucionet publike nuk rezultuan të suksesshme. Gjohat që ju vendosën subjekteve që shkelën ligjin, asnjëherë nuk arritën të mblidheshin, duke treguar mungesë të

¹²⁴ Frasher. E, Transformation and Social Change: Legal Reform in the Modernization Process, Harvard Law School, 9.5.2008

forcës së zbatimit të ligjit dhe respektin e shtetit ligjor. Në këtë kontekst mund të dilet në përfundimin se aktualisht ligji tërësisht ka dështuar. Kjo si pasojë e dy faktorëve kryesorë. Së pari, sepse ligji u adoptua pa një proces konsultimi dhe vlerësimi të kontekstit ku do të zbatohet dhe së dyti, sepse strukturat e zbatimit të ligjit në qeverisje nuk funksionuan për të realizuar aplikimin e ligjit në praktikë. Duke parë situatën problematike në realitet, në vitin 2008 Ministria e Shëndetësisë propozoi disa amendamente, të cilat nuk u reflektuan në ligj. Më pas ishte Ministria e Financave e cila propozoi disa ndryshime, që synonin të përmirësonin implementimin dhe zbatimin e ligjit, në veçanti përsa i përket mbledhjes së gjobave. E megjithatë zbatimi i ligjit ka pushuar së zbatuari nga organizmat qeveritarë përgjegjës, në një kohë që ligji vazhdon ende të jetë në fuqi. Që prej 5 viteve nga adoptimi i tij, sot askush (qofshin zyrtarë apo qytetarë) nuk do të dëgjojë se ligji ekziston. Një kompromis i heshtur është vendosur; Njerëzit mund të pijnë duhan kudo që ata kanë dëshirë, ndërkohë komuniteti ndërkombëtar është i kënaqur për ekzistencën e këtij ligji në letër. Por, si një normë legale, ligji kundër duhanit duhet të gëzojë të njëjtin autoritet dhe zbatim si çdo ligj tjetër në vend.

Siç u përmend, gjatë tranzicionit post-komunist, një punë e madhe është bërë përsa i përket rishikimit të kornizës ligjore dhe hartimit të ligjeve të reja në përputhje me *acquis communitaire*. Megjithatë implementimi i ligjeve nuk ka ndjekur të njëjtën rrugë. Ekzistenca e një sistemi ligjor të pasur me norma legale, jo domosdoshmërisht mund të përkthehet në operimin e tyre optimal në jetën e përditshme. Studime dhe raporte minitorimi kombëtare dhe ndërkombëtare vlerësojnë se standartet legale, sidomos në letër, kanë pësuar një zhvillim të madh gjatë viteve, megjithatë mjaft kritika i janë dedikuar aftësisë për të ndërtuar një sistem të themeluar në zbatimin e shtetit ligjor¹²⁵. Asnjë veprim jashtë hapësirës që lejon shteti ligjor nuk duhet të tolerohet dhe aq më keq të kalojë si një rutinë normale apo çështje burokratike. Këto mund të çënojnë ndjeshëm besueshmërinë tek institucionet publike. Por ajo që është më e rëndësishmja e njëkohësisht edhe më e rrezikshmja është fakti se duke krijuar precedentë të vazhdueshëm, një përhapje e mentalitetit negativ ndaj institucioneve do të mbizotërojë tek qytetarët. Ky është një faktor që çënon legjimitetin e qeverisjes dhe respektimin e shtetit ligjor në kushtet aktuale dhe për të ardhmen.

Në rastin e Shqipërisë, nuk është korniza ligjore që ka problemet kryesore, më tepër se sa mungesa vullnetit nga drejtuesit, mungesa e koordinimit dhe mungesa e bashkëpunimit institucional mes institucioneve zbatuese e ndëshkuese të ligjit. Nga intervistat e realizuara identifikohet se një tjetër faktor me rëndësi është mungesa e kapaciteteve dhe burimeve të nevojshme për implementimin e ligjit. Duhet thënë se vërehet një tendencë për të shkuar direkt tek ligji, duke e prezantuar atë si sukses të institucioneve qeverisëse. Por që kjo të bëhet, një analizë kujdesshme nevojitet për të vlerësuar pengesat institucionale dhe kapacitetet për implementimin e ligjit. Shpesh problemi i zbatimit, qëndron jo tek njerëzit që refuzojnë normat, por tek performanca e institucioneve implementuese që nuk gëzojnë burimet dhe nuk përdorin efektivisht pushtetin në dobi të zbatimit rigoroz të ligjit¹²⁶. Ligjet më të mira mund të kopjohen nga modelet perëndimore, por buxheti për t'i implementuar është mjaft i ndryshëm. Si pasojë, pas 20 viteve demokraci, shqiptarët mund të kenë sistemin ligjor më të përparuar në rajon, por pa mundësi për ta zbatuar efektivisht. Ky problem i trashëguar aktualisht ka krijuar një kulturë mos-implementimi duke kërcënuar sistemin e shtetit ligjor në tërësi. Mungesa e aplikimit strikt

¹²⁵ FRIDE, Democracy Monitoring Report: Albania, April 2010


¹²⁶ Sokol Berberi, anëtar i Gjykatë Kushtetuese, Intervistë, Prill 2011

të ligjeve dhe në të njëjtën kohë tolerimi i shpeshtë i shkeljeve ligjore janë skenaret më të këqija për një shtet që synon të konsolidojë shtetin ligjor. Këto faktorë kanë pasoja të drejtëpërdrejta, jo vetëm për zbatimin e ligjit dhe ndëshkimin e shkelësve. Një ndikim negativ ka edhe për të ardhmen kur kushtet dhe kapacitetet do të jenë zhvilluar për zbatimin e ligjit, por konteksti i brendshëm do të jetë i tillë, ku kultura e mosrespektimit të ligjit tashmë do të jetë e përhapur dhe e vështirë për t'u çrënjosur.

Teorikisht, në një sistem demokratik frika e qytetarëve dhe elitës nga abuzimi i mundshëm i pushtetit ka sjellë nevojën e ndërtimit të një sistemi “kontrolli dhe balance”, i programuar për të rritur përgjegjshmërinë e qeverisë në dobi të efikasitetit dhe efektivitetit¹²⁷. Megjithatë në këtë strukturë, performanca e institucioneve nuk është përgjigjia e vetme, pasi edhe institucionet më të mira do të dështojnë për të bërë një ligj efektiv, nëse të dyja palët; si qytetarët edhe zyrtarët, nuk do të shprehin sjellje respektuese dhe bindje ndaj normave legale apo t'i konsiderojnë ligjet si detyruese me pasoja ndëshkuese. Në këtë kuadër krijohet ideja se çdo veprim i ndërmarrë, aspiron të bëhet në emër të shtetit ligjor si një rrugë legjitimimi e veprimtarisë së organizmave qeverisës, por shkalla që kjo arrihet varion.

Duhet të theksohet se institucionet përgjegjëse për zbatimin e shtetit ligjor në Shqipëri janë përballur me probleme dhe kritika për performancën dhe rezultatet e ulëta në 20 vitet e fundit. Në një raport të Bankës Botërore, ku vlerësohet zhvillimi i shtetit ligjor në Shqipëri gjatë 10 viteve të fundit, vërehet se pavarësisht progresit të identifikuar, standartet e shtetit ligjor mbeten të ulëta. Madje vlen për t'u veçuar, që sipas Bankës Botërore performanca e institucioneve publike, përsa i përket shtetit ligjor, paraqitet më e ulët se në vitin 1996.¹²⁸ Në anën tjetër të tjera vlerësime flasin se Shqipëria, krahasuar me vendet e tjera të rajonit, ka përjetuar një proces të vështirë të forcimit të shtetit ligjor dhe mbetet mbrapa në konsolidimin e shtetit ligjor.

Figura 31: Zhvillimi i Shtetit Ligjor në Shqipëri sipas World Bank




100% = i konsoliduar ; 0% i pakonsoliduar

¹²⁷ Kim. Seok-Eun, The Role of Trust in the Modern Administrative State, Administration and Society. Vol 7, 2005

¹²⁸ World Bank, Rule of Law in Albania: 1996-2008, World Governance Indicators, 2009

Figura 32: Zhvillimi i shtetit të së drejtës në Shqipëri



Burimi: FRIDE, Democracy Monitoring Report: Albania, April 2010

Duke marrë në konsideratë faktin se ligji në mënyrë të pashmangshme krijon hapësira për abuzim të pushtetit nga grupe dhe individë të ndryshëm, mendohet se është shteti ligjor që minimizon këto rreziqe që vet ligji mund të krijojë. Faktorë kryesor që kanë ndikuar negativisht në themelimin e një sistemi të bazuar në shtetin ligjor dhe vlerat demokratike në Shqipëri janë edhe influencat dhe konfliktet politike duke mos harruar gjithashtu nepotizmin dhe klientelizmin në institucionet publike i trashëguar në vite¹²⁹. Ky mjedis ka rrezikuar zhvillimin e sistemit ligjor në Shqipëri e në të njëjtën kohë, besimin e njerëzve në institucionet qeverisëse.

Administrimi i drejtësisë

Një ndër fushat kryesore të konsolidimit të një shteti funksional, i bazuar në ligj, është ndëshkimi i veprimeve ilegale. Si rrjedhojë drejtësia mund të konsiderohet si një ndër shtyllat kryesore të forcimit të shtetit ligjor. Raportet e organizmave të ndryshëm ndërkombëtarë vërejnë dështimet e sistemit të drejtësisë në zbatimin e ligjit në Shqipëri, duke u pasqyruar në besimin e publikut tek organet e sistemit të drejtësisë dhe institucioneve publike në tërësi. Raportet veçojnë se ndërhyrjet e politikës në strukturat e drejtësisë kanë dobësuar ndjeshëm besueshmërinë dhe legjitimitetin e vendimeve të gjykatave. Si pasojë e problemeve të hasura në këtë fushë, studime të këtyre 10 viteve të fundit tregojnë besimi publik në sektorin e drejtësisë është i ulët. Kjo reflektohet edhe në terren, pasi një vend ku shteti ligjor dhe besimi në sistemin e drejtësisë është në zhvillim, ekzekutimi vullnetar i vendimeve të gjykatave është mjaft i ulët, e shpesh inekzistent¹³⁰. Në mjaft referenca theksohet se korrupsioni në sistemin gjyqësor ka qenë një ndër “problemet më serioze”, edhe pse “rastet e gjyqtarëve të ndjekur penalisht për korrupsion janë të rralla”¹³¹.

Institucionet Europiane shpesh kanë shprehur shqetësim në lidhje me gjendjen e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Duke iu referuar një raporti të vitit 2006 “...një sistem drejtësie i dobët, i varfër, dhe pjesërisht i korruptuar përbën një ndër shqetësimet kryesore të shtetit ligjor në


¹²⁹ Zyberi. Gentian, Shteti Ligjor ne Shqipëri: Midis aspirates dhe realitetit, RSHSL Annual Conference 2008, www.ajls.org/doc/Abstrakt_GZyberi-Shteti-Ligjor-AJLS-2008.pdf

¹³⁰ Lipponen. Osmo, Analiza e Sistemit Ligjor ne Shqipëri, OSBE: 2004

¹³¹ FRIDE, Democracy Monitoring Report: Albania, Prill 2010

Shqipëri”¹³². Të tjera raporte shprehin rezerva ndaj pavarësisë, përgjegjshmërisë, transparencës dhe efikasitetit të drejtësisë në vendin tonë¹³³. Një tjetër vlerësim i kohëve të fundit i OSBE-së, del në konkluzionin se forma më e zakonshme e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e drejtësisë vjen nga burimet private si bizneset, individë apo grupe kriminale që synojnë të influencojnë drejtëpërdrejtë prokurorinë apo gjyqtarët për të marrë vendime specifike. Në njërën anë prokurorët apo gjyqtarët shpesh pranojnë ryshfete në këmbim të dënimeve të buta apo favore gjatë procesit gjyqësor, ndërsa në anën tjetër në disa gjykata ata janë të tejngarkuar me çështje gjyqësore që presin të shqyrtohen. Kjo shkakton një proces hetimor dhe gjykim mjaft sipërfaqësor¹³⁴. Situata reflektohet në numrin e lartë të çështjeve të pranuar në Gjykatën Kushtetuese mbi ankesat ndaj vendimeve të organeve të drejtësisë si prokuroria, gjykatat, dhe përmbarimi.

Figura 33: Vendimet e Gjykatës Kushtetuese për Sektorin e Drejtësisë



Burimi: Ministria e Drejtësisë

Gjykatat cilësohen si pararoja e luftës kundër çdo çështjeje të korrupsionit. Si rrjedhojë nëse drejtësia nuk është e aftë apo nuk ka vullnetin e duhur për të dënuar të korruptuarit, atëherë përpjekjet kundër fenomenit të korrupsionit nga policia dhe prokuroria për hetimin e çështjeve korruptive do të jenë të kota. Nëse gjykatat nuk arrijnë të jenë objektive në vendimet kundër korrupsionit, atëherë nuk bën sens për qytetarët ose institucionet të denoncojnë raste të tilla¹³⁵.

Publiku pret që sistemi i drejtësisë të funksionojë dhe të jetë i pari në luftën kundër korrupsionit, mjaft i përhapur në vend. Por, nëse publiku percepton se drejtësia është e korruptuar për vete, do të ketë pak arsye për të besuar këtë institucion të rëndësishëm në funksionimin e shtetit ligjor. Në këtë kontekst mund të theksojmë se besimi është ngushtësisht i lidhur me performancën institucionale, në rastin tonë performancën e institucioneve të drejtësisë. Pra një sistem drejtësie i korruptuar është tejet i dëmshëm për përpjekjet për të luftuar korrupsionin. Ai dobëson shtetin ligjor, çënon principin e barazisë përpara ligjit dhe dobëson besimin e publikut tek gjykatat.

¹³² European Commission, Albania Progress Report 2006, Brussels

¹³³ Council of Europe, ‘Honoring of Obligations and Commitments by Albania’. Preliminary draft report. Strasbourg: Parliamentary Assembly, 9 qershor 2009 & American Bar Association, ‘Judicial Reform Index for Albania’. Washington DC, Dhjetor 2008

¹³⁴ SIDA, Albania Anti Corruption Study, January 2008, Ramboll Management – Copenhagen

¹³⁵ SIDA, Albania Anti Corruption Study, January 2008, Ramboll Management – Copenhagen

Nëse ky besim në erozion vazhdon, palët do të preferojnë t'i zgjidhin mosmarrëveshjet privatisht shpesh edhe me 'vetëgjyqësi' duke minuar bazat e sistemit shtetëror.


Perceptimet e përhapjes së korrupsionit në drejtësi mbeten aktuale. Në një sondazh të "American Bar Association" i vitit 2008, gati gjysma e gjykatësve besonin se korrupsioni në drejtësi përbënte një problem serioz dhe rreth 60% e publikut rezultonte se kishte pak ose aspak besim te sistemi i drejtësisë¹³⁶. Në këtë perspektivë edhe pse shtyllat e një sistemi drejtësie të pavarur janë themeluar me ligj, institucionet mbeten të dobëta dhe të pafuqishme për të përballuar ndërhyrjet e jashtme dhe korrupsionin.

Gjatë tranzicionit, sistemi i drejtësisë mund të konsiderohet si një prej sektorëve më të korruptuar në pushtetin ekzekutiv, në një kohë që sondazhet tregojnë se gjykatat rradhiten si institucionet më pak transparente në Shqipëri¹³⁷. Aksesit i qytetarëve në informacionin e këtij sektori mbetet gjithashtu problematik¹³⁸. Në një kohë që korrupsioni brenda sistemit gjyqësor perceptohet si tepër i lartë duke penguar funksionimin normal të tij, pak masa janë ndërmarrë për t'ju përgjigjur kësaj problematike.

Ndëshkimi dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore

Presionet politike, korrupsioni dhe burimet e kufizuara kanë ngadalsuar funksionimin e pavarur të sistemit të drejtësisë në vend. Edhe në ditët e sotme zbatimi i vendimeve gjyqësore mbetet problematik, në veçanti përsa i përket çështjeve ku institucionet shtetërore janë të akuzuarit apo të dënuarit¹³⁹. Pavarësisht faktit se nuk ka statistika të sakta mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në dëm të institucioneve shtetërore, dihen vështirësitë për të ekzekutuar vendime të tilla. Si rrjedhojë procedurat e ekzekutimit për çështjet civile e administrative kanë nevojë për përmirësim në mënyrë që të sjellin raportin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore më pranë standarteve të BE-së, në veçanti ku vet shteti është pala humbëse.

Figura 34: Ankesat drejtuar Avokatit të Popullit në lidhje me vendimet e drejtësisë¹⁴⁰



¹³⁶ American Bar Association, Judicial Reform Index for Albania, December 2008, USA

¹³⁷ IDRA, Corruption in Albania-Perception and Experience, Survey 2006 & 2009, Tirane

¹³⁸ US Dep. of State, Country Report on Human Rights Practices 2008,


¹³⁹ European Commission, Commission Opinion on Albania's application for membership of the European Union, Brussels, 09 November 2010

¹⁴⁰ Ombudsperson Office, Annual Report 2005-2010, http://www.avokatipopullit.gov.al/?page_id=259

Parregullsitë në sistemin juridik janë vërejtur edhe nga institucioni i Avokatit të Popullit, i cili gjatë viteve të fundit ka mbledhur një numër të lartë ankesash mbi vendimet dhe aktivitetin e sistemit të drejtësisë; prokurori, gjykata, përmbarimi. Shumica e ankesave të pranuar kanë patur të bëjnë me shkelje të natyrës procedurale apo administrative nga gjykatat, apo mungesa e ekzekutimeve të vendimeve nga zyra e përmbarimit¹⁴¹.

Gjatë viteve të tranzicionit zbatimi i vendimeve gjyqësore nuk ka qenë në standartet e kërkuara dhe lë mjaft vend për përmirësim. Bashkëpunimi midis policisë dhe organeve të drejtësisë nuk është në nivelin e duhur, ndërkohë që Zyra e Përmbarimit është e kufizuar në aktivitetin e saj nga mungesa e fondeve, vendimeve të paqarta të gjykatave dhe refuzimit të organizmave shtetërorë për të përmbushur detyrimet juridike bazuar në vendimet e gjykatave¹⁴².

Figura 35: Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës në Shqipëri ndër vite



Burimi: Ministria e Drejtësisë

Në nëntor të vitit 2008 u aprovua ligji “Mbi Shërbimin e Përmbarimit Privat” duke lejuar krijimin e organizmave privatë në kryerjen e detyrave të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Themelimi i përmbarimit privat konsiderohet të mbështesë zbatimin e vendimeve gjyqësore. Megjithatë, rregullorja implementuese që ky shërbim të nisë punën ende nuk janë adoptuar duke vazhduar të krijojnë pengesa për sistemin e drejtësisë¹⁴³.

2.7.3. Ndikimi i zbatimit të ligjit në besimin social

Funksionimi i sistemit ligjor është themelor për besimin ndaj institucioneve publike dhe organizmave qeveritarë në tërësi dhe në të njëjtën kohë ngritja e një sistemi reciprok besimi mes institucioneve dhe publikut. Njerëzit që janë skeptikë për zbatimin dhe aplikimin e drejtë të kornizës ligjore në jetën e përditshme, do të tregojnë pasiguri dhe mospajtueshmëri me

¹⁴¹ Po aty

¹⁴² European Commission, Albania Progress Report, 2006 & 2005, Brussels.

¹⁴³ European Commission, Albania 2009 Progress Report, Brussels

sistemin në tërësi. Si rrjedhojë, të gjitha hapat drejt krijimit dhe zbatimit të normave ligjore duhet të jenë në respektim të të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë pikë, një çështje kryesore që lidhet ngushtë me respektimin dhe konsolidimin e shtetit ligjor është legjitimiteti i sistemit. Legjitimiteti mishëron konsensusin se qytetarët bien dakort dhe pranojnë rregullat dhe normat qeverisëse të institucioneve shtetërore¹⁴⁴. Shtetet që gëzojnë një besim publik të lartë gëzojnë vlera demokratike dhe një shoqëri civile të zhvilluar, ku qytetarët mund të marrin pjesë dhe të kontrollojnë institucionet e tyre¹⁴⁵.

Shteti ligjor bazohet në konceptin se asnjë individ apo pjesë e qeverisë nuk duhet të dalë mbi ligjin, qofshin këta njerëz të thjeshtë apo zyrtarë të lartë. Është shteti ligjor që promovon barazinë e individëve / grupeve përpara ligjit. Këto ligje duhet të reflektojnë moralin e shoqërisë, dhe në demokracitë perëndimore, supozohet që këto norma të jenë të formalizuara, neutrale, objektive dhe të vendosura paraprakisht¹⁴⁶.

Në tranzicionin nga komunizmi në demokraci ka patur debate të vazhdueshme mbi legjitimitetin jo vetëm të elitës së re politike por edhe të institucioneve dhe ligjeve të themeluara¹⁴⁷. Studiues të ndryshëm argumentojnë se niveli i perceptimeve të publikut mbi besueshmërinë e institucioneve, influencon drejtëpërdrejtë prirjen e tyre për t'ju bindur rregullave dhe ligjeve të krijuara nga këto institucione¹⁴⁸. Qytetarët që besojnë se ligjbërësit dhe zyrtarët e shtetit përmbushin detyrat që u janë deleguar, janë më pak të prirur për mos t'ju bindur rregullave, t'i shmangen sistemit apo të përfitojnë ilegalisht prej tij. Në anën tjetër një qeveri e besueshme, është e aftë të inkurajojë qytetarët për t'ju bindur rregullave në atë masë që qytetarët e konsiderojnë legjitime autoritetin që merr vendime. Nën një autoritet me legjitimitet të pranuar, qytetarët mund të jenë dakort të sakrifikojnë interesat e tyre personale, për aq kohë që procedurat dhe aktiviteti qeveritar cilësohet si i besueshëm për shoqërinë në tërësi¹⁴⁹. Në këtë këndvështrim, në një sistem funksional, besimi luan një rol të rëndësishëm në vullnetin që do të kenë qytetarët për të ndjekur një vendim të njëanshëm të qeverisë, shpesh edhe pa kërkuar informacion të detajuar, duke supozuar se këto vendime janë legjitime e mbrojnë interesat e shumizës. Duke patur një orientim komunitar, qytetarët perceptojnë rregullat dhe obligimet si diçka që ata kanë pranuar t'u imponohen dhe që janë gati t'i respektojnë nëse kanë ndjesinë se këto norma nuk do të abuzohen nga askush¹⁵⁰. Mund të flitet se as në vendet perëndimore, që ne kemi si model, njerëzit nuk e besojnë njëri-tjetrin si individë, por si pjesë e një sistemi të përbashkët, të bazuar në një kornizë ligjore që garanton dhe mbron secilin nga cënimi

¹⁴⁴ Blind, P, Building Trust in Government in the Twentieth Century, UNDESA, November 2006, www.unpan1.un.org/intradoc/groups/public/.../un/unpan025062.pdf

¹⁴⁵ Newton, K & Norris, P, Confidence in Public Institutions, Faith, Cure or Performance, John F Kennedy School of Government, 1999

¹⁴⁶ Zyberi, Gentian, Shteti Ligjor ne Shqiperi: Midis aspirates dhe realitetit, RSHSL Annual Conference 2008, www.ajls.org/doc/Abstrakt_GZyberi-Shteti-Ligjor-AJLS-2008.pdf

¹⁴⁷ Zyberi, Gentian, Shteti Ligjor ne Shqiperi: Midis aspirates dhe realitetit, RSHSL Annual Conference 2008, www.ajls.org/doc/Abstrakt_GZyberi-Shteti-Ligjor-AJLS-2008.pdf

¹⁴⁸ Letki, N & Evans, G, Endogenizing Social Trust: Democratization in East-Central Europe, British Journal of Political Science 2005, Vol. 35 No. 3, pp. 515-529

¹⁴⁹ Kim, Seok-Eun, The Role of Trust in the Modern Administrative State, Administration and Society, Vol 7, 2005

¹⁵⁰ Natalia Letki, Investigating the Roots of Civic Morality: Trust, Social Capital, and Institutional Performance, Department of Political Science, Collegium Civitas, <http://www.qog.pol.gu.se/conferences/november2005/papers/Letki.pdf>

i të drejtave dhe lirive themelore. Në këtë kontekst kur veprimet e shtetit bazohen në themelet e shtetit ligjor dhe drejtësisë, njerëzit kanë tendencë të tregojnë më tepër besim ndaj autoriteteve publike. Kjo i bën ata më bashkëpunues si pjesë e të njëjtës shoqëri. Megjithatë ky debat nuk duhet të kufizohet vetëm në marrëdhëniet mes njerëzve dhe institucioneve shtetërore. Funksionimi i shtetit ligjor është i rëndësishëm jo vetëm për veprimtarinë e institucioneve shtetërore, por në të njëjtën kohë ndikon në pritshmëritë e qytetarëve për besimin tek njëri tjetri (ndër-personal) duke lejuar shtetin të luajë rolin e ndërmjetësit në marrëveshjet mes tyre¹⁵¹. Pra besimi tek institucionet reflektohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë edhe në raportet mes individëve, grupeve të ndryshme në shoqëri dhe besimin e reflektuar në marrëdhëniet e tyre.

Një ndër çështjet kyçe në 20 vitet e fundit në Shqipëri, është fakti se përpjekjet për të reformuar institucionet qeverisëse, u karakterizuan nga një krizë legjitimiteti. Iniciativat për të ristrukturuar sistemin u bënë nga aktorët qeverisës për të forcuar pozitat dhe përfitimet e tyre¹⁵². Në mjaft raste faktorët që shkaktuan këtë krizë legjitimiteti, kanë të bëjnë me vendim-marrjen e njëanshme si në aspektin legjislativ, edhe në atë ekzekutiv, duke adoptuar ligje dhe vendime të nxitura nga interesa të ngushta që bien në kundërshtim me nevojat e interesat e shoqërisë¹⁵³. Në anën tjetër vendim-marrja dhe zbatimi i vendimeve dhe ligjeve shpesh ka shkaktuar mosmarrëveshje dhe pakënaqësi, në veçanti përsa i përket transparencës dhe konsensusit. Kur njerëzit janë pak ose aspak të përfshirë në zhvillimin e kornizës ligjore dhe njëkohësisht shteti ligjor nuk është i konsoliduar në zbatimin rigoroz të ligjit, qytetarët kanë pak arsye për të parë institucionet si përfaqësues të tyre. Rrjedhimisht do të kenë pak obligim për t'ju bindur autoritetit. Krijimi i institucioneve transparente është i nevojshëm për të lejuar mbizotërimin e një kulture ndershmërie dhe moraliteti qytetar mes njerëzve, çka lidhet shpesh me besimin reciprok. Funksionimi i shtetit ligjor i referohet një sensi qytetar në interes të përbashkët, duke shkaktuar sjellje të përgjegjshme dhe bindje tek rregullat, përpara të cilave duhet të jemi të gjithë të barabartë. Kjo mund të quhet thelbësore, duke marrë në konsideratë se morali qytetar përbën një kundërshtues të korrupsionit dhe pandershmërisë; frenon qytetarët nga sjellje kundër normave shtetërore dhe shoqërore, si ndaj bashkëqytetarëve ashtu edhe ndaj institucioneve¹⁵⁴.

Huntington vlerëson se besimi rritet si pasojë e konsolidimit të shtetit ligjor dhe institucioneve publike. Në rastin tonë mund të thuhet se mungesa e një sistemi legal të stabilizuar dhe të besueshëm, bëri që normat shoqërore të komuniteteve të vogla, të kthehen në kornizën bazë të zbatimit të kontratave mes njerëzve, në një kohë që sistemi instructional mosbesues shmanget. Pra kemi një zhvendosje të besimit nga besimi institucional në marrëdhëniet e ngushta mes njerëzve bazuar në besim dhe reciprocitet¹⁵⁵. Në këtë linjë Levi propozon një model të quajtur “modeli kontigjent” i konsensusit, i cili demonstroi se besimi ndër-personal tek përfaqësuesit e institucioneve mund të transformohet në besim institucional, që përkthehet në shkallën e

¹⁵¹ Francisco Herreros and Henar Criado, “The State and the Development of Social Trust”, *International Political Science Review* (2008), Vol. 29, No. 1, 53–71.

¹⁵² Elezi, G, *Rule of Law in Albania*, Sussex University

¹⁵³ Frasherri, E, *Transformation and Social Change: Legal Reform in the Modernization Process*, Harvard Law School, 9.5.2008

¹⁵⁴ Letki, N & Evans, G, *Endogenizing Social Trust: Democratization in East-Central Europe*, *British Journal of Political Science* 2005, Vol. 35 No. 3, pp. 515-529

¹⁵⁵ Po aty

bindjes së qytetarëve me normat e rregulluara me ligj. Ky model tregon se besimi i publikut tek qeveria është i kushtëzuar në faktin se qytetarët kanë besim tek institucionet vetëm kur besojnë se ato funksionojnë në përputhje me interesat e tyre si shoqëri¹⁵⁶.

